

VËRTETËSIA

Botim i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Viti III

Nr. 4

**Zbulimi i së padukshmes
dhe Kurani Famëlartë » f. 30**

**Shenjat kryesore
të ardhjes së Imam Mehdiut
dhe të Mesihut të Premtuar**

» f. 8

»
**ISLAMI DHE
SHKENCA**
përputh-
shmëria apo
konflikti?
- Dr. Abdul
Salam, fitues
i çmimit Nobel

f. 50

»
**Fjalimi i Dr.
Abdul Salamit**
gjatë marrjes
së çmimit
Nobel

f. 88

»
Aurora Boreale
(dritat veriore)
dhe përmendja
e saj në
Kuran

f. 66

»
Kujtim i Musa
Rrustemit,
ish-presidentit
të Xhematit
Mysliman
Ahmadia të
Kosovës

f. 72

Disa lutje të Hazret Profetit Muhammed^{s.a.v.s.}

O Zoti im, Ti më dëgjon dhe e sheh gjendjen time. Ti e di të fshehtë dhe të dukshmen time. Asgjë nga gjërat e mia nuk është e fshehur nga Ti. Ndërsa, unë jam i varfër, lypës, përderës dhe kërkues i strehimit Tënd. O Zoti im, po dridhem e përpëlitem si ai që dëshmon dhe pranon fajin e vet. Po të lyp siç lyp një varfanjak. Po qaj para Teje si një mëkatar shumë i poshtër dhe po të lutem siç lutet një i frikësuar dhe shumë i brengosur, koka e të cilit është e ulur para Teje, të cilit i lotojnë sytë për Ty, trupi i të cilit është gjunjzuar për Ty dhe që vetëm për Ty ka vënë hundën në tokë. O Zoti im, mos të dal i pafat kur të lutem Ty. O Zoti im, o Ti që je më i miri për t'u lutur Ty dhe o Ti që je më Bujari se çdokush tjetër, trego dashuri dhe mëshirë ndaj meje! (Amin)

*(Tibrani Kebir, nga Hazret Ibne Abasi; Xhamius Segir;
Hazinatud Dua nga Hafiz Muzaffar Ahmedi)*

O Zoti im, unë jam rob yti, djalë i robit Tënd, djalë i robëreshës Tënde, jam në dorëzimin Tënd, koka ime është në dorën Tënde, jam i kënaqur me caktimin Tënd, sepse Ti gjithmonë cakton drejt. O Zot, po të lutem Ty me çdo emër Tëndin, me të cilin e ke quajtur Vetën, qoftë nga ata emra që ke zbritur në Librin Tënd, qoftë nga ata që ke lënë në të padukshme te Ti, Kuranin ma bëj fllad të zemrës sime dhe nëpërmjet atij, largo të gjitha brengat dhe pikëllimet e mia!

(Hazinatud Dua nga Hafiz Muzaffar Ahmedi)

REDAKSIA ADRESA

Kryeredaktor: Samad Ahmed Ghorri

Zv. Kryeredaktor: Shahid Ahmad Butt

Redaktorë: Rexhep Hasani,

Muhamet Peci

Anëtarë: Javaid Iqbal Nasir,

Bujar Ramaj, Çapajev Zera

Grafika:  petani

Shtypur në Shtypshkronjën:

Gent•grafik

Xhemati Mysliman Ahmadija i

Shqipërisë, Autostrada Tiranë-Durrës,
Km. 1,

Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355(0)682974992, 0692994966

+377(0)45366374

Fax: +355(0)48302523

E-mail: vertetesia@gmail.com

VËRTETËSIA

*një hap
më pranë
argumentit
dhe rrugës
së drejtë*

Botim i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë
Maj - Gusht 2011 • Viti III • Nr. 4

PËRMBAJTJA

Profeti që më së shumti ka treguar për të padukshmen

Editorial

3

Ajete të Kuranit Famëlartë – paralajmërimet për kohët tona

5

Shenjat kryesore të ardhjes së Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar – në bazë të haditheve të Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s.

Ardhja e Mesihut si Imam Mehdi; Rënia e myslimanëve dhe ndarja e tyre në 73 sekte; Mbizotërimi i fesë së krishterë; Rënia morale; Çështja e xhihadit; Koha e ardhjes së Imam Mehdiut; Eklipsi diellor dhe ai hënor gjatë muajit të ramazanit; Dexhali dhe Gomari i tij i çuditshëm; Jaxhuxhi e Maxhuxhi; Dhjetë shenja para ardhjes së Orës

8

Rreth paralajmërimeve të Kuranit Famëlartë

Thënie të Hazret Mesihut të Premtuar a.s.

25

**Zbulimi i së padukshmes dhe Kurani Famëlartë
Hazret Mirza Tahir Ahmedr.t.a, Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar**

30

“Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd”

një lajm pa koment

45

Përsosmëria e fjalës ALLAH

46

Islami dhe shkenca – përputhshmëria apo konflikti?

- Dr. Abdul Salam, fitues i çmimit Nobel

Kurani Famëlartë dhe shkenca; Zanafilla e Islamit dhe shkenca; Epoka e artë e shkencës në Islam; sipas Briffaultit; Rënia e shkencës në Islam; Shkenca moderne dhe besimi; Kufijtë e shkencës

50

A është e lejuar muzika në Islam?

Hazret Mirza Tahir Ahmedr.t.a., Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar

62

Hixhabi

Hazret Mirza Masroor Ahmed, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar

64

Aurora Boreale (dritat veriore) dhe përmendja e saj në Kuran

Mekanizmi i aurorës; Erërat diellore dhe magnetosfera; Zbulimet e para të kësaj dukurie; Origjina e kësaj dukurie;

66

Kujtim i Musa Rrustemit, ish-presidentit të Xhematit Mysliman Ahmedia të Kosovës

72

Vdekja e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit, Mesihut të Premtuar dhe shpalljet rreth saj

80

Fjalimi i Dr. Abdul Salamit gjatë marrjes së çmimit Nobel

88

Xhelsa Salana e 44-të të Xhematit Mysliman Ahmedia të Anglisë

90

Xhelsa Salana e 35-të të Xhematit Mysliman Ahmedia të Gjermanisë

93

PROFETI QË, MË SË SHUMTI KA TREGUAR PËR TË PADUKSHMEN

Editorial

Kurani Famëlartë thotë:

“Vetëm Ai (Allah) e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur.”

(El-Xhin 72:27-28)

Ajeti i lartpërmendur tregon se, përveç detyrave të tjera të shenjta, profetët janë të njoftuar edhe me gjërat nga bota e padukshme, të cilat përmbushen në kohët e tyre, duke vënë kështu argumentin e vërtetësisë së tyre para popujve të tyre. Në një ajet tjetër të Kuranit, Allahu i Madhërishëm thotë se çdo profet vjen me paralajmërime, që mund të jenë të gëzueshme ose alarmuese. Kështu ndodhi edhe me profetin e Islamit, Hazret Muhammedin ^{s.a.v.s.}, për të cilin Zoti thotë se ai ka ardhur për gjithë njerëzimin për ta kumtuar lajmin nga Ai:

“Ne të kemi dërguar ty për të gjithë njerëzimin si lajmëtar i së mirës dhe alarmues”.

(El-Saba 34:29)

Pra, sipas Kuranit, udhëheqësi ynë, Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}, ishte i ngarkuar për të dhënë paralajmërime nga e padukshmja, paralajmërime të cilat do t'i arrijnë të gjithë kufijtë hapësinorë si dhe kohorë të njerëzimit, kudo që gjen-

den dhe kudo që veprojnë.

Fuqinë e dijes nga e padukshmja dhe rreth së të padukshmes, të cilat i mbizotëronte profeti ynë, do të mund t'i shpjegojnë sikur t'i referoheshim një fakti tjetër që lidhet me jetën e më të dashurit tonë, Hazret Profetit Muhamed ^{s.a.v.s.}. Siç e dimë të gjithë, profeti kishte lindur në një shoqëri që gjendej larg shkencave apo profesioneve të kohës. Edhe Gadishulli arab ishte një vend ku thuajse të gjithë ishin të pashkolluar. Shterpësinë e asaj shkretëtire e pasqyronte më së miri gjendja e popullit për sa i përket intelektit dhe dijes. Madje edhe vetë Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} nuk kishte shkuar në ndonjë shkollë apo te ndonjëri për të mësuar. Duke i pasur parasysh këto rrethana, për të cilat pak kush nuk i di, është e paimagjinueshme që pa pasur ndonjë përkrahje, ashtu vetvetiu, papritmas të mbijë ndonjë burim i furishëm dijes. Por kjo ka vetëm një shpjegim: e vetmja rrugë e dijes së profetit tonë ishte Zoti i Gjithëdijshëm. Dhe pikërisht kjo dije, kjo dritë prej Zotit, u bë shkak i gjithë asaj lëvizje te arabët dhe madje edhe më larg. Në Kurantin

Famëlartë përmend ardhjen e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s}, në suren El-Xhuma dhe po ashtu jepen misionet e tij:

Allahun e përlëvdon gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë. Ai është Sunduesi, i Shenjti, i Plotfuqishmi dhe i Urti. Është Ai që u solli analfabetëve një të dërguar nga gjiri i tyre, që u lexon atyre ajetet e Tij, i pastron, u mëson Librin dhe urtësinë, edhe pse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë. Ai do ta dërgojë atë edhe tek të tjerë, të cilët ende nuk u janë bashkuar. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti. Kjo është dhuntia e Allahut, Ai ia jep atë kujt të dojë. Allahu zotëron dhuntitë të mëdha.

(El-Xhuma 62:2-5)

Kjo gjë u dëshmuar. Profeti Muhammed ^{s.a.v.s} erdhi te një popull i pashkolluar dhe solli një revolucion të madh në një periudhë të shkurtër kohe. Sigurisht, edhe gjatë jetës së tij shumë paralajmërime të mëdha janë dhënë dhe janë plotësuar. Për shembull, ai la Mekën në një kohë kur të gjithë myslimanët donin të shpëtonin nga vdekja. Pikërisht në atë kohë, Allahu e njoftoi se ai përsëri do të hyjë në këtë qytet, por jo më si i pushtuar, por si triumfues, gjë që u plotësua¹.

Dhënia e profecive dhe plotësimi i tyre nuk kufizohen vetëm në kohën sa ishte ai i gjallë. Shumë nga profecitë e tij flasin për të ardhmen, madje edhe për revolucionet e mëdha të kohës sonë. Njëri ndër ato paralajmërime, madje shumë i rëndësishëm, është edhe paralajmërimi për ardhjen dhe

¹ Për shembull, në një ajet, Kurani duke dhënë këtë paralajmërim thotë: *Padyshim, Ai që ta bëri obligim Kuranin, Ai do të kthejë ty aty nga erdhe.* (El-Keses 28:86)

shenjat e ardhjes së Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar, të cilat përmenden edhe në Kuranin Famëlartë, po ashtu edhe në shumë hadithe të të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s}. Shumë nga dijetarët myslimanë, duke u bazuar në fjalët e paralajmërimeve dhe duke dashur se ato të plotësohen fizikisht e jo metaforikisht, po presin Isain ^{a.s.} të zbrësë nga qielli, pra, po atë Isa, që ka jetuar para dymijë vjetësh. Veç kësaj, me ardhjen e tij do të vijë edhe një *Dexhal* që sipas tyre do të ketë aftësi mbinjerëzore, për të mos thënë aftësi të Zotit dhe një sërë paralajmërimesh të tjera, të cilat, nga këndvështrimi i tyre do të plotësohen fjalë për fjalë, pra në mënyrë statike çfarë jep mesazhi e jo analiza e tij, gjë që të çon vetëm në botën e fantazive.

Nga ana tjetër, duke mos pasur udhëheqje shpirtërore, myslimanët pësuan e vazhdojnë të pësojnë rënie morale e shpirtërore, saqë janë të gatshëm t'u japin këso interpretimesh profecive të Profetit tonë të dashur. Pikërisht kjo rënie paraqet kohën më të duhur dhe më të qëlluar të atij, që do të rithemelonte besimin e humbur. Realisht, edhe vetë ata kanë filluar të pohojnë se kjo është pikërisht koha, kur duhej të vinte Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar. Por, si gjithmonë, duke qenë larg besimit të pastër, njerëzit guxojnë të përcaktojnë vetë natyrën e kohës dhe të atij që duhet të vijë dhe e refuzojnë atë që dërgohet. A do të ishte po e njëjta rrethanë nëse njerëzit, për kërkesat e tyre vetjake kryeneçe, të përcaktojnë kohën e tij për qefin tyre duke harruar se një gjë e tillë është kompetencë e dikujt tjetër?!

vazhdon në faqen 29

Ajete të Kuranit Famëlartë paralajmërimi për kohët tona

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit



إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ۖ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ۖ

“Kur dielli të paloset.
Kur yjet të errësohen.”



وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ۖ

“Kur malet të lëvizen.”



وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ ۖ

“Kur devetë me barrë dhjetëmuajshe,
të braktisen”



وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ۖ

“Kur egërsirat të grumbullohen.”



وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ۖ

“Kur detet të derdhen fort
(njërin mbi tjetrin).”





وَإِذَا التُّفُوسُ زُوِّجَتْ ﴿١٤١﴾

“Kur njerëzit të bashkohen.”



وَإِذَا الْمَوْدَّةُ سُيَلَّتْ ﴿١٤٢﴾ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ﴿١٤٣﴾

“Dhe kur foshnja-femër e varrosur për së gjalli të pyetet: për çfarë faji ishte vrarë?”



وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ﴿١٤٤﴾

“Kur librat të publikohen dhe shpërndahen.”



وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ﴿١٤٥﴾

“Kur qielli të zhvishet”.



وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِرَتْ ﴿١٤٦﴾

“Kur xhehenemi të flakërojë”.



وَإِذَا الْجَنَّةُ أُرْلِفَتْ ﴿٣٠﴾
“Kur xheneti të afrohet”.

عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا أَحْضَرَتْ ﴿٣١﴾
“Atëherë çdokush do të marrë vesh se
çfarë kishte sjellë”.

فَلَا أَقْسَمُ بِالْخُنُوسِ ﴿٣٢﴾
“Madje betohem për ato që
intrigojnë dhe pastaj tërhiqen”.

الْجَوَارِ الْكُنُوسِ ﴿٣٣﴾
“Për varkat që fshihen në vendin e
tyre të fshehtë”.

وَالْيَلِ إِذَا عَسَّسَ ﴿٣٤﴾
“Për natën kur bie terri”.

وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ ﴿٣٥﴾
“Dhe për agimin kur ai fillon të
marrë frymë”.

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ﴿٣٦﴾
“Sigurisht, kjo është fjala e një
të dërguari fisnik”.

ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ﴿٣٧﴾
“që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë
te Zoti i Fronit”.

مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ ﴿٣٨﴾
“Shumë i bindur dhe gjithashtu
besnik”.

وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ ﴿٣٩﴾
“Shoku juaj nuk është i marrë”.

وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ ﴿٤٠﴾
“Ai e ka parë këtë në horizontin
e qartë”.

وَمَا هُوَ عَلَى الْعَيْبِ بِضَهِينٍ ﴿٤١﴾
“Dhe ai nuk është koprrac në
tregimin e së padukshmes”.

وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ ﴿٤٢﴾
“Dhe as kjo nuk është fjale
e shejtanit të mallkuar”.


فَأَيْنَ تَدْهُبُونَ ﴿٤٣﴾
“Prandaj, nga po ia mbani?”

إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿٤٤﴾
“Vërtet, kjo është veçse një këshillë
për botët”.

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ ﴿٤٥﴾
“Për secilin nga ju që dëshiron
të tregohet i qëndrueshëm”.

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٦﴾
“Por ju nuk mund të dëshironi,
përveçse me vullnetin e Allahut,
Zotit të botëve”.

(Et-Tekuîr 81:1-30)



Shenjat kryesore
të ardhjes
së Imam Mehdiut
dhe të Mesihut
të Premtuar

*Në bazë të thënieve
të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}*

Ardhja e Mesihut të Premtuar dhe Imam Mehdiut

عن ابى هريرة رضى الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: يوشك من عاش منكم أن يلقى عيسى ابن مريم اماما مهديا وحكما عدلا فيكسر الصليب ويقتل الخنزير ويضع الجزية وتضع الحرب أوزارها.

(مسند احمد جلد 2 رقم الصفحة 411)

Transmetohet nga Abu Hurejrah r.z. se Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Çdokush që do të jetojë prej jush, do ta gjejë Isain birin e Merjemes si Imam Mehdi, si vendimtar, gjyqtar, ai do ta thyejë kryqin, do të mbysë derrin dhe do të heqë xhizjen dhe lufta (xihadi) do të dorëzojë armët e saj.”

(Musnad Ahmed, vol. 2, f. 411)

Ky hadith, në Muslim, përmendet si më poshtë:

عن ابى هريرة رضى الله عنه انه قال : قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: والله لينزلن ابن مريم حكما عادلا فليكسرن الصليب وليقتلن الخنزير وليضعن الجزية ولتتركن القلاص فلا يسعى عليها ولتذهبن الشحناء والتباغض والتحاسد وليذعنوا إلى المال فلا يقبله أحد

(مسلم كتاب الايمان باب نزول عيسى ابن مريم)

Transmetohet nga Abu Hurejrah r.z. se Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Për Zotin, do të zbresë patjetër Biri

i Merjems si vendimtar, gjyqtar, ai patjetër do ta thyejë kryqin, patjetër do të mbysë derrin dhe patjetër do të heqë xhizjen, me siguri do të dalin devetë jashtë përdorimit dhe askush nuk do t'i hipë, koprracia, lakmia, inati dhe xhelozia do të zhduken (me anë të Mesihut të Premtuar). Ai do t'i thërrasë njerëzit drejt pasurisë, por asnjeri nuk do ta pranojë.”

(Muslim Kitabul Iman, Bab Nuzul Isa ibni Merjem)

SHËNIM:

Misionet e Mesihut të Premtuar dhe të Imam Mehdiut që janë përmendur në këto hadithe, nëse i shohim si shkak pasojë, ato vetë japin edhe shenjet e ardhjes së tij dhe përcaktojnë kohën e tij.

Rënia e myslimanëve dhe ndarja e tyre në 73 sekte

Ai është *vendimtar* dhe *gjyqtar*, sepse në kohën e tij, myslimanët do të përçaheshin dhe zgjidhja përfundimtare do të vinte prej Zotit. Kështu që, në shumë hadithe, Profeti Muhammed s.a.v.s. paralajmëron rënien e skajshme të myslimanëve. Këtu do të përmendim vetëm tri nga ato:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

- Sigurisht, edhe popullit tim do t'i ndodhin gjërat që u kanë ndodhur më parë Izraelitëve, ashtu siç këpucët ngjajnë njëra me tjetrën. Madje, nëse dikush prej Izraelitëve ka kryer imoralitet haptas me ➤

VËRTETËSIA

nënën e tij, do të jetë ndonjëri edhe nga populli im që do të bëjë të njëjtën gjë. Vërtet, Izraelitët u ndanë në 72 sekte, por njerëzit e mi do të ndahen në 73; të gjithë do të jenë në zjarr përveç njërit.

- Kush do të jetë ai? – e pyetën *es-habët* e tij.

- Ata që do të jenë në rrugën time dhe të *es-habëve* të mi – u përgjigj i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.}

(*Tirmidhi, vol. 5, Kitabul ul Iman, kap. 18, hadithi 2641*)

Në *Sunen Abi Daud* përmendet se I Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} tha:

72 do të jenë në zjarr dhe një do të jetë në xhenet. Ai do të jetë **Xhemati**.

Në arabisht, *xhemat* do të thotë “bashkësi”. Bashkësia nuk mund të ekzistojë pa një kryetar, i cili, në terminologjinë e Islamit quhet *kalif*. Me bekimin e Zotit të Madhërishëm, sot sistemi i kalifatit funksionon vetëm në Xhematin Mysliman Ahmedia, themeluesi i të cilit Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ka deklaruar të jetë Imam Mehdi dhe Mesih i Premtuar. Ndërsa, të gjitha sektet e tjera, jo vetëm që nuk gëzojnë një sistem të tillë, por bashkërisht e kundërshtojnë këtë xhemat. Pikërisht për këtë kishte paralajmëruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që 72 sekte në një drejtim dhe 1 në një drejtim tjetër, por vetëm ky i fundit do të jetë në rrugën e drejtë. I Dërguari

i Allahut^{s.a.v.s.} paralajmëroi për rënien e myslimanëve me fjalët, që nëse i lexoni ato, juve ju duket sikur i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} po tregon gjendjen e tyre të sotme. Ai thotë:

“*Sigurisht do të vijë koha kur Islamit nuk do t’i mbetet asgjë përveç emrit të tij dhe Kuranit nuk do t’i mbetet përveç tekstit të tij. Xhamitë e tyre do të jenë të mbushura me njerëz, por të zbrazëta nga hidajeti (d.m.th. nga udhëzimi i vërtetë). Dijetarët e tyre do të jenë krijesat më sherrxhi nën qiell. Përçarja do të mbillet prej tyre dhe tek ata do të kthehet.*”

(*Shuabul Iman, Imam Bejhki, vëll. II, f. 311, i botuar në Darul-kutubil-ilmija,*

Bejrut; Mishkat, kitabul Ilm)

Në një hadith tjetër, që rrëfëhet nga Hazret Abdullah Bin Amr^{r.z.}, i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} thotë:

“*Me të vërtetë Zoti nuk do ta heqë dijen nga robërit e tij përnjëherë. Por, dija do të hiqet nga zhdukja e dijetarëve, derisa nuk do të mbetet asnjë dijetar. Atëherë njerëzit do të zgjedhin injorantët si dijetarë, të cilët kur kërkohen, lëshojnë vendime pa dije dhe kështu devijohen dhe i devijojnë të tjerët*”.

(*Buhari, Kitabul Ilm, Bab Kejfa jekbidul ilm*)

Mbizotërimi i fesë së krishterë

Në hadith, Profeti Muhammed^{s.a.v.s.} thotë se **Mesihu i Premtuar do të vijë për të thyer**

kryqin, paralajmërim ky që do të japë një pamje absurde nëse do ta paramendoni të plotësohej me kuptimin e tij të drejtpërdrejtë. Çfarë dobie mund të sjellë një njeri duke zbritur nga qielli që t'i thyejë të gjitha kryqet që gjenden botë, qofshin nëpër kisha, qofshin nëpër rrugë apo varreza ose qofshin ato në qafat e miliona grave apo burrave të botës! Në të vërtetë, ky paralajmërim tregon se gjatë kohës së Mesihut të Premtuar, feja e krishterë me besimin e kryqit do të jetë e mbizotëruar në botë. Mesihu i Premtuar do të vijë pikërisht për të dhënë argumente të qarta që do të tregonin pavërtetësinë e besimit në kryq. Edhe në shpjegimin e Dexhallit, do të lexoni sesi do të mbizotërojë feja e krishterë. Sot, kjo profeci është përmbushur pikë për pikë. Shumë nga dijetarët myslimanë apo jomyslimanë, e pranojnë faktin se Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ishte i pari që trajtoi gjerësisht problematikën e ngjarjes së kryqëzimit të Hazret Isait^{a.s.}. Ai argumentoi nga Bibla, Kurani dhe shkenca se Hazret Isai nuk ndërroi jetë në kryq, por i shpëtoi kryqëzimit dhe pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi nëpër malet e Kashmirit.

Rënia morale

Vrasja e derrit gjithashtu ka kuptim metaforik. Dijetarët myslimanë gabimisht e kuptuan

këtë profeci të madhe në sensin fizik. Do të ishte mirë që ata që e besojnë këtë gjë, duhet të fillojnë të vrasin derra që tani, në mënyrë që t'ia lehtësojnë punën atij profeti që do të vijë nga qielli! Nëse dikush e keqkupton këtë që sapo thamë, atëherë si është e mundur që të mendohet një detyrë e tillë për një profet!? Në këtë profeci, derri nuk simbolizon tjetërkënd përveç njeriut. Kjo padyshim tregon se në kohën e Mesihut të Premtuar bota do të degradohej në ekstrem. Metafora e derrit me këtë kuptim është përdorur vetë nga Kurani Famëlartë. Aty thuhet:

Thua: "A doni t'ju tregoj se kush do të marrë dënimin më të rëndë nga Allahu? Ata që Allahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke i shndërruar në majmunë dhe derra, si dhe ata që adhurojnë djallin. Ata janë në vendin më të njerueshëm dhe janë më larg rrugës së vërtetë".

(El-Majdah 5:61)

Profecia e rënies morale është lidhur ngushtë me ardhjen Hazret Mesihut të Premtuar. Në një hadith tjetër, Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} tregon fjalë edhe më të qarta: Hazret Enes ibn Malik ^{r.z.} tregon se Hazret i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "Gjërat do të përkeqësohen shumë, bota do të degradohet në ekstrem dhe njerëzit do të përparojnë vetëm në koprraci e lakmi dhe Ora do t'u vijë vetëm njerëzve të këqij ➤

dhe nuk do të ketë asnjë Mehdi tjetër përveç Isait birit të Merjemes.”

(Ibni Maxhah, Kitabul fiten, Bab shiddatuz zaman)

Edhe kjo profeci është përm-bushur fjalë për fjalë dhe nuk kërkon ndonjë shpjegim të mëte-jshëm.

Çështja e xhihadit gjatë kohës së Mesihut të Premtuar

Një gjë tjetër që është përmendur në këto profeci është se **Mesihu i Premtuar** ^{a.s.} *do t'i japë fund xhihadit me armë, d.m.th. luftës fetare*, për shkak se kushtet e xhihadit me armë nuk do të ekzistojnë dhe se në çdo vend të botës do të ketë liri fetare. Kjo profeci gjithashtu tregon se pikërisht në kohën e ardhjes së tij, myslimanët do ta ngrinin çështjen e xhihadit, prandaj atij do t'i duhet t'u bëjë thirrje që të heqin dorë nga luftërat fetare. Sot, ekzistojnë pikërisht këto rrethana, kur ne shohim që një pjesë e madhe e myslimanëve është marrë vetëm me luftëra jo vetëm kundër jomyslimanëve, por edhe kundër grupeve të tjera myslimane, edhe pse, sot njerëzit mund ta praktikojnë fenë islame në çdo vend të botës. Ishte Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} i pari, që para njëqind viteve u bëri thirrje myslimanëve që të heqin dorë nga xhihadi me shpatë dhe se pena dhe argumenti duhet të

jenë armët e myslimanit për të luftuar me kundërshtarët. Në një poezi të tij, ai thotë:

O miq! Hiqni dorë nga mendimi i xhihadit

Gjakderdhja dhe lufta për fenë, tani janë të ndaluara

Ai që merr pjesë në luftëra (fetare) edhe pas këtij urdhri,

Patjetër do të ndëshkohet rëndë nga jobesimtarët

Koha e ardhjes së Mesihut të Premtuar

Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} Mesihun e Premtuar e quan Isa biri i Merjemes. Shumë myslimanë e kanë keqkuptuar këtë dhe menduan sikur i njëjti Isa që ka jetuar para dymijë vjetve, do të rikthehet përsëri në tokë. Ndërsa, ajetet Kuranore dhe hadithet tregojnë qartazi që Hazret Isai ^{a.s.}, si çdo profet tjetër, ka ndërruar jetë. (Inshallah në ndonjë numër tjetër të *vërtetësisë* do të sjellim argumente rreth vdekjes së tij). Mesihu i Premtuar është quajtur si Isa, për shkak të ngjashmërisë së plotë që do të ketë ai me të. Hazret Isai nuk kishte sjellë ndonjë ligj të ri, por ai dhe gjithë hebrenjtë, për të cilët kishte ardhur ai, ndiqnin librin e Hazret Musait ^{a.s.} Hazret Isai ^{a.s.} kishte ardhur trembëdhjetë shekuj pas Hazret Musait ^{a.s.} Në të njëjtën mënyrë edhe Mesihu i Premtuar do të vinte trembëdhjetë shekuj pas Hazret Muhammed ^{s.a.v.s.} sepse ky i fundit kishte ngjashmëri të

plotë me Hazret Musain ^{a.s.} siç e thotë edhe Kurani në një vend: *“Ne kemi dërguar tek ju një Dërguar si dëshmitar, ashtu siç patëm dërguar një të tillë te Faraoni”*

Eklipsi i diellit dhe i hënës gjatë muajit të ramazanit

Kohën e ardhjes së Imam Mehdiut e përcakton edhe më qartë një tjetër paralajmërim i famshëm, ai i eklipsit të diellit dhe të hënës gjatë muajit të ramazanit:

عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَلِيٍّ قَالَ: إِنَّ لِمَهْدِيٍّ بَيْنَا آيَاتَيْنِ لَمْ تَكُونَا مُنْذُ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ تَنَكُّسُ الْقَمَرِ لِأَوَّلِ لَيْلَةٍ مِنْ رَمَضَانَ وَتَنَكُّسُ الشَّمْسِ فِي النِّصْفِ مِنْهُ وَلَمْ تَكُونَا مُنْذُ خَلَقَ اللَّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ (سنن دار قطنی، کتاب العیدین باب صفة صلوة الخسوف والكسوف)

Hazret Imam Muhammed Bakiri, që është nipi i Hazret Imam Husenit thotë:

“Për Mehdiun tonë ka dy shenja të cilat nuk janë shfaqur kurrë më parë, që kur janë krijuar qiejt dhe toka: (1) në muajin e ramazanit, në natën e parë (gjatë netëve të eklipsit hënor) do të eklipsohet hëna (2) në të njëjtin ramazan, dielli do të eklipsohet në ditën e mesit (të ditëve të eklipsit diellor). Që kur ka krijuar Allahu qiejt dhe tokën, nuk janë shfaqur këto dy shenja për askënd”.

(Sunan Darqutni, kitabul eidain, Bab salatil husufi uel kusuf)

Profecia kërkon:

1. Të ketë një deklaruës për Mehdiun para se të ndodhin këto dy shenja qiellore, në mënyrë që këto të shfaqen për vërtetësinë e tij.
2. Më 13 të ramazanit të eklipsohet hëna, sepse ajo eklipsohet vetëm gjatë natës 13, 14 ose 15 të muajit sipas kalendarit hënor që është edhe kalandari islamik.
3. Më 28 të të njëjtit ramazan të eklipsohet edhe dielli, sepse ai eklipsohet vetëm gjatë ditës së 27, 28 ose 29 të muajit sipas kalendarit hënor.

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, në vitin 1882 përmes shpalljeve hyjnore u njoftua se ai ishte prej Zotit. Në vitin 1894 ndodhën shenjat qiellore të lartpërmendura, duke dhënë një dëshmi hyjnore për vërtetësinë e tij. Me 13 ramazan të vitit 1311 Hixhri (21 mars 1894) u eklipsua hëna dhe eklipsi diellor ndodhi të premten më 28 ramazan 1311 Hixhri (6 prill 1894).

Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, paqja qoftë mbi të thotë:

“Gjatë këtyre 13 shekujve, shumë njerëz kanë deklaruar se janë Mehdi, por për askënd nuk janë shfaqur këto shenja qiellore... Unë betohem për Atë Zot, në dorën e të Cilit është jeta ime, se Ai i ka shfaqur këto shenja në qiell vetëm për vërtetësinë time.”

(Tuhfa Gularvia, f. 33, Rruhani Khezain, vëll. 17, f. 142-143)



“Vetëm në epokën time, në muajin e Ramazanit, ndodhën eklipset e diellit dhe të hënës; në epokën time, në përputhje me thëniet autentike të Profetit Muhammed s.a.v.s., të Kuranit të Shenjtë dhe të Librave më të hershëm, ra murtaja në të gjithë vendin, dhe vetëm në epokën time filluan të ekzistonin mënyra të reja transportimi të quajtura hekurudha dhe vetëm në epokën time, sipas profecive të mia, ndodhën tërmete të tmerrshme. A nuk është e vërtetë se nëse njeriu i frikësohet Zotit dhe e do Atë, ai nuk duhet të guxojë të më mohojë mua?! Shihni! Unë betohem për Zotin e Plotfuqishëm dhe ju them se janë shfaqur, po shfaqen dhe do të shfaqen mijëra shenja për të vendosur vërtetësinë time. Nëse ky do të ishte një plan i njeriut, ai kurrë nuk do të kishte patur kaq shumë mbështetje dhe ndihmë.”

(Haqiqatul Wahi)

të jetë shpejtësia e tij në tokë? Ai iu përgjigj: - Me shpejtësi të resë, kur e merr era. Ndërkohë, Allahu do ta dërgojë Isain birin e Merjemes, që do të zbresë në lindje të Damaskut, në një minare të bardhë, ai do të jetë i mbështjellë me dy çarçafë të verdhë, krahët e tij të vendosur mbi krahët e engjëjve... Mesihu i Premtuar do të niset në kërkim të Dexhallit dhe do ta gjejë te Bab-lud (porta e Lud-it) dhe do ta vrasë atë. ... Ndërkohë, Allahu do t'i drejtohet Isait a.s., përmes shpalljes dhe i thotë: Unë kam një popull, sot askush nuk ka fuqi të luftojë me të. Ndaj, udhëhiqi robërit e Mi drejt malit Tur. Atëherë, Zoti do të ngrejë Jexhuxhët e Mexhuxhët, të cilët do të shpejtojnë prej çdo lartësie...”

(Muslim Kitabul Fiten, Bab dhukrid Dexhall)

Mesihu i Islamit, fitorja e tij, Dexhalli, Jaxhuxhi e Maxhuxhi

Nevas bin Sem'an rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} duke folur rreth Dexhallit tha:

“...e pashë Dexhallin, i cili m'u shfaq si një i ri me flokë kaçurrele, shtatmadh dhe i ngjante Abdul Uzza bin Ketanit (një jobesimtar). Ai që e gjen nga ju, le të recitojë ajetet e para të sures El-Kehf ...” Es-habët e pyetën: - Sa do

Imam Muslimi e shënoi këtë hadith në librin e tij për shkak të autencitetit të tij. Hadithi është i gjatë, ndaj ne kemi zgjedhur vetëm disa pjesë të tij, të cilat, në të vërtetë, janë paralajmërimet që Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} mori përmes revelatave, shpalljeve apo vizioneve prej Zotit, ku Ai i ka dhënë shenjat kryesore të Dexhallit, Jexhuxhëve e Mexhuxhëve. Këto shenja duhet të zërthehen sipas dijes së tabirit.


Një paralajmërim kryesor në këtë hadith është vendardhja e Mesihut të Premtuar a.s., e cila gjendet **në lindje të Damaskut**. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, që deklaroi se ai është Mesihu i Premtuar ka lindur dhe jetuar dhe është varrosur në një qytezë të quajtur Kadian, i cili gjendet në Panxhab, në veri të Indisë, vend ky është pikërisht në lindje të Damaskut.

Me **minaren e bardhë** nuk duhet të kuptojmë ndonjë minare fizike, sepse në kohën e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. s'ka qenë aspak ndonjë traditë për ndërtimin e minareve, dhe as në Damask nuk gjendej atëherë ndonjë minare e tillë. Minarja e xhamisë El-umavi që është në lindje të qytetit Damask, u ndërtua në shekullin tetë pas *hixhrit* (mërgimit) të Profetit Muhammed s.a.v.s. Vallë, a nuk duket absurde zbritja e një njeriu prej qiellit, që nuk mund

të zbresë dot në tokë, por vetëm deri në majë të një minareje, nga e cila pritësve u duhen shkallët që ta zbresin atë në tokë! Në fakt, vetë koha tregoi kuptimin e vërtetë të kësaj profecie. Minarja është simboli i lajmërimit ose i përcjelljes së mesazhit. Sot, falë mjeteve të reja të komunikimit, mesazhi i Islamit të vërtetë dhe drita e saj e bardhë mund të përhapen në të gjitha anët e botës.

Dy çarçafë të verdhë kanë kuptimin metaforik. Njeriu habitet duke menduar se çfarë nevojë kishte për të treguar edhe ngjyrën e çarçafëve të tij? Nuk është e mundur që në një profeci kaq të rëndësishme të përshkruhen gjërat kaq sipërfaqësore që nuk kanë asnjë kuptim. Me të vërtetë, të gjitha këto duhen shpjeguar në bazë të shpjegimit të ëndrrave. Sipas *tabirit* të ëndrrave, ngjyra e verdhë simbolizon sëmundjen. Kështu që, dy çarçafë të verdhë kanë kuptimin që Mesihu i Premtuar a.s. fizikisht do të jetë i sëmurë

nga dy sëmundje, të cilat i jepnin më shumë vlerë punës madhore që do të bënte ai në mbështetjen e fesë Islame. Ashtu siç rritet vlera e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. nga fakti se ai pavarësisht ka qenë i pashkolluar, por nëpërmjet Kuranit Famëlartë dhe urtësisë së tij, i dha botës thesare të pafundme dijesh. Hazret Mirza ➤



Ghulam Ahmedi, sipas profecisë vuante nga diabeti dhe migrena, por megjithëkëtë, ai shkroi rreth 85 libra me argumente të ndritura për fenë Islame.

Fjalët **“krahët e tij të vendosura mbi krahët e engjëjve”** gjithashtu nuk duhet t'i marrim fizikisht, pasi engjëjt nuk i përkasin botës fizike dhe se asnjë i dërguar i Zotit nuk vjen në këtë mënyrë. Krahët e tij do të jenë të vendosura mbi krahët e engjëjve do të thotë, Mesihu i Premtuar a.s. do të gjejë mbështetjen dhe ndihmën e njerëzve të mirë, siç ishin eshabët e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}

Kjo profeci mund të kuptohet edhe nga një aspekt tjetër. Një njeri që zbret i gjallë nga qielli me engjëjt fizikë, kush do ta kundërshtojë atë?! Ndërsa në Kuranin Famëlartë, Allahu xh.sh. thotë:

“Ah, sa mjerim për njerëzit! Kurdo që u vjen ndonjë i dërguar, ata nuk bëjnë tjetër vetëm se tallen me të”

(Jasin 36:30)

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Pra kjo është një shenjë prej Zotit se çdo profet është përqeshur dhe përbuzur. Por njeriun, që duke u shoqëruar me engjëjt, zbret nga qielli, në mesin e të gjithë njerëzve, kush do ta përqeshë atë? Edhe me këtë argument, një njeri i mençur mund të arrijë të kuptojë se zbritja fizike e Mesihut të Premtuar nga qielli është një besim i gabuar.”

(Ruhani Khezain, vëll. 20: Tadhkiratush Shahadatain faqe. 67)

Dexhalli dhe Jaxhuxhi e Maxhuxhi:

Dexhalli dhe Jaxhuxhi e Maxhuxhi janë dy emra të ndryshëm, por përfaqësojnë një popull, që e mohon Zotin qoftë kategorikisht qoftë nga veprimet e tij. Dexhalli tregon gjendjen fetare të atij populli, ndërsa Jaxhuxhi e Maxhuxhi fuqinë materiale nëpërmjet të cilit ai do të mbizotërojë botën. Ashtu siç keni lexuar më parë, që në kohën e Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar, feja krishtere do të jetë e mbizotëruar me dogmat e saj të gabuara dhe ky popull nuk do të ishte tjetërkush përveç vendeve perëndimore ku mbizotërohet feja e krishterë.

Dexhalli fjalë për fjalë, do të thotë “mashtues i madh, rrënacak, ai që fshen të vërtetën”. Në surenë Merjem të Kuranit thuhet se gënjeshtria më e madhe është pikërisht shpifja e atij populli, i cili thotë se Zoti ka një djalë. Në këtë kuptim, emërtimi Dexhall tregon aspektin fetar të vendeve perëndimore. Ndërsa Jaxhuxhi dhe Maxhuxhi janë fjalë të prejardhura nga rrënja **أَخْجَجًا** “axh-xha” dhe “axhixhan” d.m.th. flaka dhe afshi i zjarrit, djegie e fuqishme.^a Ky emërtim tregon se ato vende do të përdornin shumë zjarrin apo enërgjinë. Sot, të gjitha makineritë dhe aparaturat funksionojnë prej ndonjë enërgjie, e cila mund të quhej një lloj zjarri. Shumica e këtyre makinerive është shpikur

nga vendet perëndimore. Një kuptim tjetër i këtij emërtimi është se ky popull do të ishte i zgjuar por njëkohësisht edhe arrogant, sepse sipas Kuranit Famëlartë, arroganca është vetia e zjarrit. Në një vend thuhet se shejtani u tregua arrogant sepse është krijuar nga zjarri.

Në hadithe, shpesh është përmendur që në ditët e vona, Dexhalli do ta mbizotërojë botën, ndërsa Kurani, në suren El-Enbija dhe shumë hadithe të tjera thonë të njëjtën gjë edhe për Jexhuxhët e Maxhuxhët, me fjalët “*ata do të shpejtojnë prej çdo lartësie*”.^b Kjo tregon qartazi se bëhet fjalë për të njëjtit njerëz, sepse dy popuj të ndryshëm nuk mund të mbizotërojnë njëri-tjetrin njëkohësisht. Le të shohim tani më në detaje se Hazret Profet Muhammedi s.a.v.s. çfarë ka thënë rreth këtij populli.

Shenjat e Dexhallit që dha i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}, po t’i shohim me vëmendje, zemra nuk do të pushojë së lavdëruari ndaj Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, sepse aty shohim se me çfarë simbolesh të përsosura e me çfarë fjalësh të qarta ka paralajmëruar për shoqërinë e sotme dhe fuqitë materialiste, të cilat mbizotërohen nga vendet që ndjekin dogmat e gabuara të fesë së krishterë. Mesihu i Premtuar do t’i luftonte përmes argumenteve të pathyeshme të Kuranit. Veç kësaj, nga lutja dhe fuqia e tij shpirtërore, ai do të shpëronte njerëzit nga ndikimet e asaj shoqërie materialiste.

Tiparet kryesore të Dexhallit siç i përshkruan Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}

- Do të jetë qorr nga syri i djath-të (d.m.th. i verbër shpirtërisht).
- Syrin e majtë do ta ketë shumë të mprehtë (materialisht larg-pamës).
- Në ballë do të ketë shkruar k-f-r (d.m.th. i pafe. Kjo tregon se ato vende edhe pse ndjekin fenë e krishterë, në veprimet e tyre nuk i përkasin aspak një populli fetar).
- Më aftësi të jashtëzakonshme fizike (shumë i zhvilluar në teknologji).
- Do të bëjë gjakderdhje të mëdha (shkakton luftëra).
- Do të lëvizë si re shiu (do të ketë mjete të shpejta të transportit që do ta zëvendësojnë devenë. Këtë profeci e tregon edhe hadithi i Muslimit që keni lexuar më parë në këtë artikull).
- Do ta urdhërojë qiellin të lëshojë shi dhe tokën të nxjerrë të korra.
- Do të nxjerrë thesare edhe nga shkretëtira.
- Sasi e madhe ushqimi dhe uji do ta shoqërojnë atë.
- Do të paraqesë një xhenet, i cili në të vërtetë do të jetë xhehenem.
- Xhenetin e vërtetë do ta quajë xhehenem.
- Ai do ta pushtojë gjithë botën.
 - Për ta mposhtur Dexhallin, lexoni ajetet e para dhe të fundit të suresë El-Kehef. ➤

(Ajetet e para dhe të fundit të suresë El-Kehef flasin vetëm për dogmat e gabuara të krishtërimin dhe për shoqërinë materialiste që vjen si pasojë e tyre).

Gomari i çuditshëm i Dexhalit

Dexhalli do të vijë me gomarin e tij të çuditshëm që në fakt janë mjetet transportit të kohës moderne. Shenjat e këtij gomari, mund t'i lexoni në artikullin "Zbulimi i së padkushmës dhe Kurani Famëlartë" në faqet 42-44, të këtij numri të "Vërtetësisë")

Dhjetë shenjat para ardhjes së Orës:

عَنْ حُذَيْفَةَ ابْنِ أَسِيدٍ الْغِفَارِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ إِطَّلَعْتُ
النَّبِيَّ عَلَيْهِمَا وَتَحَنُّنًا نَتَذَكَّرُ فَقَالَ مَا تَذَاكُرُونَ قَالُوا
نَذَكُرُ السَّاعَةَ قَالَ إِنَّهَا لَنْ تَقُومَ حَتَّى تَرَوْنَ قَبْلَهَا عَشْرَ
آيَاتٍ فَذَكَرَ الدُّخَانَ وَالذَّجَالَ وَالدَّابَّةَ وَطُلُوعَ الشَّمْسِ
مِنْ مَغْرِبِهَا وَتُرُوقَ عِيسَى بْنِ مَرْيَمَ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ
وَسَلَّمَ وَبِأَجُوجَ وَبِأَجُوجَ وَثَلَاثَةَ خُسُوفَ حَسَفَ
بِالْمَشْرِقِ وَحَسَفَ بِالْمَغْرِبِ وَحَسَفَ بِجَزِيرَةِ الْعَرَبِ
وَإِحْرَاقَ ذَلِكَ نَارِ تَخْرُجُ مِنَ الْيَمِينِ تَنْظُرُ النَّاسُ إِلَى
مَحْشَرِهِمْ

Hudhejfa bin Asid Ghefari r.z. tregon: "Një herë erdhi Profeti Muhammed s.a.v.s. tek ne ndërkohë ne po kuvendonim". Ai pyeti: "Për çfarë po bisedoni?" Ata thanë: "Po bisedojmë për Orën (kiametin)". Ai tha: "Kiameti nuk do të vijë

derisa të shikoni dhjetë shenja". Ai i përmendi: "Tymi, Dexhalli, Dab-bah (insekti), lindja e diellit nga Perëndimi, zbritja e Isait paqja e Allahut qoftë mbi të, Jaxhuxhi e Maxhuxhi, tri tërmete (hasf): një në Lindje, një në Perëndim dhe një në gadishullin arab dhe në fund do të shfaqet një zjarr nga Jemeni që do t'i përcjellë njerëzit deri në vendin ku do të grumbullohen ata."

(Muslimi, Kitabul Fiten, bab fil ajatil lati takumu kebles-sa'ah)

SHPJEGIM:

Sipas Imam Hakimit, ky hadith është *sahih*.^c Në një hadith tjetër këto shenja janë renditur pak më ndryshe. Sidoqoftë, këtu do të shpjegojmë ashtu siç kanë ndodhur ato radhazi.

I. Ardhja e Hazret Isait a.s.:

është e qartë vetë nga hadithi se shenja ardhjes së Mesihut të Premtuar a.s. është në qendër dhe shenjat e tjera sillen rreth saj. Nëse plotësohen shenjat e tjera, do të nënkuptohet se edhe shenja e ardhjes së Mesihut të Premtuar është plotësuar, deklarimi për të cilin, është bërë nga Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmedia. Shumë myslimanë gabimisht janë duke pritur të vijë i njëjti Isa që ka kaluar dy mijë vjet më përpara. Asnjë profet nuk vjen nga qielli dhe ardhja e dytë e një profeti të mëparshëm do të thotë ardhja e një njeriu që do të kryejë të njëjtën punë që ka bërë i vjetri. Pra, ngjashmëria e plotë është ajo që u jep dy gjërave apo dy njerëzve një emër.

NUMRI IV

II & III. Dexhalli dhe Jaxhuxhi e Maxhuxhi: Janë sqaruar në shpjegimin e hadithit pak më lartë.

IV. Lindja e diellit nga Perëndimi: në kohën e Mesihut të Premtuar, një kuptim i kësaj profecie do të thoshte se dielli i dijës së vërtetë, pra dielli i Islamit, do të ngrihej nga Perëndimi. Kjo në një rën anë tregon se në kohën e tij, Islami do të përhapet në vendet perëndimore, ndërsa në anën tjetër paralajmëron humbjen fetare të vendeve të krishtera. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Lindja e diellit nga Perëndimi, siç Zoti më ka treguar në një ëndërr, do të thotë që vendet perëndimore do të përfitojnë nga dielli i së vërtetës dhe edhe ato do ta pranojnë fenë islame.”

(Përmbledhur nga Izala auham,

Rruhani Khazain, vëll. 3, f. 376-377)

Në një vend tjetër, ai tha:

“Nëpërmjet meje Allahu e ringriti diellin e Islamit nga Perëndimi, i cili po perëndonte.”

(Hytheja Ilhamiah, Rruhani Khazain, vëll. 16, f. 253)

Dikush do të mund ta mohonte këtë deklaram njëqind vjet përpara nga sot, kur Xhemati Mysliman Ahmedia sapo kishte nisur misionin e tij në Perëndim. Por, sot çdo ditë e më shumë shfaqet vërtetësia e kësaj profecie nga fakti se me çfarë shpejtësie Ahmediati po përhapet në vendet e Evropës.

V. Tymi: me tymin, në kohën

e Profetit Muhammed^{s.a.v.s.}, mysli-manët kishin kuptuar krizën e urisë që kishte rënë në gadishullin arab (*Buhariu, Kitabut Tefsir, Sureja Ed-Duhan*). Edhe në Bibël është përmendur që, në ditët e vona do të ketë krizë urie. Veç kësaj, edhe nga kuptimi i drejtpërdrejtë, kjo profeci është plotësuar në shumë mënyra: qoftë si tymi i tmerrshëm që del nga bomba atomike apo tymi stërshqetësues i kohës sonë që del nga industritë dhe makinat, që gjithnjë e më shumë bëhet kërcënues për mjedisin tonë duke shkaktuar ngrohje globale.

VI. Dab-bah: fjalë për fjalë, në arabisht, do të thotë insekt ose kafshë. Në Kuranin Famëlartë përmendet që kur të përmbushet fjala e Zotit kundër mohuesve, domethënë kur ata nuk e besojnë fjalën e Zotit edhe pse sqarohen me argumente të qarta, atëherë Zoti do të nxjerrë një krijesë e cila do t'i pickojë ata duke lënë një shenjë të qartë se ata kanë qenë mohues të së vërtetës (*En-Neml 27:83*). Në një hadith që transmetohet nga Neuas bin Sam'an përmendet si paralajmërim që në kohën e Mesihut të Premtuar kur ai dhe pasuesit e tij do të përndiqen nga kundërshtarët, atëherë një insekt do t'i kapë në qafat e tyre, nga i cili shumica prej tyre do të vdesin.^d Dijetari i madh Tur Betshi (vdiq në vitin 630 pas hixhretit) komentoi që insekti do të thotë insekti i murtajës.^e Edhe në ➤

librat e shitëve përmendet që në kohën e Imam Mehdiut do ketë edhe vdekje të kuqe (domethënë luftëra) dhe vdekje të bardhë që u komentua të ketë vdekje nga murtaja.^f

Sipas paralajmërimit të Profetit Muhammed^{s.a.v.s.}, në vitin 1894 ndodhën shenjat qiellore të eklipsit diellor dhe hënor në datat e caktuara gjatë muajit të ramazanit, shenjë kjo që do të ndodhte për vërtetësinë e Imam Mehdiut vetëm një herë në gjithë historinë e njerëzimit. Mirza Ghulam Ahmedi, Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar u njoftua prej Zotit që nëse njerëzit nuk do të përfitojnë nga kjo shenjë hyjnore, atëherë ata duhet të presin një ndëshkim të llahtarshëm. Në vitin 1898, ai pa në një ëndërr që disa engjëj, në vende të ndryshme të provincës Panxhab, po mbillnin pemë të zeza. Ai gjithashtu njoftohet që ato pemë janë të murtajës, e cila së shpejti do të përhapej në rajon. Në një vizion (*keshf*) ai pa një insekt, për të cilin, ai u informua se ishte insekti i murtajës që u quajt “*Dab-batul ard*” insekti i tokës sepse murtaja vjen nga insektet tokësore. Kjo ishte edhe si metaforë që, kur myslimanët dhe dijetarët e tyre do të anojnë më shumë nga toka, atëherë ata do t’i përngjajnë këtij insekti tokësor.^g

Kështu që, sipas paralajmërimit u shfaq “insekti tokësor” dhe në vitin 1896 murtaja filloi nga Mumbai dhe me egërsi të plotë erdhi gjer në provincën Panxhab

ku deri në vitin 1906, shkaktoi një kërdi të paparë në historinë e rajonit. Kjo llahtari nuk do të qetësohej tërësisht edhe për tridhjetë vite të ardhshme derisa të shkaktonte 12.5 milionë njerëz në gjithë Indinë.^h Në provincën e Panxhabit qindra njerëz varroseshin çdo javë. Por, e çuditshmja ishte se asnjë ahmedian nuk kishte pësuar vdekje nga ajo, e cila ishte bërë një kasaphanë për kundërshtarët e Mesihut të Premtuar a.s. Për këtë, Zoti e kishte njoftuar parakohe me fjalët “**Unë do të mbroj çdokënd që jeton në shtëpinë (xhematin) tënde**”.ⁱ Madje, si shenjë e vërtetësisë së tij, ai i kishte urdhëruar anëtarët e Xhematit të mos imunizoheshin nëse qeveria nuk i detyronte. Është fakti se pikërisht gjatë periudhës së murtajës, Xhemati u shtua shumë në numër. Sipas gazetës “*El-Hakam*”, deri në vitin 1902, ahmedianët ishin shtuar deri njëqind mijë anëtarë. Deri në vitin 1904, kjo shifër shkoi në dyqind mijë duke arritur pastaj në katërqind mijë deri në vitin 1906, kur në provincën e Panxhabit murtaja ishte dobësuar. Një gjë tjetër interesante ka qenë se murtaja nuk pushoi deri sa Hazret Mirza Ghulam Ahmedi a.s. dha paralajmërimin që ajo do të përfundonte.

VII, VIII e IX. Tri hesfë (tërmete): hadithi thotë se do ndodhin tri *hesfë*: një në Lindje, një në Perëndim dhe një në Gadishullin arab. Në arabisht,

fjala *hesf* do të thotë fundosje e diçkaje në tokë, domethënë të shkaktohet tërmet. Edhe në Kuranin Famëlartë, kjo fjalë është përdorur mjaft herë me këtë kuptim.^j

Kështu që, me tri *hesfë*, mund të konsiderohen edhe tërmetet në Lindje, në Perëndim dhe në Gadishullin arab që është në qendër të Tokës. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi u njoftua prej Zotit me këtë shpallje: “Në botë erdhi një alarmues, por bota nuk e pranoi atë. Por, Zoti do ta pranojë dhe do ta shfaqë vërtetësinë e tij me sulme shumë të ashpra”.^k Madje, veçanërisht për tërmetet fragmenti i tij i mëposhtëm tërheq fuqishëm njeriun që e do të vërtetën që të mendojë edhe një herë, para se ta mohojë vërtetësinë e këtij robi të Zotit, i cili thotë:

“Mbajeni në mend se Zoti më njoftoi në mënyrë të përgjithshme për tërmete. Prandaj, kuptojeni mirë se ashtu siç ishte parashikuar nga unë, Amerika dhe Evropa pësuan tërmete. Edhe Azia nuk do të shpëtojë nga ato. Madje disa tërmete do të shfaqin pamje të Kiametit dhe do të rrjedhin lumenj me gjak nga vdekja. As edhe kafshë edhe zogj nuk mund t’i shpëtojnë dot kësaj vdekjeje. Toka do të pësojë një shkatërrim të atillë, saqë njeriu nuk do ta ketë dëshmuar që kur ka lindur ai

në këtë botë. Shumë vende do të pësojnë një shkatërrim total, duke lënë pas një pamje sikur të mos kishte jetuar njeri në ato vende. Bashkë me këto, do të vijë edhe katastrofa të tjera dhe tokën e qiellit do të zërë një llahtari e tillë që dija njerëzore nuk do të ketë njohur më parë fenomene të tilla. Atëherë njerëzit do të frikësohen dhe thonë: Çfarë po ndodhë?! Shumë prej tyre do të shpëtojnë dhe shumë prej tyre do të asgjësohen. Ato ditë janë pranë, në të vërtetë po shoh se janë te dera, kur bota do të dëshmojë një pamje kiameti. Do të ndodhin jo vetëm tërmete, por edhe katastrofa të tjera të frikshme, disa prej tyre nga qielli dhe disa nga toka. E gjithë kjo do të ndodhë sepse njeriu ka hequr dorë nga adhurimi i Zotit të Vërtetë dhe zemrat e njerëzve, synimet dhe ëndërrta, janë përqendruar të gjitha te bota. Nëse unë nuk do të kisha ardhur, këto fatkeqësi mund të ishin vonuar disi, por me ardhjen time janë shfaqur gjithashtu planet e tërbuara sekrete, që ishin në heshtje nga një periudhë e gjatë, siç ka thënë Zoti në Kuran:

“Ne kurrë nuk dënojmë ndonjë popull derisa të mos dërgojmë ndonjë Profet tek ai.” (El-Isra 17:16)

Ata që do të pendohen do të jenë të sigurt dhe ata që i frikësohen Zotit përpara sesa ndonjë fatkeqësi t’i përf-

shijë ata, ndaj atyre do të tregohet mëshirë. A mendoni se ju mund të rrini në paqe nga këto tërmete, ose se ju mund të ruani veten nëpërmjet mjeteve tuaja? Kurrsesi jo! Sepse atë ditë, mjetet e njeriut do të marrin fund. Mos mendoni se Amerika dhe rajonet e tjerë kanë përjetuar tërmete të forta dhe se vendi juaj është i sigurt. Unë druaj se ju mund të vuani ndoshta tortura edhe më të mëdha. Nuk je e sigurt, o Evropë, as ti, o Azi. O banorët e ishujve, asnjë perëndi e krijuar nga ju nuk do të jetë e aftë t'ju ndihmojë. Unë shikoj qytete që shemben dhe banime në rrënoja. Ai Zot i Vetëm heshti për një periudhë të gjatë. Vepra të këqija u bënë përpara syve të Tij dhe Ai u tregua i duruar. Por tani Ai do të shfaqet në një formë të tmerrshme. Ai që ka veshë le të dëgjojë se koha nuk është e largët. Unë jam përpjekur t'i mbledh të gjithë nën sigurinë e Zotit, por edhe dekretet hyjnore duhet të plotësoheshin. Singërisht ju them të vërtetën, që po i afrohet radha edhe këtij kombi. Ju do të jeni dëshmitarë të kohës së Nuhit (Noas) dhe sytë tuaj do të shikojnë atë që ndodhi në tokën e Lutit (Lotit). Por Zoti është i ngadaltë në zemërimin e Tij. Pendohuni që t'u tregohet mëshirë. Ai që braktis Zotin është një insekt dhe jo njeri, dhe ai që nuk i frikësohet Atij është i vdekur

dhe jo i gjallë.”

(Rruhani Khazain, vol. 22, Hakikatul Vahi, f. 267-269; botimi i parë: 15 maj, 1907)

Cfarë shenjash ka dhënë vetë Hazret Isai^{a.s.} për ardhjen e tij?

Në Dhiatën e Re shkruhet:

Atëherë u tha atyre: “Do të ngrihet kombi kundër kombit; dhe mbretëria kundër mbretërisë; do të ngjajnë tërmete të mëdha, zi buke dhe murtaja në vende të ndryshme; do të ndodhin edhe dukuri të llahtarshme dhe shenja të mëdha nga qielli. Por, para të gjitha këtyre gjërave, do të vënë dorë mbi ju dhe do t'ju përndjekin dhe do t'ju dorëzojnë në sinagoga e do t'ju futin në burg; dhe do t'ju nxjerrin përpara mbretërve dhe guvernatorëve për shkak të emrit tim, por kjo do t'ju japë rastin që të dëshmoni. Ta vini, pra, në zemrën tuaj që të mos mendoni më parë se si do përgjigjeni për t'u mbrojtur, sepse unë do t'ju jap një gojë e një dituri të tillë të cilën të gjithë kundërshtarët tuaj nuk do të jenë në gjendje ta kundërshtojnë ose t'i rezistojnë. Dhe ju madje do t'ju tradhtojnë edhe prindërit, dhe vëllezërit, dhe farefisi dhe miqtë; dhe disa prej jush do t'i vrasin. Dhe të gjithë do t'ju urrejnë për shkak të emrit tim. Por as edhe një fije floku e kokës suaj nuk do t'ju humbasë. Me durimin tuaj ju do t'i fitoni shpirtrat tuaj”. (Luka 21:10-19)

Para se të vazhdojmë, është me rëndësi të përmendet edhe fakti se sot ahmadianët po përndiqen dhe persekutohen në vendet islamike si Pakistani, Afganistani, Indonezia, vendet arabe etj,

vetëm për shkak se ata e pranuan Mesihun e Premtuar dhe Imamin e Kohës. Janë lëshuar vendime që ahmadianët nuk janë myslimanë, dhe si të tillë duhet të vriten. Në Pakistan, gati çdo muaj vritet ndonjë ahmadian. Madje, më 28 maj të vitit të kaluar (2010), 92 ahmadianë të pafajshëm janë vrarë barbarisht me sulme terroriste, kur ata po falnin namazin e së premtes në dy xhami të qytetit Lahor. Pra, parashikimi i Hazret Isait po vërtetohet gjithnjë e më shumë, sepse vetëm për shkak të emrit të Mesihut të Premtuar po bëhen gjitha këto persekutime.

Duke iu rikthyer temës së tërmeteve, në vijim do t'ju tregojmë disa fakte tronditëse, që ndodhën mu ashtu siç ishin parashikuar nga të dy Mesihët.

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, Mesihu i Premtuar a.s. ka lindur më 13 janar, të vitit 1835 dhe ka ndërruar jetë më 26 maj, të vitit 1908. Në qoftë se do të numërojmë vetëm tërmetet e fuqishme të botës që shkaktuan të paktën 50 mijë viktima, na del që nga shekulli i nëntë deri në

vitin 1835, e cila është një periudhë njëmbëdhjetë shekullore, bota pësoi 11 tërmete aq të forta. Gjatë jetës së Hazret Mesihut të Premtuar a.s. nuk shënohet ndonjë tërmet i tillë. Ndërsa nga viti 1908, kur ka ndërruar jetë ai, e gjer më sot, domethën vetëm në një shekull, bota pësoi përsëri 11 tërmete të tilla. Kjo ishte sipas kronikës së tërmeteve që jep Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (USGS) në webfaqen e saj.¹

Tërmetet më të mëdha para vitit 1835

Nr.	Data	Vendi	Vdekje	Ballë
1.	1783-02-04	Kalabri, ITALI	50,000	
2.	1755-11-01	Lisbon, PORTUGALI	70,000	8.7
3.	1727-11-18	Tabriz, IRAN	77,000	
4.	1693-01-11	Sicily, ITALI	60,000	7.5
5.	1667-11	Shemakha, KAUKAZIA	80,000	
6.	1556-01-23	Shaanxi (Shensi), KINË	830,000	~8
7.	1290-09-27	Chihli, KINË	100,000	
8.	1268	AZI E VOGËL	60,000	
9.	1138-08-09	Aleppo, SIRI	230,000	
10.	893-03-23	Ardabil, IRAN	150,000	
11.	856-12-22	Damghan, IRAN	200,000	

Tërmetet më të mëdha pas vitit 1835

Nr.	Data	Vendi	Vdekje	Ballë
1.	1908-12-28	Messina, ITALI (Ishte ndierë edhe në Shqipëri)	72,000	7.2
2.	1920-12-16	Haiyuan, Ningxia (Ning-hsia), KINË	200,000	7.8
3.	1923-09-01	Kanto (Kwanto), JAPONI	142,800	7.9
4.	1948-10-05	Ashgabat (Ashkhabad), Turkmanistan (Turkmenija, BRSS)	110,000	7.3
5.	1970-05-31	Chimbote, PERU (Amerika Jugore)	70,000	7.9
6.	1976-07-27	Tangshan, KINË	255,000	7.5
7.	1990-06-20	IRAN PERËNDIMOR	50,000	7.4
8.	2004-12-26	SUMATRA	227,898	9.1
9.	2005-10-08	PAKISTAN	86,000	7.6
10.	2008-05-12	Eastern Sichuan, KINË	87,587	7.9
11.	2010-01-12	HAITI	222,521	7.0

Ai që ka pak frikë ndaj Zotit, shpresojmë që do të mendojë seriozisht rreth këtij paralajmërimi të llahtarshëm. Këtu kemi folur vetëm për murtajën dhe tërmetet. Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë **“do të vijnë edhe katastrofa të tjera dhe tokën edhe qiellin do të zërë një llahtari e tillë që dija njerëzore nuk do të ketë njohur më parë fenomene të tilla”**. Tsunamitë, dy Luftëra Botërore, SIDA dhe shumë katastrofa të tjera natyrore e bëjnë të mendojë njeriun që pse vallë Zoti i kishte kursyer të gjitha për këtë shekull! Por, Mesihu i Kohës paraprakisht e kishte lajmëruar këtë në: **“E gjithë kjo do të ndodhë, sepse njeriu ka hequr dorë nga adhurimi i Zotit të Vërtetë dhe zemrat e njerëzve, synimet dhe ëndërrat janë përqendruar të gjitha te bota”**.

X. Zjarri nga Jemeni që do t'i përcjellë njerëzit deri në ven-

din ku do të grumbullohen ata: Në një transmetim tjetër thuhet që ky zjarr do të bjerë nga toka e Adnit (një qytet i Jemenit), i cili më në fund do të grumbullojë gjithë njerëzit, e madje edhe insektet. Kjo shenjë nga përshkrimi i saj duket të jetë shenja e fundit, që mbase do të shfaqë para ditës së fundit (Allahu e di më së miri). Edhe dijetari i famshëm Hafiz Mulla Ali shkruan se ky grumbullim do ta shkaktojë edhe grumbullimin e fundit të mosbesimtarëve.^m Zoti i Madhërishëm e di më mirë se në ç'formë dhe në ç'përmasa do të jetë ai. Ndaj, është detyrë e çdokujt që ta kërkojë Imam Mehdiun dhe Mesihun e Premtuar^{a.s.}, sepse shumica e paralajmërimeve që tregojnë shenjat e ardhjes tij, tashmë janë plotësuar fjalë për fjalë. Zoti i udhëzofte gjithë njerëzit për rrugën e drejtë! Amin

Samad Ghori

Bibliografi

a Fjalori “Lisanul Arab” nën fjalën “axh-xha” dhe “maxhuxh”

b El-Enbija 21:97

c “Mustadrik Hakim”, vëll. 4, f. 428, shtypshkronjë “En-nesr El-hadithijah”, Rijad

d “Sahih Muslim”, Kitabul Fiten, Bab Dhikrid Dexhall

e “Akaid Muxhadidijah Es-Siratus Savijji”, Kutub Menzil Nekshbendjiah, Kashmiri Pazar, Lahor

f “Ikmalud Din”, f. 981, shtypshkronjë “Hejderiah” Nexhef

g Mirza Ghulam Ahmedi, “Nuzul-ul-Mesih”, f. 39, Rruhani Khezain, vëll. 18, f. 416,421

h Wikipedia nën fjalën “Third Pandemic”

i “Kishtië Nuh” (Varka e Nuhut) f. 10, Rruhani Khezain, vëll 19, f. 12

j P.sh. En-Nahl 16:46; El-Isra (Beni Israil) 17:69; El-Keses 28:82; El-Ankabut 29:41; El-Mulk 67:17; etj

k “El-Vesijat” f. 5, Rruhani Khezain, vëll. 20, f. 303

l *Burimi i kronikës: http://earthquake.usgs.gov/earthquakes/world/most_destructive.php*

m “Mirkatul Mafatih Sherrh Mishkatil Masabih”, vëll. 5, f. 188, shtypshkronjë “Mejmanah”, Egjipt

Rreth paralajmërimeve të KURANIT FAMËLARTË



*Thënie të Hazret Mirza Ghulam Ahmedit,
Mesihut të Premtuar^{a.s.}*


Hazret Mesihu i Premtuar^{a.s.}, duke komentuar suren *Et-Tekuir*, thotë:

“Dhe kur devetë, me barrë dhjetëmuajshe, do të braktisen” (El-Takvir 81:5)

“Ndër shenjat e kohës së *dexhalit* janë ... kur shkenca dhe teknologjia do të përparojnë. Disa shpikje dhe kryevepra janë përmendur si shembuj në këtë sure.

Ato janë ... *“ue idhel isharu ut-tilet”* (Et-Tekuir 81:5), kur devetë do dalin jashtë përdorimit sepse ato nuk do të kenë asnjë vlerë. Në arabisht fjala *“ishar”* përdoret për devetë me barrë, të cilat arabët i vlerësonin shumë.

Është shumë e qartë se ky ajet nuk ka asnjë lidhje me Kiametin, sepse koha e Kiametit nuk është ajo kohë kur mashkulli i devesë mbars devenë, por ajeti shenjon shpikjen e trenit. Kurani flet veçanërisht për devetë me barrë për të treguar



lidhjen e fortë të kësaj shenje me këtë botë, e jo me ditën e kiametit.”

(Ruhani Khazain, vol. 6, “Shehadetul Kuran”, f. 318 Rabwah, Pakistan, 2008, botimi i parë: 1893)

“Edhe Profeti Muhammed^{s.a.v.s.}, duke shpjeguar kohën e ardhjes së Mesihut të Premtuar, thotë: وَلْتَرَكُوا الْقِلَاصُ فَلَا يُسْمَعُ عَلَيْهَا që do të thotë, në kohën e Mesihut të Premtuar njerëzit nuk do të

udhëtojnë më me deve.

(“Sahih Muslim”, Kitabul iman, bab nuzul Isa ibni Merjem)

Pra, asnjeri nuk do të udhëtojë me deve, që do të thotë se do të shpikëj një mjet tjetër transporti, si treni. Pse është përmendur deveja? Kjo sepse pikërisht ajo ishte mjeti kryesor i arabëve për transport, me të cilin ata udhëtonin duke marrë edhe plaçkat e shtëpive të tyre të vogla. Dihet, nëse përmendët një kafshë e madhe bartëse si deveja, kafshët e tjera bartëse vetë nënkuptohen.

Shkurt, paralajmërohet se do të shpiken mjetet e tilla të transportit, të cilat do të zëvendësojnë edhe devetë... A mund të ketë shenjë më të qartë se kjo! Ajeti i Kuranit flet për ditët e vona duke thënë: “*kur devetë të braktisen*”, dhe kjo tregon shumë qartë shpikjen e trenit. Pra, si ajeti i Kuranit ashtu edhe hadithi i Profetit Muhammed^{s.a.v.s.} paralajmërojnë për të njëjtën kohë. Në hadith, nga që kjo shenjë është përmendur në lidhje me ardhjen e Mesihut të Premtuar, atëherë duhet ta kuptojmë se edhe ajeti flet për shenjat e ardhjes së Mesihut të Premtuar.”

(*Ruhani Khazain, vol. 6, “Shehadetul Kuran”, f. 308-309, Rabwah, Pakistan, 2008, botimi i parë: 1893*)

“Zoti e dinte shumë mirë se paralajmërimi i revolucionit madhështor përmes deveve do të ndikonte shumë në zemrat e arabëve dhe se tek ata, nuk do të kishte aq vlerë ndonjë paralajmërim tjetër sesa ky. Për këtë arsye kjo profeci është përmendur në Kuranin Famëlartë, përbushja e së cilës duhet t’i bënte besimtarët që të brohorisnin me gëzim, se Kurani i Madhërishtëm paralajmëroi për kohën e fundit, kohë e cila është e Mesihut të Premtuar, e *jaxhuxhit* dhe e *maxhuxhit* dhe e *dexhalit*. Deveja, shoqëruesja e vjetër e arabëve, me të cilën ata udhëtonin nga Meka në Medinë dhe gjer në Siri shkonin për tregti, do të ndahet nga ata përgjithmonë. *Subhanallah!* (lavdi Zotit) Çfarë profecie e qartë është kjo! Më do zemra që të hedh parulla nga gëzimi, sepse kjo është një shenjë shumë e madhe se Kurani Famëlartë, Libri ynë i dashur, është nga Zoti. Një shenjë kaq e hapur nuk përmendet as në *Tevrat*, as në *Ungjill* dhe as në ndonjë libër tjetër

të botës.”

(*Ruhani Khazain, vol. 17, “Tohfa golarvia” f. 196-197, Rabwah, Pakistan, 2008, botimi i parë: shtator 1902*)

“*Dhe kur njerëzit do të bashkohen*” (*El-Takvir 81:8*)

“Profecia e bashkimit të njerëzve është përbushur në shumë aspekte. Në një aspekt ky bashkim shpjegohet me shumë shembuj, si telegrafi, i cili u vjen në ndihmë njerëzve në kohë të vështira. Ai sjell lajme nga njerëz të dashur dhe nga vendet e largëta. Madje ndodh që lajmi vjen te kërkuesi, para se të lëvizë ai nga vendi i tij, duke iu mundësuar atyre të komunikojnë, sikur ata takohen me njëri-tjetrin, pa pasur ndonjë pengesë prej tyre.

Bashkimi i njerëzve në një tjetër aspekt tregohet se rrugët tokësore dhe detare do të bëhen pa frikë dhe vështirësitë e udhëtimit do të zhduken, në mënyrë që njerëzit të udhëtojnë pa asnjë frikë nga një shtet në një shtet tjetër. Pa dyshim, në kohën tonë shtetet e ndryshme kanë lidhje të forta me njëra-tjetrën dhe njerëzit njohin njëri-tjetrin më shumë se përpara, sikur ata të takoheshin çdo ditë. Allahu i Madhërishtëm bëri që njerëzit e një vendi të takohen me njerëzit e një vendi tjetër, tregtarët ose ata që kanë zanate të ndryshme kanë krijuar lidhje me zanatçinjtë e vendeve të tjera. Ata bashkërisht përpiqen të fitojnë sa më shumë duke pësuar sa më pak humbje. Ata janë bërë bashkëveprimtarë për të gjetur çdo gjë të mirë, gëzimi, ushqimi dhe lehtësie. Gjithçka eksportohet ose importohet nga një vend në një tjetër. Pra, shihni sesi Allahu i Madhërishtëm i bashkoi njerëzit, ashtu sikur ata të jenë udhëtar të një varke.

Bashkimi i njerëzve në një aspekt tjetër u realizua nga mjetet e transportit, qofshin tokësore qofshin detare. Edhe kështu njerëzit takohen dhe bashkohen me njeri-tjetrin. Një tjetër shkak i bashkimit të njerëzve u bë edhe posta. Në kohën tonë, mjetet e postës janë përmirësuar ndjeshëm duke bërë të mundshëm dërgimin e letrave deri në skajet e botës. Me siguri do të habiteni nëse do të mendoni pak për dendësinë e dërgimit të letrave në të gjithë botën, shembullin e të cilit nuk mund ta gjeni në kaluarën. Gjithashtu, do t'ju çudisë edhe shtimi i udhëtarëve dhe tregtarëve. Pra, të gjitha këto janë mjete për t'i bashkuar njerëzit dhe shembullin e tyre nuk mund ta gjeni dot në kohët e mëparshme. Unë ju ftoj që për hir të Zotit të mendoni pak, a keni dëshmuar këto gjëra më përpara? A keni lexuar gjëra të tilla në libra të tjerë të mëparshëm?

Ajeti që paralajmëron për publikimin e librave tregon për shtypin. Vetë dëshmoni sesi Zoti ka krijuar një popull që shpiku mjetet e shtypit. Shihni se sa shumë shtypshkronja janë hapur në Indi dhe në vende të tjera! Kjo është punë e Zotit. Ai na ndihmon në përhapur fenë tonë, librat tanë dhe këshillat tona në çdo popull, në mënyrë që njerëzit t'u vënë veshin dhe të udhëzohen ... Ajeti "*Dhe kur do të grumbullohen egërsirat*" tregon se do të shtohen injorantët dhe mëkatarët, besimi dhe frika (*takua*) ndaj Zotit thuajse do të zhduken. Me sytë tuaj dëshmoni sesi pusi i mirësisë është shterrur dhe shumica e njerëzve vrapojnë pas së keqes, duke u treguar mendjelehtë për fenë, kur shikojnë diçka të keqe, e përvetësojnë, por kur shikojnë diçka të mirë, ia kthejnë shpinën. Ata i shikojnë me dashuri gjërat që

kanë shpikur mosbesimtarët, ndërsa krijimtarive të Zotit ua kthejnë shpinën."

(*Ruhani Khazain*, vol. 5, "*Aina kamalat-e-Islam*" f. 470-474, *Rabwah*, Pakistan, 2008, botimi i parë: 1893)

"Për sa i përket ajetit "*Dhe kur lumenjtë do të çahen*" (*Et-Tekuîr* 81:7), edhe këtë mund ta dëshmoni vetë sesi Allahu ka krijuar një popull që çau lumenjtë duke nxjerrë kanalet prej tyre. Ata vazhdojnë të bëjnë kështu dhe mësojnë edhe gjërat më të imta të kësaj fushe. Ata kanë sjellë lumenjtë përmes kanaleve deri në vendet e pabanuara, në mënyrë që t'i përbanojnë ato dhe të largojnë thatësira. Ata po bëjnë kështu për të përfituar sa më shumë nga toka."

(*Ruhani Khazain*, vol. 5, "*Aina kamalat-e-Islam*" f. 469-470, *Rabwah*, Pakistan, 2008, botimi i parë: 1893)

"Ka mundësi që ndër këto ajete, disa mund të kenë lidhje edhe me ditën e kiametit, por lidhja e tyre e parë është me këtë botë, sepse këto janë shenjat e ditëve të vona. Kur bota do të ketë marrë fund, atëherë çfarë shenjash mund të quhen këto! Ndoshta në mesin e myslimanëve mund të ketë edhe të pamend të tillë, të cilët duke mos kuptuar këtë sekret, këto profeci mendojnë se janë për botën e pastajme, ndërsa ato me përmbushjen e tyre në këtë botë, do të duhej t'ua forconin besimin. Të gjitha këto profeci, edhe në librat e mëparshëm, janë quajtur shenjat e kohës së Mesihut të Premtuar. Lexoni (*Dhjatën e Vjetër*) *Danieli*, kapitulli 12."

(*Tohfa golarvia*" f. 90, *fusnotë*, botimi i parë: shtator 1902)

"Kjo epokë është e tillë që Allahu i Madhërishëm ka krijuar mjetet që e kthejnë botën në një qytet



dhe kështu përmbushet profecia e Kuranit që thotë: *“Dhe kur njerëzit do të bashkohen”*. Tani, të gjitha fetë kanë dalë në fushë beteje dhe duhet që ato të përballen me njëra-tjetrën. Por, vetëm një do të jetë e vërtetë që do të triumfojë së fundmi.”

(*Gazeta El-Hakem*, 31 tetor, 1902, f. 1

“Çdo kulm ka një rënie dhe çdo zhvillim ka një prapësi. Siç e shihni edhe furtuna ndalet kur arrin malet e larta, gjithashtu, nata zbardhet në fund. Kështu thotë edhe Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë: *“Për natën kur bie terri dhe për ditën kur nisë të zbardhë”* (Et-Tekuir 81:18-19) d.m.th. *“Ne japim dëshminë e natës kur arrin të përfundojë ajo dhe të ditës kur ajo fillon të marrë frymë”*. Në këtë ajet është përmendur se agimi do të vijë medoemos kur nata e kalon kulmin e saj... Prandaj, edhe Allahu i Madhërishëm deshi që t’u japë besimtarëve edhe një herë epokën e përparimeve dhe t’u tregojë që ata kanë një Zot të Plotfuqishëm, që gjithashtu është *Rrahman* dhe *Rrahim* dhe Sundues i asaj dite kur të gjithëve do t’u jepen vlerësimet e veprave të tyre, ditën kur do të ringjallen të vdekurit.”

(*Ruhani Khazain*, vol. 18, *“E’xhazul Mesih”* f. 158-159 *Rabwah*, Pakistan, 2008, botimi i parë 20 shkurt, 1901)

“Përveç kësaj, janë përmendur edhe shenja të tjera të rënies shpirtërore, siç thotë: *“Dhe kur dielli do të paloset”* (Et-Tekuir 81:2) që do të thotë injoranca (shpirtërore), demoralizimi dhe një errësi e paparë do ta pushtojnë botën. *“Dhe kur yjet do të zbehen”* (Et-Tekuir 81:3) që do të thotë se edhe drita e devotshmërisë së dijetarëve do të zbehet. *“Dhe kur yjet do të rrëzohen”* (El-Infitar 82:3) që do të thotë dijetarët e Zotit do të marrin fund.

(Këto shenja nuk shpjegohen me kuptimin e drejtpërdrejtë) sepse nuk është e mundur që njerëzit të rrojnë në këtë botë edhe kur yjet rrëzohen përtokë. Duhet ta dini se edhe në Ungjill janë përmendur shenja të tilla për kohën e ardhjes së Mesihut të Premtuar duke thënë se ai do të vijë në kohën kur do të rrëzohen yjet dhe dielli e hëna do të pushojnë së ndriçuari. Një i mençur kurrsesi nuk i merr këto profeci me kuptimin fizik. Si është e mundur që edhe dielli të errësohet dhe yjet të bien përtokë dhe toka të mbetet e sigurt me njerëzit dhe pastaj të vijë Mesihu i Premtuar?!”

(*Ruhani Khazain*, vol. 6, *“Shehadetul Kuran”*, f. 318-319, *Rabwah*, Pakistan, 2008, botimi i parë: 1893)

“Vetëm në epokën time, në muajin e Ramazanit, ndodhën eklipset e diellit dhe të hënës; në epokën time, në përputhje me thëniet autentike të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, të Kuranit të Shenjtë dhe të Librave më të hershëm, ra murtaja në të gjithë vendin, dhe vetëm në epokën time filluan të ekzistonin mënyra të reja transportimi të quajtura hekurudha dhe vetëm në epokën time, sipas profecive të mia, ndodhën tërmete të tmerrshme. A nuk është e vërtetë se nëse njeriu i frikësohet Zotit dhe e do Atë, ai nuk duhet të guxojë të më mohojë mua?! Shihni! Unë betohem për Zotin e Plotfuqishëm dhe ju them se janë shfaqur, po shfaqen dhe do të shfaqen mijëra shenja për të vendosur vërtetësinë time. Nëse ky do të ishte një plan i njeriut, ai kurrë nuk do të kishte pasur kaq shumë mbështetje dhe ndihmë.”

(*Ruhani Khazain*, vol. 22, *Hakikatul Vahi*)

PROFETI QË MË SË SHUMTI KA TREGUAR PËR TË PADUKSHMEN

vijon nga faqja 4

A do të vazhdojnë edhe më tutje t'u ngjajnë popujve, të cilët mu për shkak të kryeneçësisë, merituan dënimin ngaqë ngulmuan në atë që kërkonin e jo në atë që u ishte ofruar?!

Xhemati Mysliman Ahmedia beson fuqimisht se paralajmërimi rreth ardhjes së Imam Mehdiut dhe Mesihut të Premtuar janë përmëshur dhe se shenjat e ardhjes së Imam Mehdiut janë plotësuar. Këto paralajmërimet, nëse studiohen nga këndvështrimi që dha Themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmedia, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{s.a.v.s.}, dhe që është bazuar mbi ajetet Kuranore, hadithet e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} dhe logjikën e shëndoshë, atëherë del që Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} nuk flet për fantazi, por duke përdorur metafora të përsosura, ai përshkruan para një mijë e katërqind vjetësh, zhvillimet revolucionare të kohës sonë, si për shembull zhvillimin material të

botës; shpikjen e mjeteve të transportit, duke përfshirë edhe mjetet rrugore, si dhe ato ajrore; mjetet

Hazret Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} nuk flet për fantazi, por duke përdorur metafora të përsosura, ai përshkruan para një mijë e katërqind vjetësh, zhvillimet revolucionare të kohës sonë, si për shembull zhvillimin material të botës; shpikjen e mjeteve të transportit, duke përfshirë edhe mjetet rrugore, si dhe ato ajrore; mjetet bashkëkohore të komunikimit; ngritjen e gjykatave për të drejtat e njeriut; revolucionin e shtypit dhe medias; arritjet e mëdha në fushën e astronomisë; luftërat me armë zjarri e me bomba bërthamore, etj. që të gjitha këto krejtësisht të paimagjinueshme për njeriun e kohës së katërbëdhjetë shekujve të mëparshëm.

bashkëkohore të komunikimit; ngritjen e gjykatave për të drejtat e njeriut; revolucionin e shtypit dhe medias; arritjet e mëdha në fushën e astronomisë; luftërat me armë zjarri e me bomba bërthamore, etj. që të gjitha këto krejtësisht të paimagjinueshme për njeriun e kohës së katërbëdhjetë shekujve të mëparshëm. Sigurisht, këto gjëra duken të pabesueshme për një njeri, qoftë mysli-
liman qoftë jomysli-
liman, që nuk e ka studiuar fenë Islame nga këndvështrimi i Xhematit Mysliman Ahmedia. Ftojme

lexuesit e *Vërtetësisë* që t'i zbulojnë shumë nga këto paralajmërimet në këtë numër të saj, të dedikuar për shenjat e ardhjes së Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar.

Samad Ghori

ZBULIMI I SË PADUKSHMES DHE KURANI FAMËLARTË

Hazret Mirza Tahir Ahmadi, r.t. (1928-2003)
Kalifi i Katërt i Xhematit Mysliman Ahmadia

“Kur varret do të zhvarrosen.”
(El-Infitar 5:82)

Sikundër patë, që *ajeti* (vargu) i *sures* (kapitullit) El-Zilzal, flet haptas për nxirjen e thesareve të fshehura prej tokës, ky ajet i *sures El-Infitar* tregon për zbulimin e monumenteve arkeologjike.

Por nuk është vetëm ky ajet që hedh dritë mbi këtë temë. Ne e zgjodhëm këtë për shkak të natyrës së tij profetike, përndryshe, ka shumë ajete të tjera në Kuranin Famëlartë që, në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë, tërheqin vëmendjen e njeriut për shumë qytetërime dhe civilizime të varrosura e të lashta. Ato nxisin njeriun që t’i zhvarrosë të mbeturat e tyre dhe të studiojë shkaqet që ua sollën shkatërrimin e tyre përfundimtar.



Dy ajetet e para të sures El-Takvir të poshtëshënuara, parashikojnë që Islami do të ketë pësuar rënie, para se të fillojë epoka e re:

“Kur dielli do të paloset. Dhe kur yjet do të errësohen.”

(El-Takvir 81:2-3)

Duhet të kemi parasysh se dielli dhe yjet që janë përmendur në këto ajete, simbolizojnë Islamin dhe

njerëzit e tij të mëdhenj. Kurani i Madhërishëm e quan Profetin Muhammed ^{s.a.v.s.} سِرَاجًا مُنِيرًا “*Siraxhan munira*”, që fjalë për fjalë do të thotë “*dielli ndriçues*”, gjithashtu, duke iu referuar es-habëve të tij që përfituan nga drita e tij, Profeti Muhammed s.a.v.s. i quan yjet, të cilët, në mungesën e diellit, hedhin dritë të mjaftueshme për udhëzimin e të humburve:



أَصْحَابِي كَأَنْجُومٍ فَبِأَيِّهِمْ أَقْتَدِينُمْ إِهْتَدَيْتُمْ

“Es-habët e mi janë si yje. Cilindo do të ndiqni, do të gjeni rrugën e drejtë.”¹

Pra, kur është fjala për ndërprerjen e dritës së diellit, do të thotë rënia e Islamit, sepse Profeti Muhammed s.a.v.s. është shëmbëlltyra e tij e gjallë. Në të njëjtën mënyrë, edhe errësimi i yjeve, flet për kohën kur dijetarët e fesë islame nuk do të jenë më të aftë për ta përhapur dritën e Islamit. Ajetet që vijojnë, e mbështesin fuqimisht këtë komentim. Njëkohësisht, në mënyrë të pandryshueshme, ato parashikojnë edhe zhvillimet shkencore, politike dhe shoqërore të kësaj kohe. Nëse pjesën e parë të kësaj sureje do ta marrim në mënyrë josimbolike, atëherë pjesa e dytë ndesh në kundërshtim me të parën dhe jep një pamje të paqartë. Pra, parashikimi i këtyre zhvillimeve të jashtëzakonshme, në fushën e dijes, do të bëhet bashkë me paralajmërimin e palosjes së diellit dhe errësimit të yjeve. Këto janë dy gjëra të ndara që aplikohen për zhvillimet e ardhshme në dy sfera të ndryshme. Me pak fjalë, pjesa kryesore e kësaj sureje, në njërën anë, flet për zhvillimin material të botës së krishtere, që historikisht do ta pasonte zbulimin e Amerikës, ndërsa në anën tjetër, dy ajetet e para japin një pamje krejtësisht kontraste që i përket fatit të fesë Islame. Pyetja që shtrohet është: Pse Islami do të fillojë të bjerë vetëm pas zbulimit të Amerikës? Nëse do ta gjejmë përgjigjen e kësaj pyetjeje, do të jetë e mjaftueshme për mbështetjen e

1. Mishkatul Masabih, vol. 1, kapitulli III, Kitab El-Menakib, Bab Menakibus sehab, botuesi “El-Mektabul Islami”, Beirut

interpretimit tonë rreth ajeteve të lartpërmendura. Viti 1492, siç e kemi theksuar edhe përpara, është gur kufiri më i rëndësishëm që ndan botën e vjetër nga ajo e re. A mund të provojmë gjithashtu se edhe rënia e Islamit kishte arritur në kulmin e saj pikërisht në atë vit, në mënyrë që, çdo lexues të mund ta dallojë fare lehtë lidhjen midis të dyjave? Po, ne mund ta provojmë dhe gjykimi nuk është i yni, as i ndonjë myslimani tjetër. Gjykimi është i faktit historik, që u dëshmuua vetë nga historianët e krishterë. *“The Chronicle of the World”* (“Kronika e botës”) nënvizon faktin më dallues të atij viti lidhur me fenë islame si më poshtë:

“Pas një fushate dhjetëvjeçare, Granada, i vetmi shtet islamik që kishte mbetur në Spanjë, ka rënë në duart e ushtrisë kastiliane. Rrethimi i qytetit po festohet nga të krishterët si “dita më e shënuar dhe më e bekuar në tërë historinë e Spanjës”. Ndërkohë, myslimanët e quajten si katastrofa më e llahtarshme që i erdhi Islamit.”²

“Granada, qyteti i fundit i Perandorisë myslimane të Spanjës, që i bëri ballë për dy vjet mësymjes së të krishterëve, më në fund u pushtua nga Ferdinandi dhe Isabella.”³

Këtu mori fund mbretëria myslimane që qeveriste Spanjën, vazhdimisht prej shtatëqind vitesh.

Pas mbarimit të sundimit politik mysliman, në vitin 1492, Kisha filloi një fushatë të organizuar për

2. “Chronicle of the World”, (1989) “Chronicle Communications Ltd. and Longman Group UK Ltd., f. 436

3. “Chronicle of the World”, (1989) “Chronicle Communications Ltd. and Longman Group UK Ltd., f. 436

ta shfarosur Islamin. Ndonëse dominimi mysliman mbaroi në mënyrë të befte pas një sundimi të zgjatur për më shumë se pesëqind vjetësh, ndikimi që Islami kishte ndërtuar gjatë këtyre pesë shekujve të mëparshëm, nuk mund të zhbëhej brenda një ose dy vitesh. Kishte një numër të madh Maorësh, që ishin të përhapur gjatë gjithë terrenit kodrinor jugor të Andaluzisë, që siguronin zona shumë të izoluara për Islamin. Kishte edhe një numër më të madh spanjollësh të konvertuar në Islam, që ishin jo pak të sinqertë dhe të përkushtuar në praktikimin e Islamit se sa pushtuesit e tyre nga Arabia dhe Afrika. Ishin pikërisht ata më shumë se çdo të mbetur të fesë së tyre, që provonin një irritim jo tolerant ndaj klerit të krishterë, që ishte dëshpëruar gjatë viteve për t'i shkatërruar ata ose besimin e tyre.

Ishte Khemenies apostulli më në zë i Kishës Militante, i cili,

*“do të shpëtonte shpirtrat e këtyre “të pafeve” nga zjarri i ferrit, pavarësisht nëse ata e donin apo jo.”*⁴

Ai fiksoi “në mendjen e shenjtë të Isabellës, doktrinën intriguese që për ta mbajtur besimin me të pafetë po thyente besimin me Zotin.”⁵ Ai ishte

“... jo një njeri që të tërhiqej i lehtë nga qëllimi i tij. Ai nxiti Mbretëreshën të përhapte një dekret me anë të të cilit Maorëve u ishte dhënë e drejta e zgjedhjes të pagëzoheshin ose të mërgonin. Atyre iu kishin kujtuar që të partë e tyre dikur kishin qenë të krishterë dhe kjo nga

4. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 270

5. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 270

*pikëpamja e origjinës, ata vetë kishin lindur në kishë dhe duhet të pohonin në mënyrë të natyrshme doktrinën e saj.”*⁶

Kështu filloi fillimi i fundit të Islamit në Spanjë, të cilit iu desh dyqind vjet të përshkonte rrugën e tij të vdekjes.

*“Xhamitë u mbyllën, dorëshkrime të panumërta që përmbanin rezultate epokash të mësimëve maore u dogjën nga kardinali i pamëshirshëm, dhe “të pafetë” e trishtuar u kërcënuan dhe u rrahën në Paqen e Ungjillit sipas mënyrës të aprovuar tashmë nga Madhëritë e tyre katolikë, në lidhje me çifutët jo më pak të mjerë. Shumica, sigurisht u dhanë, duke e parë më të lehtë për të shpëtuar fenë e tyre dhe shtëpitë e tyre; por një shkëndijë e shpirtit të vjetër maor mbeti duke çliruar dritë midis njerëzve të kodrave të Alpuxarras ...”*⁷

*“... sundimtarët e Spanjës nuk ishin as të zgjuar as të ndershëm në tratativat e tyre me Maorët, ndërsa koha kalonte, ata u bënë për herë e më shumë mizorë dhe të rremë. “Të pafetë” u urdhëruan të linin kostume të tyre karakteristike dhe të mbanin kapelat dhe shiritat e të krishterëve, të hiqnin dorë nga larja dhe të adaptonin pisllekun e pushtuesve të tyre, të linin gjuhën, zakonet, ceremonitë madje edhe emrat e tyre dhe të flisnin spanjisht, të silleshin në mënyrë spanjolle dhe të merrnin emra spanjolle.”*⁸

“Ishte rezervuar për Filipin e Dytë të vinte në praktikë ligjin tiranik të cilin i ati tij, e kishte lënë

6. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 270-271

7. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 271

8. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 273

mënjatë me maturi. Në vitin 1567, ai futi me forcë udhëzimin e urryer për gjuhën, zakonet etj. dhe për të siguruar vlefshmërinë e ndalimit të larjes, filloi duke rrafshuar banjat e bukura të Al-Hambrasë.”⁹

“Në dimrin e vitit 1569-70 ai (Don Gjonit) filloi fushatën e tij dhe në muajin maj kushtet e dorëzimit ishin rregulluar. Muajit midis kësaj periudhe, ishin njollosur me një lumë të skuqur gjaku. Motoja e Don Gjonit ishte “asnjë lagje”; burra, gra, fëmijë u theren me urdhër të tij dhe para syve të tij fshatrat e Alpuxarras u kthyen në kasaphanë njerëzore.”¹⁰

“Shumë të mërguar fatkeq, vdiqën gjatë rrugës nga uria, lodhja, ekspozimi në natyrë, të tjerët arritën Afrikën, ku mund të lypnin lëmoshë por nuk mund të gjenin tokë për të jetuar...”¹¹

Është deklaruar se jo më pak se tre milion Maorë u dëbuan që nga koha e rënies së Granadës deri në dekadën e parë të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Kronikani arab, me pikëllim kujton këtë goditje vendimtare: ‘I Plotfuqishmi nuk u lut t’iu siguronte atyre fitore, kështu që ata u kapën dhe u therën nga të gjitha anët, deri sa më në fund u vunë përpara nga toka e Andaluzisë, katastrofa e të cilëve erdhi deri në ditët tona, në vitin 1017 Hixhri. Sigurisht Zotit i përkasin tokat dhe zotërimet dhe Ai iu jep atyre, të cilët Ai i dëshiron.’”¹²

9. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 273

10. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 278

11. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 279

12. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin,

“Maorët u dëbuan; për pak kohë Spanja e krishtere ndriçoi, si hëna, me dritë të huazuar, pastaj erdhi eklipsi dhe në këtë errësirë, Spanja po endet e sikletosur prej kohësh.”¹³

Kështu, Stanley Lane-Poole nxjerr përfundimin në historinë e tij të *The Moors in Spain* (“Maorët në Spanjë”). Dielli i dominimit politik mysliman në Spanjë që kishte përfunduar në vitin 1492, i lënë pas, ai dukej një muzg i zymtë i përgjakur, të cilit iu desh dy shkuaj që të davariste dritën e Islamit nga qielli i Spanjës dhe ta kthente atë në një natë pa yje.

Sa për iluminizmin sekular i sjellë në Spanjë nga përhapja e qytetërimit mysliman, nuk vazhdoi gjatë.

Kështu që, viti 1492 hapi dy porta njëherësh, nga njëra prej tyre, e ardhmja dominuese e krishterimit hyri me një madhështi brohoritëse në botë, ndërsa nga tjetra, doli kokëvarur e kaluara madhështore e Islamit, çdo hap i kthimit të të cilës, i shkaktonte vuajtje të padurueshme.

Ajeti i katërt flet për lëvizjen e maleve nga një vend në një vend tjetër:

“Dhe kur malet do të lëvizin.”

(El-Takvir 81:4)

Në terminologjinë islamike, malet simbolizojnë fuqitë e mëdha të botës. Ka shumë ajete të tjera në Kuranin Famëlartë që flasin për malet më të njëjtin konotacion. Kështu që, me ajetin konkret, që

Londër, f. 279

13. LANE-POOLE,S. (1888) “The Moors in Spain” botimi i tetë, T. Fisher Unwin, Londër, f. 280

flet për lëvizjen e maleve, ne do të fillojmë të njohim çfarë do të ndodhte në ditët e vona. Menjëherë pas rënies së Islamit, do të binte një natë pa yje, për të pasuar agimi i një dite të re, që nuk do të ishte e Islamit. Superfuqitë materiale jo vetëm që do të ngriheshin, por do të përhapnin influencën e tyre nga një territor në një territor tjetër; nga një kontinent në një kontinent tjetër, duke mbuluar kështu shtet pas shteti. Malet lëvizën në sensin e tyre vetëm në këtë mënyrë dhe ato, me të vërtetë, kanë lëvizur. Lëvizja e maleve mund të ketë edhe një kuptim tjetër, por për këtë temë do të flasim më vonë. Tani, meqë kemi nisur të rishikojmë ndryshimet e mëdha, të cilat sipas kësaj sureje të Kuranit Famëlartë, ishin destinuar të ndodhnin në atë kohë, ne do të shtjellojmë temën shkallë-shkallë, sipas renditjes së ajeteve të Kuranit.

Lidhur me temën e lëvizjes, kuptimi i ajetit të pestë është mjaft i qartë. Ajeti thotë:

*“Dhe kur devetë, dhjetë muajsh
shtatzëna, do të braktisen”*

(El-Takvir 81:5)

Në këtë kontekst, profecia e braktisjes së deveve shpjegon qartazi, se mjetet më të shpejta e më të fuqishme të transportit do të shpikeshin në atë kohë. Skenari i lëvizjes së maleve nga një vend në një vend tjetër, domethënë përhapja e influencës së superfuqive nga një kontinent në një kontinent tjetër, lidhet drejtpërdrejt me çështjen e braktisjes së deveve.

Duhet të kemi parasysh se lëvizja e maleve nënkupton edhe transportimin e ngarkesave shumë të mëdha, si dhe përhapjen e

influencës së superfuqive politike në botë. Të dyja këto, detyrimisht kërkojnë mjetet më të avancuara të transportit sesa devetë. Derisa njeriu nuk do të kishte gjetur të tilla mjete të reja transporti, do të ishte budallallëk nëse ai do t'i braktiste mjetet e tij të vjetra, sado të dobëta të ishin ato. Duke braktisur devetë, ai në asnjë mënyrë nuk mund të mbartte ngarkesa aq të mëdha si male mbi shpinën e vet.

Pra, i vetmi konkluzion që del nga ky ajete është, se mjetet shumë më të shpejta mekanike do të shpikeshin, duke i lënë jashtë përdorimit kafshët si mjet i transportit.

Mos ta harrojmë se, devetë mund të simbolizojnë vetëm mjetet tokësore të transportit. Dikush mund të thotë se përse nuk u përmendën edhe anijet, varkat, etj? Çfarë zbulimi të madh bëri Kurani, për sa i përket parashikimit të mjeteve detare? Këtyre pyetjeve do t'u përgjigjemi pak më vonë. Hëpërhë, dëshirojmë ta shohim ajetin vijues që flet për grumbullimin e të gjitha llojeve kafshëve:

“Dhe kur egërsirat do të grumbullohen.”

(El-Takvir 81:6)

Përmendja e grumbullimit të kafshëve, menjëherë pas braktisjes së deveve, është mjaft interesante. Kjo është një tjetër dëshmi që devetë nuk do të braktisen pavarësisht nga dobëtitë e tyre. Grumbullimi i kafshëve, realisht, e mbështet më tej të njëjtën ide, atë të shpikjes së mjeteve revolucionare të transportit. Sigurisht, të gjitha kafshët e egra nuk mund të transportoheshin mbi shpinën e devesë. Askush nuk



mund të imagjinojë dot elefantët, rinoqerontët, gjirafat, krokodilët, balenat e kaltra, oktapodët gjigantë etj, duke udhëtuar me deve. Transportimi i tyre mund të ishte i mundur vetëm nga shpikja e mjeteve të transportit të epokës sonë. Ajeti që vijon e shtjellon akoma më shumë temën e transportit:

“Dhe kur detet do të derdhen fort (njërin mbi tjetrin).”

(El-Takvir 81:7)

Fjala arabe *“suxh-xhirat”* që është përmendur në këtë ajet, sipas fjalorit *“Lane”*, mund të përkthehet në tri variante të mëposhtme:

1. Dhe kur detet do të mbushen.
2. Dhe kur detet do të derdhen fort njërin mbi tjetrin.
3. Dhe kur deteve do t’u vihet zjarr.

Për sa i përket kuptimit të parë, detet do të mbushen do të thotë, ato do të mbushen me enët. Në këtë mënyrë, ky ajet gjithashtu mbart të njëjtin profeci që u përmend në ajetet e mëparshme. Këtë interpretim do ta shtjellojmë më shumë kur do t’i rikthehem temës.

Momentalisht, ne do të marrim kuptimin e dytë nga tri kuptimet e lartshënuara, që flet për bashkimin e deteve. Këtë profeci e sqarojnë më shumë dy ajetet e Kuranit që vijojnë:

“Ai ka lëshuar dy dete që të takohen (një ditë),

por, midis tyre ka një pengesë (tani) që nuk mund ta kapërcejnë.”

(Er-Rahman 55:20-21)

“Është Ai që ka lënë të lira dy dete, njëri

i pjëshëm e i ëmbël, kurse tjetri i njelmët e i hidhur, në mes të tyre (tani për tani) ka një pengesë e kufi të prerë.”

(El-Furkan 25:54)

Këto dy pjesë të Kuranit janë marrë nga sure të ndryshme. Secila prej tyre paralajmëron ngjarje të ndryshme të bashkimit të dy deteve. Pikërisht kështu ndodhi në kohët moderne, kur bota ka dëshmuar përmbushjen e këtyre profecive në atë mënyrë që kurrsesi nuk mund t’i shkonte ndër mend njeriut të kohës së Profetit Muhammed s.a.v.s. Kjo u realizua nga gërmimi i Kanalit Suez gjatë viteve 1859-1869, si dhe ai i Kanalit Panama gjatë viteve 1903-1914.

Kuptimi i tretë që jep skenarin e deteve me zjarr nuk është më pak interesant sesa i pari. Edhe këtë, në asnjë mënyrë nuk mund ta përfytyronte dot njeriu i katërmbëdhjetë shekujve të mëparshëm. Kjo ide mund t’i lindte vetëm njeriut të asaj kohe kur kishin filluar luftërat detare, në të cilat do të shkëmbeheshin sulme të forta prej zjarri. Çuditërisht, gjatë luftërave detare të kohës moderne, anijet përdoren aq shumë sa që ato sikur mbushen në det dhe të japin po atë pamje që është kuptimi i parë i ajetit konkret.

Kuptimi i tretë, pra ai i vënies së zjarrit në dete, sot realizohet me të vërtetë. Nga fuçitë e saj, nafta derdhet në det në një sasi të madhe dhe asaj, zakonisht i vihet zjarr, në mënyrë që të mos kërcënohet jeta e peshqve në ujë. Në raste të tilla, në kuptimin e plotë të fjalës, mijëra km² të detit pushtohet nga zjarri.

Ajeti tjetër nga sureja *El-Takvir* na çon

edhe më tej, duke mbartur përsëri të njëjtën ide. Kësaj radhe nuk flitet për grumbullimin e kafshëve, por mesazhi qendror i ajetit vijues është se do të bashkohen njerëzit:

“Dhe kur njerëzit do të bashkohen.”

(El-Takvir 81:8)

Edhe ky ajet mund të ketë tri kuptime njëherazi:

1. Kur njerëzit ose popujt do të bashkohen nëpërmjet lidhjeve (traktateve) të ndërsjella.
2. Kur do të bashkohen popujt e të gjithë botës.
3. Kur bashkimi i popujve do të jetë i mundur fal mjeteve më të shpejta të transportit.

Secili nga këto kuptime është realizuar qartas. Vetëm në epokën tonë, traktatet ndërkombëtare praktikisht i bashkojnë të gjitha vendet e botës, pa përjashtim. Ndaj, ky interpretim është vërtetuar shumë qartë dhe nuk ka nevojë të shpjegohet më.

Në të njëjtën mënyrë, themelimi i Ligës së Kombeve, që më vonë u zëvendësua me Kombet e Bashkuara, gjithashtu është një bashkim përparimtar dhe përfundimtar i botës, siç ishte parashikuar.

Për sa i përket kuptimit të tretë të kësaj profecie, pak më lart folëm për mjete të reja të transportit që me të vërtetë tërë botën e zvogëluan në një qytet.

Para se të vazhdojmë më tej, do të jetë e udhës të ndalemi këtu për të përmendur një profeci tjetër, e cila gjithashtu ka lidhje me bashkimin e popujve. Ajo profeci flet për

kthimin e Bijtë e Izraelit në Tokën e Premtuar në ditët e vona:

“Dhe pas tij, u thamë Bijve të Izraelit: “Vendosuni në këtë tokë;

dhe kur të arrijë (koha e) premtimit të ditëve të vona, do t’ju sjellim të grumbulluar.”

(El-Isra 17:105)

Në vitin 70 e.s., shteti i hebrenjve mori fund me shkatërrimin e Jerozalemit nga romakët. Që atëherë, hebrenjtë u shpërndanë në botë, duke u shpërngulur nga njëri vendi në tjetrin. Pikërisht kësaj diaspore unanime i referohet ajeti i Kuranit Famëlartë, kur deklaroi se një ditë hebrenjtë do të grumbullohen nga gjithë bota duke u mbledhur edhe një herë në Tokën e Shenjtë. Ky është një premtim i Zotit që do të plotësohet. Deri tani, ne kemi parë se në ç’masë u plotësua ky premtim, një ngjarje e tillë nuk ishte shënuar më parë. Në asnjë periudhë të historisë hebraike, nuk ka ndodhur më parë, siç ndodhi gjatë kohëve të fundit që ata përsëri u grumbulluan nga të gjitha vendet pas një diaspore, duke krijuar shtetin izraelit.

Kthehemi sërish te sureja El-Takvir, nga e cila u larguam për pak. Le të marrim ajetin nëntë që është në vijim. Edhe ky, si dhe ajeti dhjetë na japin skicë të së njëjtës epoke, së cilës iu referuan ajetet e mëparshme nga këndvështrime të ndryshme.

“Dhe kur foshnja-femër e varrosur për së gjalli do të pyetet: për çfarë faji ishte vrarë?”

(El-Tekvir 81:9-10)

Nga injoranca e tyre, disa arabë ndiheshin tepër të poshtëruar ➔

kur u lindte vajzë dhe nga turpi, kishte raste që edhe e kishin varrosur për së gjalli. Shoqëria nuk kishte asnjë të drejtë të ndërhynte në rrethana të tilla, sepse i ati gëzonte fëmijët e tij sikur të ishin pasuri.

Sipas këtij ajeti, në epokën e ditëve të vona do të sundojë ligji dhe në këtë ajet, flitet në veçanti për të drejtat e grave. Pra, Kurani nuk e parashikon vetëm një sundim të përgjithshëm të ligjit, sepse për të, mjaftonte një fjali e thjeshtë lidhur me zbatimin e ligjit. Ndërsa ajeti i Kuranit sqaron diçka më tepër, e cila nuk mund t'i shpëtojë lexuesit pa vënë re. Burrat nuk mund të kenë mundësi për të luajtur me të drejtat e grave, ky është mesazhi i fortë i këtij ajeti. Në asnjë kohë të njerëzimit, të drejtat e grave nuk morën kaq shumë rëndësi sa në epokën tonë.

Të gjitha veçoritë e ditëve të vona të zhvilluara sistematikisht nga ky kapitull i Kuranit kanë një renditje kaq harmonike, sikur të ishte një pikturë e ndonjë mjeshtri. Realisht, zhvillimet e vazhdueshme shkencore që janë përmendur në këto ajete, do të kishin lidhje shumë të ngushtë me shoqërinë dhe teknologjinë e ditëve të vona. Ajeti i tetë (të sures El-Tekvir) fliste për grumbullimin apo mbledhjen e njerëzve nëpërmjet mjeteve të ndryshme. Edhe ajeti i njëmbëdhjetë, pas përmendjes së zhvillimeve shoqërore dhe politike, flet për të njëjtën temë, por duke iu referuar mjeteve që do të bashkonin njerëzit në mënyrë akoma më të fortë, ato janë botimet e shumta të literaturës, gazetave, revistave etj. Sigurisht, të gjitha mjetet e transportit, që kemi përmendur

më lart, luajtën rolin e tyre shumë efektiv për bashkimin e njerëzve në të gjithë botën, por roli i shtypit nuk mund të zëvendësohet me asnjë mjet tjetër për të bashkuar njerëzit. Nëse do ta eliminoni rolin dhe impaktin e shtypit nga kjo botë, pavarësisht nga shkurtimi i rrugëve, njerëzit edhe një herë do të izoloohen tërësisht. Ajeti në vijim parashikon pikërisht për mjetet e shtypit, botimet masive dhe median:

“Dhe kur librat do të publikohen dhe shpërndahen.”

(El-Takvir 81:11)

Ky ajet gjithashtu bën profeci për shpikjen e shtypit modern, pa të cilin dorëshkrimet nuk mund të publikoheshin në mënyrë aq të gjerë dhe as nuk mund të shpërndaheshin.

Veç kësaj, botimi kolosal i librave gjithashtu shënon një epokë të përhapjes së dijes, shkencës dhe hulumtimit. Kurani Famëllartë thekson kaq shumë rolin e fuqishëm të pendës saqë, ia atribuon drejtpërdrejt Zotit për t'i mësuar njeriut si të shkruajë. Ajetet që po shënojmë më poshtë janë pikërisht nga sureja (kapitulli) e parë që iu shpall Profetit Muhammed s.a.v.s. dhe që prerazi deklaroi:

“Lexo! Dhe Zoti Yt është më i Nderuari, i Cili me anë të penës ia mësoi; ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”

(EL-Alak 96:4-6)

Ajetet e mësipërme, nëse lexohen në kontekst me ajetet që kemi në diskutim, na del qartë që epoka e ditëve të vona do të jetë epoka e zhvillimit dhe përparimit të dijes, epoka e institucioneve arsimimi, si

shkollat, kolegjet dhe universitetet.

Ajeti i parë i Kuranit, duke bërë një hyrje, na prezanton Zotin si më i Nderuari, sepse Ai i mësoi njeriut me anë të penës, gjë që në lë të nënkuptojmë se pena do të jetë burimi i të gjithë diturisë, radhazi dija do të jetë burimi i të gjithë madhështisë dhe nderit. Këtu, nuk duhet të harrojmë se këto shpallje i kanë ardhur atij njeriu që kurrë nuk kishte mësuar të përdorte penë në jetën e tij. Ishte pena e Zotit që shkroi veprën e Kuranit, e jo pena e Muhammedit s.a.v.s. Një tjetër kuptim që del nga ky ajet është se dija do të bëhet mjeti i përfuturit të fuqisë dhe se ajo do të dalë më e mprehtë se shpata.

Ajeti vijues i sures El-Takvir parashikon se dija e njeriut do ta përshkojë edhe qiellin:

“Dhe kur qielli do të zhvishet”.

(El-Takvir 81:12)

Ky ajet paraqet një krahasim tragjik midis gjendjes së Islamit në atë kohë dhe ngritjes së fuqive të krishtere materiale, kur drita e diellit të Islamit do të zbehet dhe yjet e qiellit të myslimanëve do të errësohen. Ndërkohë, bota materiale jomyslimane, do të fillojë të ngjitet në lartësitë qiellore për të zbuluar sekretet e gjithësisë.

Ky skenar na kujton edhe disa ajete të tjera të Kuranit Famëlartë, që gjithashtu parashikon një epokë, në të cilën, do të ketë qarkullim edhe në hapësirë. Më poshtë do t'i shënojmë ato ajete:

“Për qiellin plot me rrugë”.

(Edh-Dharijat 51:8)

“Dhe për ato që dërgohen njëra pas

tjetrës. Dhe për ato që lëvizin me shpejtësi, sikur janë shtrëngata të shpejta. Dhe për ato që propagandojnë propaganda të shkëlqyera. Dhe për ato që bëjnë dallim dhe diskriminim (midis mikut dhe armikut)”.

(El-Murselat 77:2-5)

Këto dhe kësajsoj shumë ajete të tjera japin një tablo të qartë të një qielli që do të përdoret gjerësisht për qarkullimin ajror. Qielli që do të ketë rrugë, në të cilin mesazherët do të mund të fluturojnë nga një vend në një vend tjetër. Do të jetë koha e propagandës ajrore, aq gjerë saqë njeriu do të mund të fluturojë me anë të krahëve të ajrit. Pasi t'i ketë përmbushur atij ëndrra e fluturimit, njeriu patjetër do të dëshirojë ambicie të larta, do të lançojë stacione dhe posta në hapësirë për të monitoruar e mbikëqyrur çdo gjë që ndodhë në gjithësi rreth tij. Ajeti që vijon, e ilustron akoma më qartë këtë fazë të zhvillimit të njeriut në fushën e shkencës dhe teknologjisë, nëpërmjet të cilave, ai do të mund të shohë hapësirë të pafund të gjithësisë.

“Ata nuk e përgjojnë dot dhomat hyjnore të larta, dhe qëllohen nga të gjitha anët. Zmbrapsje! Për ta do të kenë vuajtje të përherëshme”.

(Es-Saf-fat 37:9-10)

Lidhur me ambicien e njeriut për ta nënshtruar hapësirën deri në skajet e saj, Kurani i bënë këtë sfidë që është përmendur në ajetin që vijon.

Para së ta shënojmë ajetin përkatës, është e nevojshme të sqarojmë natyrën ligjërimore të tij. Përkthimi i tij: *“O shoqëri të xhindeve dhe njerëzve”* nuk bën drejtësi të ➔

duhur me mesazhin që përcjell ajeti. Fjala “xhind” nuk shënon ndonjë genie të përbindshme, ndryshe nga njerëzit. Sikundër e kemi sqaruar më parë (në kapituj të tjerë të librit), kjo fjalë përdoret shpesh nga Kurani për njerëzit e shtresës së lartë, karshi fjalës “en-nas” që përdoret për njerëzit e thjeshtë. Prandaj, domethënia e vërtetë e këtij ajeti do të përcillet më mirë, nëse ai do të përkthehet kështu: “O shoqëri të fuqive kapitaliste dhe o shoqëri të fuqive proletariate”.

Tani, do ta shënojmë ajetin dhe përkthimin e tij që kemi marrë nga përkthimi i Kuranit, të Maulavi Sher Aliut:

“O company of Jinn and men! If you have power to go beyond the confines of the heavens and the earth, then do go. But you cannot go save with authority.”

(Përkthimi i ajeteve 55:34, nga Maulavi Sher Ali)

“O shoqëri të xhindeve dhe njerëzve, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkojini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një autoritet.”

(Er-Rrahman 55:34)

Me modesti, ne do të sugjerojmë që një përkthim më i mirë i pjesës së fundit të ajetit mund të ishte “përveçse me anë të logjikës deduktive më të fortë”, që do të thotë se njeriu mund të përshkojë skajet e gjithësisë me anë të dijes së tij, edhe pse ai nuk mund të shkojë fizikisht. Kemi argumentet e mëposhtme në mbështetjen e konkluzionit tonë:

Në fakt, përkthimi në anglisht që thotë “save with authority” (përveçse me një autoritet) mund të shtrembërojë e të devijojë edhe mesazhin kryesor që mbart ajeti Kuranor. Në arabisht

është fjala “sultan”, që nuk do të thotë vetëm “autoritet”, por ajo ka edhe kuptimin “mbret”, “argument i pathyeshëm” dhe “logjikë e fortë”. Kështu që, ky ajet ka kuptimin se njeriu mund të përshkojë kufijtë e gjithësisë nëpërmjet logjikës didaktike të fortë.

Ajo që është mohuar tërësisht në këtë ajet, nuk është një a dy hedhje të shkurtra në hapësirë. Por, mohohet mundësia e arritjes së njeriut deri në kufijtë e gjithësisë me trupin e tij fizik. Përveç kësaj, rreziqet që u dalin anijeve kozmike janë përmendur edhe në ajetin që vijon:

“Kundër jush do të dërgohen flakë zjarri dhe tym dhe ju nuk do të ndihmoni dot veten”.

(Er-Rrahman 55:36)

Ky ajet, me të vërtetë, jep një pamje shumë të qartë të rrezeve kozmike, e jo të flakëve të zakonshëm të zjarrit.

Pas shpjegimit të ajetit të dymbëdhjetë të sures El-Takvir bashkë me ajetin sures Er-Rrahman, le t'i kthehemi sërish sures El-Takvir.

Është një ko incidencë e çuditshme që sapo komentuam ajetet e sures Er-Rrahman që alarmojnë për sulme të vazhdueshme zjarri, dhe pikërisht e njëjta temë na parashtrohet nga ajeti i trembëdhjetë i sures El-Takvir, që është në vijim:

“Dhe kur xhehenemi do të flakërojë”.

(El-Takvir 81:13)

Në këtë ajet zjarri i xhehenemit nënkupton ato luftëra që të japin përshtypje sikur u hapën portat e xhehenemit. Realisht, ky ajet është

një alarm dhe ky është i vetmi komentim i mundshëm brenda kontekstit të ajeteve që komentuar dhe që japin paralajmërime më të rëndësishme të kësaj kohe. Përndryshe do jetë absurde që njeriut t'i thuhet që në një kohë të caktuar, kur do të ndodhin kësisoj ndryshimesh në këtë botë dhe në të njëjtën kohë zjarri i xhehenemit të flakërojnë në ndonjë botë tjetër.

Pra, rendi i profecive, në këtë mënyrë, arrin në përfundimin e tij të logjikshëm. Zhvillimi material, sado masiv të jetë, nuk mund t'i sjellë asnjë dobi njeriut, nëse ai i fiton ambiciet materiale duke paguar pëlqimin e Zotit. Ora e ndëshkimit duhet të vijë dhe ta godasë njeriun, pavarësisht nga i gjithë përparimi i tij material. Asnjë fatkeqësi natyrore nuk do të vijë nga qielli për ta ndëshkuar kaq rëndë, saqë xhehenemi i ndezur vetë prej tij. Egoizmi i tij do t'i krijojë tensione të tilla botërore, që medoemos përfundojnë në një ferr luftërash. Pas vëzhgimit mbi historinë e dy Luftërave Botërore, ky interpretim nuk duket më thjesht një zbërthim i hamendshëm, por kërcënim i një rreziku vërtet të rëndë. Ky shkallëzim i deritanishëm e dallon shkoqur kontrastin midis rënien tragjik të Islamit dhe ngritjen e forcave jomyslimane. Ajeti që është në diskutim, përshkruan sheshit se pushtimi global i materializmit nuk do të zgjasë përjetësisht. Rënia e të gjitha fuqive jomyslimane do të shkaktohet nga rritja e armiqësisë së tyre të ndërsjellë, që do të arrijë në kulm duke sjellë katastrofa të lemerishme, të shkaktuara vetë prej tyre. Luftërat do të pasojnë njëra pas tjetrës, herë duke u ndezur, herë duke u shuar dhe do t'i shndërrojnë në hi superfuqitë e botës e t'i bëjnë

ato që të shkumbohen vetë. Dy Luftërat e para Botërore kanë shtypur tashmë madhësinë e pasfidueshme të këtyre superfuqive, ndërsa kombet e dobëta e të varfra relativisht kanë dalë me mendimin për të gjetur diçka nga dinjiteti i tyre të humbur. Ekuilibri ende është i mbajtur për të mos shkaktuar ndonjë fazë kritike. Por, edhe pse ngadalë, koha sigurisht që është duke ecur drejt një revolucioni global. Pikërisht ai revolucioni parashikohet në Kuran që të jetë edhe revolucioni përfundimtar i Islamit. Që t'i mos mendojë dikush këto thënie si të stërzmadhuara dhe të pabaza, në kapitullin vijues, ne do të sjellim disa dëshmi të forta që do të heqin dyshimet e tilla.

Në bazë të shumë ajeteve të Kuranit Famëlartë, Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. paralajmëroi haptas rezultatin përfundimtar të përplasjes botërore që do të ndodhte në ditët e vona. Këtë paralajmërim, ai e jep në kuadër të shfaqjes së *Dexhhalit*, anti-Krishtit. Por, në fillim duhet të sqarojmë se figura e *Dexhhalit*, siç na përcillet në *hadithet* (thëniet) e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s., me të vërtetë nuk është aq përrallore siç mund të duket në pamje të parë. Ai e përshkruan *Dexhhalin* sikur të përbëhej nga fuqia dhe madhështia e kombeve shumë të fuqishme. Në të vërtetë, e gjithë epoka e ditëve të vona, sipas Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s., është epoka e anti-Krishtit. Të gjitha shenjat janë përmendur duke iu referuar atij. Njëra ndër shenjat e tij, në mënyrë specifike lidhet me mjetet e transportit të kohës moderne, për të cilat, njeriu i mëparshëm as nuk mund të imagjinonte dot. Një studim i hol- lësishëm i përshkrimit të *Dexh-*



halit, sqaron mjaft qartë se të gjitha paralajmërimet që i referohen, nuk flasin për një personalitet të vetëm. Termin *Dexhhal* që përdori Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. është një metaforë që simbolizon fuqitë madhështore të kohës moderne dhe arritjet e tij, që realisht janë një sërë kombesh të krishtere shumë të përparuara e të fuqishme në botë. Por, epërsia e tyre nuk do të zgjasë përjetësisht. Gjithashtu, me fjalë jo të paqarta, është paralajmëruar edhe rënia përfundimtare e anti-Krishtit, që i simbolizon ato kombe të epërme. Pikërisht nga gërmadhat e botës së materializmit, do të lindë përsëri dielli i Islamit duke zbuluar bukurinë e saj të ndritur dhe duke hequr perdet e dyshimit e mosbesimit, të cilat e kishin mbuluar për disa shekuj të zymtë.

Tani do të flasim përsëri për temën e mjeteve revolucionare të transportit, por kësaj radhe do të diskutojmë duku iu referuar thënieve të Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. Për shenjat e tjera të anti-Krishtit, sidomos ato që kanë rëndësi fetare, do të flasim gjerësisht, por veçmas, në një kapitull tjetër.

Mjetet e transportit qofshin tokësore, detare apo ajrore, të gjitha pa përjashtim janë përmendur në atë mënyrë që përkohë plotësisht me komentimin e ajeteve të Kuranit që paraqitëm pak më parë. Madje, edhe çështja e lëvizjes së maleve sqarohet në mënyrë që do t'i kujtohen lexuesit vetvetiu, ajetet përkatëse të Kuranit Famëlartë. Përshkrimi që i bëri Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. anti-Krishtit dhe gomarit të tij tipik, me të cilin ai do të udhëtojë, duhet të ketë qenë shumë i çuditshëm për njerëzit e kohës së tij. Kështu duhet të ndodhte, sepse ai

vazhdimisht i referohej një gomari, ndërkohë asnjë nga cilësitë e zakonshme të gomarit nuk gjenden në të. Por, të gjitha mjetet e transportit të kohës moderne, i përgjigjen në mënyrë të përsosur këtij përshkrimi.

Vetia e përbashkët e këtyre mjeteve të transportit është se ato lëvizin përmes motorit me djegie, duke marrë energji prej zjarrit. Edhe motorët me djegie të jashtme, si lokomotivat me avull, gjithashtu varen nga zjarri. Sigurisht, kjo është vija e prerë dhe ndarëse midis mjeteve të transportit prej kafshësh dhe mjeteve revolucionare të kohës moderne, të kohës së anti-Krishtit, që njëkohësisht do ta zbulojë se ai nuk është një kafshë, por diçka jo e gjallë. Ne do t'i adresohemi me përemrin “ai”, vetëm sepse në paralajmërim, në kuptimin e plotë të fjalës, ai është përshkruar si një hajvan. Realisht, ai mund të identifikohet vetëm nga kjo shenjë. Nëse do ta njihni gomarin e anti-Krishtit, ju do të zbuloni mjetet e transportit të kohës moderne, përndryshe, do të ktheheni përsëri në epokën e gomarëve. Më poshtë, do të jepet një prezantim i përbërë që është marrë nga *hadithet* (thëniet e Profetit s.a.v.s.):

1. Ashtu si gomari i tij, edhe anti-Krishti do të jetë kaq masiv dhe gjigant, për të cilin, as në përrallat nuk duhet të ketë dëgjuar. Ai do të jetë kaq i gjatë, saqë koka e tij do të përshkojë edhe retë. Ai do të jetë kaq i fuqishëm, saqë gjithë botën mund ta nënshtrrojë vetëm.¹⁴
2. Pavarësisht nga aftësitë e tij të jashtëzakonshme fizike, ai

14. Allama Ala-ud-din Ali El-Muttaki (1480-1567), “Kanz-ul-ummal”, vol. 14, f. 604 e 613, Beirut, 1979

do të ketë një cen, do të jetë krejtësisht qorr me syrin e tij të djathtë.¹⁵

3. Gomari nuk do jetë vetëm mjete personal i anti-Krishtit, por ai do të jetë në shërbim të gjithë njerëzit si një mjet i transportit. Njerëzit do të futen në barkun e tij, përmes hyrjeve të posaçme që ai do t'i ketë anash tij.¹⁶
4. Barku i tij do të jetë mjaft i ndriçuar dhe i pajisur me ndenjëse të rehatshme.¹⁷
5. Gomari do të lëvizë me shpejtësi të jashtëzakonshme duke bërë edhe rrugë të gjata vetëm në disa ditë ose orë, që mjeteve kafshore do t'u duhen disa muaj për t'i bërë.¹⁸
6. Gjatë rrugës, ai do të ketë ndalesa të rregullta. Në çdo ndalesë, do të ftojë njerëzit që të futen në të dhe të ulen para se ta rinisë udhëtimin e tij dhe gjithashtu, për çdo nisje do të njoftohen me zë të lartë.¹⁹ Shkurt, ky gomar simbolik do të udhëtojë vazhdimisht nga vendi në vend duke iu shërbyer

15. Imam Muslim Bin El-Hajjaj Bin Muslim El-Kushairi El-Naisapuri, (821-875) "Sahih Muslim", Kitab-ul-Fitan, Bab Dhikrid-Dexhhal ua Sifatihua ma ma'ahu

16. Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi (1616-1698), "Biharul Anuar", Bab Alama-ti zuhurihi alejhiselam minas-sufjani wed dexhhal

17. Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi (1616-1698), "Biharul Anuar", Bab Alama-ti zuhurihi alejhiselam minas-sufjani wed dexhhal

18. Abdur Rrahman El-Safuri, "Nuz'hatul Mexhlis", vol. 1, f. 109, shtypshkronja "Maimaniyyah", Egjipt

19. Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi (1616-1698), "Biharul Anuar", Bab Alama-ti zuhurihi alejhiselam minas-sufjani wed dexhhal

njerëzve si një mjet i shpejtë dhe i rehatshëm i transportit.

7. Pasagjerët që do të ulen në barkun e tij, nuk do t'i prekë zjarri me të cilin ushqehet gomari.²⁰ Kjo tregon që kabinat që do të ketë në barkun e tij, do të jenë të izoluara mirë nga zjarri.
8. Ky gomar do të mund të udhëtojë edhe në det dhe do të kalojë nga një kontinent në një kontinent tjetër, duke lundruar përmes valëve të detit.²¹
9. Gjatë lundrimit të tij në det, ai do të zmadhohet aq shumë, sa që mund të transportojë mbi shpinën e tij edhe malet me ushqim. Shpesh, ai do të jetë i përcaktuar për t'u sjellë furnizime të mëdha të ushqimit atyre kombeve të varfra që do t'i nënshtrohen vullnetit të anti-Krishtit.²² Do t'ju kujtojmë se transporti i ngarkesës madhështore të ushqimeve ishte përmendur në ajetin Kuranor që flet me metaforë për një kohë kur malet do të lëvizin.
10. Ky gomar i çuditshëm di edhe të fluturojë, sepse për të është përmendur se mund të hedhë hap nga Lindja në Perëndim. Është përshkruar se një hap i këtij hajvani do të jetë në Lindje dhe hapi tjetër do ➔

20. Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi (1616-1698), "Biharul Anuar", Bab Alama-ti zuhurihi alejhiselam minas-sufjani wed dexhhal

21. Abdur Rrahman El-Safuri, "Nuz'hatul Mexhlis", vol. 1, f. 109, shtypshkronja "Maimaniyyah", Egjipt

22. Imam Muhammad Bin Ismail El-Buhari (810-870), "El-Sahihul Buhari", Kitabul Fit-an, Bab dhikrid dexhhal

gjendet në Perëndim.²³ Kjo distancë midis dy hapave të tij, tregon qartazi se ai do të ngrihet nga një kontinent dhe do të zbresë në kontinentin tjetër.

11. Gjatë fluturimit, ai do të lundrojë mbi retë.²⁴
12. Në ballin e tij, ai do të bartë hënën.²⁵ Hëna simbolizon qartazi fenerët që shumica e mjeteve moderne e kanë.

Pas leximit të këtij përshkrimi të gjallë të gomarit të anti-Krishtit, të cilin ai do ta përdorë për pushtimin e tij në mbarë botën, do të çuditëshim nëse lexuesi ende kërkon shpjegime për ta zbuluar se kush është ai!

Me të vërtetë, kombet e krishtera të superfuqishme që janë përmendur me titullin *Dexhhal*,²⁶ do të sundonin tërë botën një ditë. Gomari i lëvizshëm prej zjarri, që herë luan rolin e aeroplanit, herë të anijes dhe herë të trenit, duke lëvizur me shpejtësi të jashtëzakonshme, do të luante rolin kyç për pushtimin e superfuqive të krishtere në gjithë botën. Përveç spikatjes së përparësisë së shpejtësisë, në kuadër të luftës ndërkombëtare për epërsi, edhe avantazhi i peshëngritjes është përmendur në Kuran:

23. Abdur Rrahman El-Safuri, "Nuz'hatul Mexh-lis", vol. 1, f. 109, shtypshkronja "Maimaniyyah", Egjipt

24. Allama Ala-ud-din Ali El-Muttaki (1480-1567), "Kanz-ul-ummal", vol. 14, f. 613, Beirut, 1979

25. Allama Ala-ud-din Ali El-Muttaki (1480-1567), "Kanz-ul-ummal", vol. 14, f. 613, Beirut, 1979

26. Imam Muslim Bin El-Hajjaj Bin Muslim El-Kushairi El-Naisapuri, (821-875) "Sahih Muslim", Kitab-ul-Fitan, Bab Dhikrid-Dexhhal ua Sifatihua ma ma'ahu

"Pastaj, sa i përket atij, pjetat e të cilit do të peshojnë shumë, ai do të ketë një jetë të këndshëm."

(El-karia 101:7-8)

Ato kombe, sa më shumë të shtohen në peshë dhe sa më shumë të jenë të shpejta, aq më i pashmangshëm do të bëhet pushtimi i tyre në botë. Pra, vetëm pesha dhe shpejtësia e lëvizjes do të kenë përparësi në këtë rrugë drejt triumfit.

Këto profeci janë aq unike, saqë është e vështirë të gjeni shembullin e tyre në paralajmërimet hyjnore të ndonjë feje tjetër.

Përshkrimi i këtyre profecive është aq i qartë, i gjallë dhe i saktë, saqë të jep përshtypje të një piktori, i cili, me panelin e tij, paraqet atë që sheh. Pikërisht në këtë mënyrë, Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. na e paraqiti me fjalë piktoreske atë që u zbulua para syve të tij.

Me këtë, do të mbyllim diskutimin mbi serinë e profecive që përmban *sureja* (kapitulli) El-Tekvir i Kuranit Famëlartë. Tani, do t'ju paraqesim disa profeci akoma më të rëndësishme, që tregojnë karakteristika të tjera interesante të kësaj epoke. Secila nga ato profeci, lidhet me një temë të ndryshme specifike dhe që janë shpalosur në *sure* të ndryshme të Kuranit Famëlartë.

(Mirza Tahir Ahmad *"Revelation, Rationality, Knowledge and Truth"*)

(*"Shpallja Hyjnore, arsyetimi, dija dhe e vërteta"*) f. 586-612, UK, 1998)



“DASHURI PËR TË GJITHË, URREJTJE PËR ASKËND”

“Dashuri për të gjithë urrejtje për askënd” – “Myslimanët për Paqe”. Këta janë dy nga sloganet e vendosura në 90 autobusë të Nju Jorkut, si pjesë e fushatës të sponsorizuar nga një organizatë myslimane e metropolit amerikan, që ka si synim reduktimin e apatisë ndaj Islamit dhe kultivimin e bindjes se ai është paqe dhe provomon paqen.

Mjetet e transportit urban të Nju Jorkut, lagjet Queens, Manhattan dhe Bronx, për një javë rresht do të mbajnë mbi shpinë mesazhe promovuese, pjesë e një fushate të gjerë islame, të cilat kanë si qëllim të kristalizojnë bindjen se Islami promovon paqen dhe drejtësinë dhe nuk ushqen urrejtje e antipati për askënd.

Fill pas nisjes së kësaj fushate ndaj kësaj nisme në adresë të zyrës që mbulon transportin publik të metropolit amerikan, kanë mbërritur ankesa të shumta, por



ato, gjithsesi, nuk janë marrë në konsideratë nga drejtuesit e këtij shërbimi, me argumentin se afishimi i tyre nuk përbën shkelje ligjore.

Duhet theksuar se kjo nuk është hera e parë që autobusët e Nju Jorkut mbajnë të stampuar mesazhe promovuese për projekte të ndryshme për sensibilizimin e opinionit publik.

Në pjesën e reklamës, krahas tekstit bosht, nga organizatorët është afishuar edhe një numër kontakti për personat që kanë dëshirë të dinë më tepër rreth Islamit, besimit që po koleksionon anëtarësime të reja në radhët e tij.

Marrë nga gazeta “Drita Islame”, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Nr. 8 (331), gusht 2010, faqe 3.

VËRTETËSIA

MBIZOTËRUESI, MBIKËQYRËSI. FUQIPLOTI, MADHËSHTORI. I GJITHËFUQISHMI. I MADHËRISHMI. KRIJUESI. FILLUESI. FORMËDHËNËSI. GJITHËFALËSI. MPOSHTËSI. DHURUESI. FURNIZUESI. ZGJIDHJEDHËNËSI. I GJITHËDITURI. SHTRËNGUESI. DHËNËSI. PËRULËSI. LARTËSUESI. NGRITËSI. NËNSHTRUESI. I GJITHËDËGJUESHMI. VËSHTRUESI. GJYKUESI. I DREJTI. I BUTI. I GJITHINFORMUARI. PËRDËLLIMTARI. FALËSI. MIRËNJOHËSI. I LARTI. I MADHI. RUAJTËSI. USHQYESI. LLOGARIMARRËSI. FISNIKU. BUJARI. VIGJËLUESI. LUTJEPRANUESI. GJITHËPËRFSHIRËSI. I URTI. I DASHURI. I LAVDISHMI. RINGJALLËSI. DËSHMUESI. I VËRTETI. PËRKUJDESESI. I FORTI. I PATHYESHMI. MBROJTËSI, PËRKUJDESESI, NGADHËNJIMTARI. I FALËNDERUARI. GJITHËNJOHËSI. NISMËTARI. RIKRIJUESI. JETËDHËNËSI. JETËMARRËSI. I GJALLI. I PËRJETSHMI. KREATORI. I NDERUARI. I VETMI. STREHIMTARI. I FUQISHMI. I GJITHËMUNDSHMI. NISMËTARI, PËRPARËSIDHËNËSI. PASLËNËSI. I PARI. I FUNDIT. I DUKSHMI. I PADUKSHMI. UDHËHEQËSI. I GJITHËLARTËSUARI. MIRËBËRËSI. PENDIMPRANUESI. NDËSHKUESI. MËKATFALËSI. I DHEMBSHURI. PUSHTETMBAJTËSI. DREJTËSIDHËNËSI. TUBUESI. I PASURI. PASURIDHËNËSI. PRIVUESI. DËMSJELLËSI. DOBIPRURËSI. DRITA. UDHËZUESI. SHPIKËSI. KRIJUESI I EKZISTENCËS NGA MOSQENIA. I PËRHERSHMI. TRASHËGUESI. FRYMËZUESI. DURIMTARI. I GJITHËMËSHIRËSHMI. MËSHIRËPLOTI. SUNDUESI. I PASTRI. I SHENJTI, I SHNDRITSHMI. PAQEDHËNËSI. SIGURUESI. MBIZOTËRUESI, MBIKËQYRËSI. FUQIPLOTI, MADHËSHTORI. I GJITHËFUQISHMI. I MADHËRISHMI. KRIJUESI. FILLUESI. FORMËDHËNËSI. GJITHËFALËSI. MPOSHTËSI. DHURUESI. FURNIZUESI. ZGJIDHJEDHËNËSI. I GJITHËDITURI. SHTRËNGUESI. DHËNËSI. PËRULËSI. LARTËSUESI. NGRITËSI. NËNSHTRUESI. I GJITHËDËGJUESHMI. VËSHTRUESI. GJYKUESI. I DREJTI. I BUTI. I GJITHINFORMUARI. PËRDËLLIMTARI. FALËSI. MIRËNJOHËSI. I LARTI. I MADHI. RUAJTËSI. USHQYESI. LLOGARIMARRËSI. FISNIKU. BUJARI. VIGJËLUESI. LUTJEPRANUESI. GJITHËPËRFSHIRËSI. I URTI. I DASHURI. I LAVDISHMI. RINGJALLËSI. DËSHMUESI. I VËRTETI. PËRKUJDESESI. I FORTI. I PATHYESHMI. MBROJTËSI, PËRKUJDESESI, NGADHËNJIMTARI. I FALËNDERUARI. GJITHËNJOHËSI. NISMËTARI. RIKRIJUESI. JETËDHËNËSI. JETËMARRËSI. I GJALLI. I PËRJETSHMI. KREATORI. I NDERUARI. I VETMI. STREHIMTARI. I FUQISHMI. I GJITHËMUNDSHMI. NISMËTARI, PËRPARËSIDHËNËSI. PASLËNËSI. I PARI. I FUNDIT. I DUKSHMI. I PADUKSHMI. UDHËHEQËSI. I GJITHËLARTËSUARI. MIRËBËRËSI. PENDIMPRANUESI. NDËSHKUESI. MËKATFALËSI. I DHEMBSHURI. PUSHTETMBAJTËSI. DREJTËSIDHËNËSI. TUBUESI. I PASURI. PASURIDHËNËSI. PRIVUESI. DËMSJELLËSI. DOBIPRURËSI. DRITA. UDHËZUESI. SHPIKËSI. KRIJUESI I EKZISTENCËS NGA MOSQENIA. I PËRHERSHMI. TRASHËGUESI. FRYMËZUESI. DURIMTARI. I GJITHËDITURI. SHTRËNGUESI. DHËNËSI. PËRULËSI. LARTËSUESI. NGRITËSI. NËNSHTRUESI. I GJITHËDËGJUESHMI. VËSHTRUESI. GJYKUESI. I DREJTI. I BUTI. I GJITHINFORMUARI. PËRDËLLIMTARI. FALËSI. MIRËNJOHËSI. I LARTI. I MADHI. RUAJTËSI. USHQYESI. LLOGARIMARRËSI. FISNIKU. BUJARI. VIGJËLUESI. LUTJEPRANUESI. GJITHËPËRFSHIRËSI. I URTI. I DASHURI. I LAVDISHMI. RINGJALLËSI. DËSHMUESI. I VËRTETI. PËRKUJDESESI. I FORTI. I PATHYESHMI. MBROJTËSI, PËRKUJDESESI, NGADHËNJIMTARI. I FALËNDERUARI. GJITHËNJOHËSI. NISMËTARI. RIKRIJUESI. JETËDHËNËSI. JETËMARRËSI. I GJALLI. I PËRJETSHMI. KREATORI. I NDERUARI. I VETMI. STREHIMTARI. I FUQISHMI. I GJITHËMUNDSHMI. NISMËTARI, PËRPARËSIDHËNËSI. PASLËNËSI. I PARI. I FUNDIT. I DUKSHMI. I PADUKSHMI. UDHËHEQËSI. I GJITHËLARTËSUARI. MIRËBËRËSI. PENDIMPRANUESI. NDËSHKUESI. MËKATFALËSI. I DHEMBSHURI. PUSHTETMBAJTËSI. DREJTËSIDHËNËSI. TUBUESI. I PASURI. PASURIDHËNËSI. PRIVUESI. DËMSJELLËSI. DOBIPRURËSI. DRITA. UDHËZUESI. SHPIKËSI. KRIJUESI I EKZISTENCËS NGA MOSQENIA. I PËRHERSHMI. TRASHËGUESI. FRYMËZUESI. DURIMTARI. I GJITHËDITURI. SHTRËNGUESI. DHËNËSI. PËRULËSI. LARTËSUESI. NGRITËSI. NËNSHTRUESI. I GJITHËDËGJUESHMI. VËSHTRUESI.

Përsosmëria e fjalës ALLAH

Kur njeriu mëson për ndonjë gjë, gjëja e parë që ai kërkon është emri i saj, pra si quhet ajo, etj. Ndaj duhet të dimë se si është emri i asaj qenie që është Krijuesi ynë dhe i gjithësisë, i cili në fenë hindu *Përmatma* apo *Përmeshvar*, në fenë zoroastriane Ai quhet *Ahura Mazda*, në fenë hebraike Ai quhet *Jehovah* dhe në fenë islame Ai quhet Allah. Ai ka emra të ndryshëm jo vetëm me bazë fetare, por edhe me bazë kombësie dhe gjuhe. Për shembull në shqip Atë e quajnë *Zot* ose *Perëndi*, në anglisht *God* ose *Lord* etj.

Nëse i analizojmë këta emra, mund të arrijmë në përfundim se ata janë bazuar mbi ndonjë atribut të Zotit. Për shembull, *Përmatma* ka prejardhjen nga fjalët *përm* (suprem) + *atma* (shpirt); në të njëjtën mënyrë *Përmeshvar* nga *përm* (suprem) + *ishwar* (hyj). Emri *Ahura Mazda*, që gjendet në fenë e lashtë zoroastriane do të thotë, Krijuesi më i madh. Për sa i përket emrit *Jehovah*, ai lidhet me *JHVH* që, në fakt, në arabisht është Ja Hu, do të thotë O Ai (i padukshëm). Gjuha arabe dhe hebraike janë shumë të ngjashme, madje kanë qenë dialekte të së njëjtës gjuhë. Shkurt, të gjithë emrat e Zotit, përveç atij Allah, tregojnëtribute të ndryshme të Tij. Vetëm

emri Allah është i përveçëm, ku çdo shkronjë është e kuptueshme, varësisht nga ndryshimet morfologjike që pëson fjala.

Këtu duhet të sqarojmë edhe dyshimin e disa dijetarëve që thonë se emri Allah është një trajtë e lakuar, pasi “Al” (ose “El” siç e shqiptojmë në shqip), në gjuhën arabe, përdoret si mjet morfologjik të shquarsisë dhe pjesa tjetër “lah”, në fakt, është “ilah”, që do të thotë qenie që adhurohet. Nga ky shpjegim, sipas tyre, Allah do të thotë “I adhuruari”, rrjedhimisht edhe emri Allah nuk është i parmë. Por Hazret Mirza Mahmood Ahmadi, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar, në librin e tij “*Hastie Bari T’ala*” (“Qenia e Krijuesit të Lartësuar”)¹ e hedh poshtë këtë mendim duke dhënë argumentin gjuhësor se në arabisht shumica e emrave të përveçëm nuk marrin nyjën “al” shquese, pasi ata shquhen vetë me individualitetin e tyre. Ndërsa emrat e tjerë, madje edhe mbiemrat që tregojnë cilësi apo ndonjë karakter tjetër, kur të shquhen marrin “al”. Pikërisht këtyre emrave të zakonshëm, kur u paravendoset pjesëza thirrmore

1. Mirza Mahmud Ahmadi, “*Hastie Bari T’ala*”, “*Envarul ulum*” vol. 6 f. 342-344.

“ja”, rregullisht u shtohen edhe fjalët “ejjuha”. Për shembull “Ja ejjuh-al-muminun” do të thotë, “O besimtarë”, ose “Ja ejjuh-al-arab” do të thotë “O arabë” etj. Në arabisht kurrë nuk thuhet “Ja al-muminun”. Pjesëza thirrmoreja “ja” pa pjesëzën “ejjuha” përdoret vetëm me emrat e përvetshëm. Duke kuptuar këtë rregull të gjuhës arabe, do të shohim se edhe emri Allah në arabisht, që nga lashtësia e gjer më sot, gjithmonë është trajtuar si emër i parmë, pasi në arabisht kurrë nuk u përdor “ja ejjuha-llah”, por vetëm “Ja Allah” gjë që tregon se emri Allah nuk është i prejardhur por është emër i parmë i Zotit të Madhërishtëm.

Kurani Famëlartë fillon me fjalët “Në emër të Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”. Ndërsa pas suresë El-Fatiha, që është çelësi i Kuranit, fillon sureja e dytë El-Bekare me tri shkronja “Alif-Lam-Mim”, që në fakt është shkurtimi i pohimit “Anallahu A’lem” (“Unë jam Allah, i Gjithëdijshtëm”). Pas këtij prezantimi, të gjitha atributet e Tij në Kuran, i referohen emrit Allah. Kështu që në Kurandin Famëlartë, ky emër i bekuar është paraqitur si emri i parmë i Krijuesit të gjithësisë. Kjo do të thotë se Allahu është ajo qenie ku kulmohen të gjitha vetitë e mira duke qenë njëkohësisht larg çdo të mete.

Mrekullia e emrit Allah

Ajo që thamë më lart, mbështetet edhe te forma e këtij emri. I përsosur si i emëuari i tij, ky emër deri në fund të shkronjës së tij, tregon të njëjtin personalitet. Kjo do të thotë se nëse do t’i heqim, një nga një nga fillimi deri në fund, të gjitha shkronjat e këtij emri, ai jep të njëjtin kuptim në çdo trajtë të tij për të cilin është emëruar. Më poshtë mund ta shohim këtë analizë:

Nr.	Me shkronja arabe	Shqiptimi me shkronja latine	Kuptimi në gjuhën shqipe
1.	الله	Allah(u) (Në arabisht zanoret nuk janë të domosdoshme të shkruhen, por ato lexohen sipas kontekstit)	Allahu
2.	للّه	lil-lah	i Allahut
3.	له	lah(u)	i Atij
4.	ه	Hu	Ai

1. Trajta e parë dhe e plotë përfaqëson emrin e Zotit të Lartësuar. Dihet që arabishtja shkruhet nga e djathta dhe po ashtu ajo si gjuha shqipe është gjuhë sintetike, pra gjuhë që i shpreh marrëdhëniet ndërmjet gjymtyrëve në fjali me anë të ndryshimeve të trajtave të vetë fjalëve.
2. Duke filluar nga shkronja e parë, nëse do t'i heqim shkronjën “*alif*” (a), trajta që del në gjuhën arabe lexohet “*lil-lah*”. Kjo fjalë, pavarësisht nga heqja e shkronjës së parë të saj, jo vetëm që mbetet kuptimplotë, por çuditërisht kuptimi i saj del “*i Allahut*” ose “*i takon Allahut*”. Në fakt, kjo fjalë jep kuptimin se çdo gjë i takon Zotit.
3. Në shkallën e tretë të zbërthimit të emrit Allah, kur i hiqet l-ja e fjalës “*lil-lah*” në arabisht ajo prapë mbetet kuptimplotë

duke mbartur përsëri thelbin e saj, pasi ajo lexohet “*lah(u)*” që do të thotë “*i Atij*”. Edhe kjo fjalë është e mjaftueshme për të dhënë kuptimin se gjithçka është e Tij. (Shenja <ω> bie, pasi ajo ishte për të treguar bashkimin e dy l-ve.)

4. Në shkallën e fundit kur i heqim edhe shkronjën e parafundit që është përsëri l-ja sërish mbetet kuptimplotë. Në këtë mënyrë do të mbetet vetëm “*h(u)*” që është trajtë e shkurtër të përemrit *Hua*, e cila në shqip do të thotë “*Ai*”. Sigurisht, kjo nuk është më pak se një mrekulli që pasi t'i hiqen emrit Allah të gjitha shkronjat, në fund përsëri mbetet Ai.

Në Kuranin Famëlartë Allahu i Madhërishëm thotë:

“Qoftë lartësuar emri i Zotit tënd, që është i Madhërishëm dhe i Nderuar!”²

2. Er-Rrahman, 55:79

ISLAMI DHE SHKENCA

përputhshmëria
apo
konflikti?



NUMRI IV



Nga prof. dr. Abdus Salam,
fitues i çmimit Nobel

Ky fjalim u mbajt nga prof. dr. Abdus Salami, fituesi i çmimit nobel në fizikë (1979) në UNESCO House të Parisit, më 27 prill të vitit 1984, pas ftesës nga organizata "Islam and the West" (Islami dhe Perëndimi). Takimin e inauguroi dr. Habib Chatti, sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Konferencës Islame. Sipas programit, në këtë takim ishin ftuar dy përfaqësues nga feja Islame, ndërsa dy të tjerë për të paraqitur pikëpamjen perëndimore. Nga pala islame ishte dr. Abdus Salami dhe dr. Hussein AlJzaeri, ish-ministrër i shëndetësisë së Arabisë Saudite dhe tashmë drejtor rajonal i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Nga ana perëndimore ishte prof. Louis Leprince-Ringuet, profesor në politeknikë Ecole dhe prof. Jean Bernard, president i Akademisë Franceze për Shkencën dhe drejtor i Institutit për kërkime 'Leukemia'.

KURANI FAMËLARTË DHE SHKENCA

Le të nisem me pohimin se unë jam mysliman dhe njëkohësisht një besimtar praktikues i fesë islame. Jam mysliman sepse i besoj mesazhit shpirtëror të Kuranit Famëlartë, i cili duke më dhënë shembuj nga kozmologjia, fizika, biologjia dhe mjekësia, më këshillon si shkencëtar t'i kushtoj rëndësi studimit të ligjeve të natyrës

Kurani thotë:

Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundura?!

[El-Gashije 88:18-20]

dhe thekson:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto. I lartësuar qofsh (nga çdo e metë)!” [Ale-Imran 3:189-190]

Kurani tregon epërsinë e *alimit*, pra atij që zotëron diturinë dhe mendjehollësinë, duke parashtruar pyetjen: Si mund të qëndrojnë këta, të cilëve u mungojnë këtotribute, përballë atyre që i zotërojnë ato? **Shtatëqind e pesëdhjetë ajete kuranore (pothuaj një e teta e librit) nxit besimtarët që të studiojnë natyrën, të përsiatin e të shfrytëzojnë arsyetimin në**

kërkimin e të përsosurit e për të kthyer kërkimin e diturisë dhe të kuptuarit shkencor në pjesën thelbësore të shoqërisë.

I Dërguari i Allahut ^{savs} ka theksuar se kërkimi i dijes dhe shkencës është detyrim i çdo myslimani dhe i çdo myslimanje. Ai urdhëroi ndjekësit e tij ta fitojnë dijen edhe nëse do t'u duhej të merrnin udhën për në Kinë në këtë kërkim. Këtu, pa dyshim, ai më shumë synonte dijen shkencore sesa atë shpirtërore, si dhe nënvizonte natyrën mbarënjerezore në kërkimet shkencore.

Ky duhet të jetë kushti paraprak, nga i cili duhet të nisët çfarëdolloj mendimi fundamental i Islamit. Krahas këtij kushti, do ta shtojmë atë që Maurice Bucaille ka pranuar shprehimisht në veprën e tij madhështore *“The Bible, the Quran and Science”* (Bibla, Kurani dhe shkenca):

‘Nuk ka asnjë ajet në Kuran, ku përmenden fenomenat natyrore dhe që bien në kundërshtim me atë që ne dimë me siguri nga zbulimet shkencore.’

Përpos këtyre vihet kushti i tretë; gjatë gjithë historisë islame, nuk ka ngjarë asnjëherë ajo që i ndodhi Galileut apo Gjordano Brunos. Persekutimet kanë qenë, dënimet publike madje përjashtime dhe bojkotkanë ndodhur, por gjithmonë për mospajtime doktrinare e jo për idetë shkencore. Aq më tepër, inkuizicioni i parë, i cili u shfaq në Islam, nuk drejtohej nga teologët ortodoks, por nga të ashtuquajturit racionalistët, *Mu'tazala*. Këta ishin teologët që krenoheshin për përdorimin e arsyetimit. I famshmi


Ahmad bin Hanbali ishte një ndër ata që iu nënshtrua tiranisë së tyre.

ZANAFILLA E ISLAMIT DHE SHKENCA

A në të vërtetë myslimanët e parë i kishin marrë seriozisht këto udhëzime të Kuranit të Shenjtë dhe të Dërguarit të Allahut ^{savs}?

Vetëm njëqind vjet pas vdekjes së Profetit të shenjtë ^{savs}, myslimanët i caktuan vetes zotërimin e shkencave të asokohshme si detyrë kryesore. Në një mënyrë sistematike, ata përkthyen gjithë korpusin e diturisë së deriatëhershme në gjuhën fetare, pra arabisht. Duke themeluar qendrat e studimit shkencor (*Bejtul Hikmah*), ata fituan epërsinë e padiskutueshme në fushën e shkencën që do të vazhdonte për treqind e pesëdhjetë vitet e ardhshme.

George Sarton në veprën e tij monumentale, *History of Science* (Historinë e Shkencës) përshkruan përmasën madhështore të kësaj arritjeje. Sarton ka ndarë historinë e tij të arritjeve të mëdha në fushën e shkencës në Epokë, ku secila Epokë shtrihet për një periudhë kohore prej pesëdhjetë vjetësh. Në krye të çdo epoke qëndron një figurë kryesore: bie fjala, 500-450 p.e.s. ishte epoka e Platos, e ndjekur nga epoka e Aristotelit, Euclidit, Arkimedesit dhe me radhë. Por nga 750 deri në 1100 është një seri e vazhdueshme epokash me emrat si Xhabiri, Kuarizmi, Razi, Masudi, Abul Uafa, Biruni dhe Umer Hajjam. Në këto 350 vjet kimistët, algjebriktët,



Ibni Rushd

mjekët, gjeografët, matematikanët, fizikanët dhe astronomët arab, turk, afgan dhe persian nga federata të ndryshme myslimane pushtuan skenën botërore të shkencave. Vetëm pas viteve 1100, nisen të shfaqen emra të parë perëndimorë në skemën e Sartonit, megjithatë akoma për 250 vjet të tjera, ata do të ndanin këtë nder me burrat e shquar myslimanë si Ibni Rushd, Nasiruddin Tusi dhe Ibni Nafis.

Një ndër arsyet kryesore pas arritjes së studimeve shkencore të Islamit ishte karakteri i tij mbarëbotëror. Perandoria myslimane tejkalonte kufijtë gjeografik e kombëtar dhe shoqëria e saj hershme ishte tolerante ndaj popujve të tjerë dhe ideve të tyre.

Një ndër aspektet e nderimit të shkencës në Islam ishte patronazhi që ajo gëzonte në perandorinë Islame. Mund të parafrazohet mendimi i H.A.R. Gibbit në lidhje me letërsinë arabe si një situatë paralele për shkencë "Në një shkallë më të gjerë, lulëzimi i shkencave ➔

VËRTETËSIA

në Islam ishte i kushtëzuar... me gjerësinë e botëkuptimit dhe nën patronazhin e gradave të larta. Ndërkaq shoqëria Islame ishte në rënie, shkenca humbi gjallërinë e forcën e saj. Por derisa, në një kryeqytet apo tjetrin, princat dhe ministrat gjenin kënaqësi, përfitim apo famë duke mbrojtur shkencën, pishtari vazhdoi të ndriçohej.”

EPOKA E ARTË E SHKENCËS NË ISLAM

Epoka e artë e shkencave në Islam padyshim ishte periudha e viteve 1000, pra epoka e Ibn-e-Sinasë (Avecenna), i fundit nga mesjeta dhe nga bashkëkohësit e tij, e i pari nga modernistët, të Ibn-al-Haithamit dhe Al-Birunit. Ibn-al-Haithami (Alhazen, 965-1039) konsiderohet një ndër fizikanët më të shquar e të gjitha kohërave. Ai parashtrroi tezën se një rreze drite, duke përshkuar përmes një ambienti, ndjek rrugën më të lehtë dhe “më të shpejt”. Në këtë mënyrë ai parashikonte parimin e Fermatit për ‘kohën minimale’ që ai do të paraqiste pas disa shekujsh.^a Ai gjithashtu parashtrroi tezën e inercisë (plogëtisë), e cila më vonë do të bëhej ligji i parë i lëvizjes te Njutoni. Ai shpjegoi procesin e thyerjes për nga marrëdhëniet materiale, duke studiuar lëvizjen e ‘grimcave të dritës’ kur ato përshkonin nëpër sipërfaqen e dy mjeteve, në përputhje me ligjin drejtkëndësh të forcës. Kjo arritje u ri-zbulua e u përpunua më vonë nga Njutoni. Pjesa V e ‘Opus Majus’-it të Roger Bacon-

it është pothuajse kopje e Optikës të Ibn-al-Haithamit.^b S’është për t’u çuditur se Bacon-i gjithmonë thoshte se njohja e gjuhës arabe dhe të shkencave arabe ishte e vetmja rrugë drejt dijes së vërtetë.

Al-Biruni (973-1048), bashkëkohësi i dytë e i shquar i Ibn-i-Sinasë punoi në Afganistan. Ai ishte shkencëtar që ndiqte metodën empirike ashtu si Ibn-i-Haithami. Ai ishte modern dhe jo-mesjetar në pikëpamjet e tij si Galileo, bashkë me të cilin ai do të ndante zbulimin e pavarur (paraprak) të ashtuquajturit ‘invariant Galilian të ligjeve natyrore’- një formulim emancipues sipas të cilit ato Ligje Fizike që veprojnë në tokë, janë në fuqi edhe mbi trupat qiellor në këtë gjithësi. Nuk ka asnjë pikë dyshimi se shkenca perëndimore është trashëgim greko-islam. Megjithatë, në përgjithësi mendohet se shkenca islame është një dukuri e përfutur. Sipas këtij mendimi, shkencëtarët mysliman ndoqën traditat teorike greke në mënyrë të verbër dhe nuk kontribuuan aspak në metodat shkencore.

Ky pretendim është i gabuar. Si në të gjitha periudhat e studimeve intensive shkencore, në fazën e parë njeriu bazohet në atë që ka trashëguar; ndërsa në fazën tjetër të formimit, ngrihen dyshimet mbi mësimet e mjeshtërive të parë. Kjo fazë ndiqet nga një ndërprerje. Një ndërprerje e tillë u shoqërua me lindjen e vrojtimit dhe eksperimenteve pikërisht në shkencat Islamike. Përfaqësuesit e shquar të kësaj kthese ishin Ibn-

al-Haitham dhe El-Biruni. Dëgjoni këtë vlerësim të Aristotelit nga el-Biruni. Dëgjoni vlerësimin që El-Biruni i bën Aristotelit:

“Problemi që kanë një shumicë njerëzish është tejkalimi në respektin e pikëpamjeve të Aristotelit. Ata janë të mendimit se pikëpamjet e tij nuk mund të kenë asnjë lajthitje, edhe pse ata dinë se Aristoteli thjesht merrej me përfundimet teorike në kapacitet të plotë, dhe asnjëherë nuk pohoi se pikëpamjet e tij ishin të mbrojtura nga Zoti dhe ai vetë kishte imunitet ndaj gabimeve.”

Ose ja shikoni përfundimin e ngulmët të tij për gjeologji:

“... por nëse ju të shikoni tokën Indiane me sytë tuaj dhe të përsiatni mirë natyrën e saj, nëse të studioni gurë të rrumbullakët që gjenden në thellësinë e saj, sado të gërmoni, që mund të jenë në përmasa të mëdha afër vendeve malore ku lumenjtë rrjedhin me rrymë të fortë, në përmasa të vogla larg vendeve malore ku lumenjtë rrjedhin të qetë e ngadaltë dhe të copëtuar (të pluhurzuar) në formën e rërës aty ku uji është i amullt (i ndenjtur) sidomos afër burimit të tyre ose afër grykës së derdhjes së lumenjve në det – po të shqyrtoni të gjitha këto fakte, me siguri do të arrish përfundimin se India dikur ishte një det dhe gjatë një periudhe të gjatë u mbush nga aluvioni i lumenjve.”

Më në fund, el-Biruni shkruan për besëtytnitë mesjetare:

Sipas popullit më datën 6 (të janarit) vjen një çast kur i gjithë uji i kripur shndërrohet në ujë të



Xhabir bin Hajan - Portreti i shek. XV që gjendet në bibliotekën Medicea Laurenziana në Firenze të Italisë

ëmbël. Meqenëse të gjitha veçoritë e ujit varen krejtësisht nga natyra e tokës... andaj këto cilësi e vlera kanë një farë qëndrueshmërie... prandaj ky mendim është plotësisht i pabazuar. Vëzhgimet dhe eksperimentimet e vazhdueshme do t'i tregojnë çdokujt kotësinë e këtij pohimi.”

SIPAS BRIFFAULTIT

“Ndonëse grekët ishin të parët që sistemuan, përgjithësuan dhe teorizuan (gjërat), por mënyra të ngadalta të hulumtimit, grumbullim i diturisë pozitive, metoda të hollësishme shkencore, shqyrtime të detajuara e të zgjatura dhe kërkime eksperimentale të gjitha ishin të papajtueshme në temperamentin grek. Atë që ne e quajmë shkencë, lindi në Evropë si rezultat i një frymëzimi të ri të shqyrtimit, të metodave të reja të kërkimit, të metodave të eksperimentit, të studimit, të përcaktimit dhe të zhvillimit të matematikës në ➔

një formë të panjohur te Grekët. Këtë frymë dhe këto metoda ia paraqitën Arabët botës evropiane. Shkenca moderne është kontributi më i rëndësishëm i qytetërimit Islam.”

Këto vlerësime të Briffaultit përforcohen nga Sartoni:

“Një ndër tragjeditë e historisë është se agimi i frymës moderne në shkencë udhëhequr nga el-Biruni dhe Ibn al-Haithami u ndërpre; ajo nuk arriti të sillte një ndryshim të përhershëm në metodologjinë shkencore. Vetëm pas njëqind vjetësh gjatë të cilëve punuan El-Biruni dhe Ibn al-Haithami, krijimi shkencor në Islam mori fund. Bota duhet të priste pesëqind vjet të tjera derisa të arrinte të njëjtin nivel pjekurie dhe këmbënguljeje në kërkim e eksperimentim me Tycho Brahen, Galileon dhe bashkëkohësit e tyre.”

RËNIA E SHKENCËS NË ISLAM

Sipas mendimit tim, fundi i shkencës organike ndër federata islame rrjedh kryesisht nga shkaqet e brendshme. Së pari nga izolimi i iniciativës sonë shkencore dhe së dyti nga dekurajimi e mospërfillja ndaj ndryshimit dhe risisë (*teklid*).

Pse krijimtaria shkencore u zhduk në Islam? Duke filluar nga vitet 1100 e.r., kjo tatëpjetë u përfundua rreth 1350 e.r. Pse ne nga toka Islame mbetëm mprapa? Askush nuk e di këtë me siguri.

Vërtet kanë qenë edhe arsytet e jashtme, si shkatërrimi i shkaktuar nga mësymja e Mongolit, ndonëse e rëndë, por kjo mësymje shkaktoi një ndërprerje. Sepse gjashtëdhjetë vjet pas Xhengzitet, nipi i tij Halagu do të themelonte një observator në Maraga, ku më vonë do të punonte Nasiruddin Tusi.

Sipas vështrimit tim, fundi i shkencave organike brenda federatave islame vjen më shumë nga shkaqet e brendshme – së pari nga izolimi i ndërmarrjes sonë shkencore dhe së dyti nga dekurajimi për ndryshim dhe risi. Fundi i shek. XI dhe fillimi i shek. XII ishte periudha me konflikte të mëdha fetare dhe sektare të motivuara nga interesa të ulëta politike. Madje dikush si Imam Gazali, shkroi në veprën e tij me famë *Ihjai ulumuddin* (Rilindje e Diturisë Fetare) rreth 1100 e.r.:

“Një krim i rëndë po bëhet kundër besimit nga njeriu që përfytyron se Islami mbrohet nga mohimi i shkencave matematike. Sigurisht e vërteta e shpallur nuk mban asnjë gjë që t’u kundërvihet këtyre shkencave përmes mohimit apo pohimit, ndërsa edhe këto shkenca nuk kanë qëllim t’i kundërvihen vërtetësisë së besimit.”


Edhe pse Imam Gazali shkroi këto fjalë, prirja e asaj kohe u kthye nga krijimtaria shkencore te sofizmi me shpirtëroren e tij dhe te mungesa e tolerancës për ndryshim (*teklid*) dhe risi në të gjitha fushat e diturisë përfshirë këtu edhe shkencat.

Për të ilustruar këtë plogështi e apati ndaj veprimtarisë shkencore

që kaploi gjithë Islamin, më lejoni të citoj Ibne Haldumin (1332-1406), një ndër historianët më të mëdhenjtë dhe nga intelektualet më të shquar të të gjitha kohërave. Ibne Haldumi shkruan në veprën e tij *Mukedima*:^c

“Ne kemi dëgjuar në kohë të fundit se në vendin e Frankut dhe në brigjet veriore të Mesdheut, gjendet një kulturë e pasur e shkencës filozofike. Thuhet se këto studiohen atje dhe mësohen në nivele të ndryshme. Shpjegimet sistematike ekzistuese që parashtrohen prej tyre, thuhet se janë gjithëpërmbledhëse, njerëzit që kanë dijeni për këtë janë të shumtë, ndërsa studentët e tyre janë akoma më shumë. Allahu e di më së miri se çfarë ndodhet atje. ... por një gjë është e qartë se problemet e fizikës nuk mbajnë ndonjë rëndësi tek ne në çështjet tona fetare. Prandaj ne duhet t’i lëmë mënjanë.”

Ibne Halduni tregon shumë pak kureshtje, por dëshirë aspak. Plogështinë që fjalët e tij duken se përcjellin na çon drejt një tërheqje nga brenda dhe një izolimi të ndërmarrjes sonë shkencore. Kush nuk e di se izolimi në fushën shkencore dhe respekti ndaj autoriteteve që e shkaktojnë atë, nënkupton vdekjen intelektuale. Gjatë ditëve tona më të bukura, në shek. IX dhe X, ne kishim gjetur në Bagdad dhe Kajro institute ndërkombëtare për studime të larta (*Bejtul Hikmah*) ku zhvilloheshin konkurse me famë botërore për shkencëtarët e studiuesit. Por që nga 1300 e.r., nuk ka më. Çfarëdo shkence që u kultivua,



Ibni Sina

ishte e përqendruar në shkollat fetare, ku traditat vlerësoheshin më shumë se sa përtëritja e risia. Të diturit e *Transoxianas*, pasi që mësuuan për hapjen e medresesë së parë, caktuan një shkencë serioze si **menesonial** në përkujtimin e shkencës së vdekur. Ata u treguan më korrekt në vlerësimin e tyre. E gjithë natyra enciklopedike e dijes dhe shkencës në Islam ishte pengesë në një periudhë specializimi. I tërë fakulteti i kritikës, përmes të cilit, një studiues i ri mund të dyshonte çka i mësohej, e rishqyrtonte dhe mund të parashtronte koncepte të reja, tashmë nuk as nuk lejoheshin e as inkurajoheshin.

Për të përfunduar historinë, nga koha e Ibne Haldumit, ky izolim intelektual e shkencor vazhdoi – madje edhe gjatë perandorive të mëdha Islame, gjatë perandorisë Osmane, perandorisë persiane Safvi dhe asaj indiane Mugal. Nuk mund të mendohet se këta sulltanë dhe *shehensha* s’kishin asnjë ➔

dijeni për avancime teknologjike të evropianëve. Është shumë e vështirë që ata të kishin mbetur të paditur nga epërsia e rrëmbyeshme e venedikasve apo gjenovezëve në prodhimin e armëve apo mjeshtërinë e portugezëve në lundrim dhe ndërtim anijesh, sidomos kur ata sundonin oqeanet e botës, përfshirë të gjitha ato që preknin kufijtë e vendeve myslimane si dhe rrugën detare të haxhit. Por një gjë është e sigurtë se myslimanët kurrë nuk arritën të kuptonin se mjeshtëria lundruese e portugezëve nuk ishte e rastësishme, por ajo ishte formuar në mënyrë shkencore dhe ishte kultivuar pas shumë përpjekjeve, duke filluar nga themelimi i institucionit kërkimor në Sagres, ngritur nga princ Henri Navigator në 1419.

A kjo dobësi buroi nga arroganca e keqpërdorur? William Eton, konsulli anglez në perandorinë Osmane, shkruan në një letër në vitin 1800:

“Askush nuk ka idenë për navigacionin dhe përdorimin e magnetit. Udhëtimi, si burim kryesor i shtrirjes dhe ngritjes kulturore është plotësisht i ndaluar nga shpirti arrogant i besimit të tyre dhe ... smira me të cilën vështrohen marrëdhëniet me të huaj – është i natyrës që nuk reflektohet në karakterin zyrtar – pra njeriu i shkencës së përgjithshme – nuk njihet veçse si një mjeshtër që duhet të merrej me prodhimin e topave, ndërtimin anijesh dhe etj., ai vlerësohet pak më mirë se një çmendur.”

Ai përfundon me një vërejtje, në një zë ogurzi modern:

“Ata pëlqejnë të bëjnë tregti me ata që u sjellin artikuj të dobishëm dhe të vlefshëm, pa menduar fare për të prodhuar ata.”

SHKENCA MODERNE DHE BESIMI

Çfarë është situata sot? Ndër të gjitha qytetërimet e mëdha botërore gjendja më e katandisur e shkencës është në vendet islame. Unë ndonjëherë dyshoj se disa prej myslimanëve besojnë se nëse teknologjia në themel është neutrale dhe skajshmëria e saj mund të zbutet përmes ndjekjes së etikës Islame, shkencë në anën tjetër vjen me një mendim të paracaktuar, që shkencë moderne me doemos duhet të na çojë drejt “arsyetimit” “racionalizmit” dhe përfundimit drejt braktisjes; domethënë ata që ndjekin shkencën ‘do të mohojnë përcaktimet e kulturës sonë’. Pikërisht në këtë mendim fshihet një fyerje ndaj vlerave tona kulturore për shkak të brishtësisë së tyre mendore. Por, duke e lënë mënjanë këtë vështrim, më lejoni të them: Mos luftoni betejat e së shkuarës kur të ashtuquajturit ‘filozofë racional’ me pikëpamjet e tyre dogmatike e të paarsyeshme, në doktrinën kozmologjike, që ata trashëguan nga Aristoteli, hasën vështirësi për t’i pajtuar këto koncepte me fetë e tyre.

Më duhet të rikujtoj që këto ndeshje ishin më të përgjakshme midis

studiuësve që u përkisnin shkollave krishtere të mesjetës. Problemet kryesore që i merakosnin këta studiuës lidheshin me kozmologjinë e metafizikën: ‘A toka gjendet në një vend të paluajtshtëm, a ekziston diçka përtej saj? Zoti a drejton gjithësinë lëvizës drejtëpërdrejt për një synim efikas ose Atij i intereson vetëm synimi përfundimtar? A të gjithë trupat qiellor vihen në lëvizje nga një forcë lëvizëse apo disa të tillë? A forcat lëvizëse qiellore kanë dobësi e lodhje? Çfarë është karakteri i lëndës qiellore? Ajo a i ngjan lëndës tokësore, për sa i përket cilësive të qenësishme si nxehtësi, ftohje, lagështi dhe thatësi? S’kemi pse të çuditemi kur Galileo u mundua për herë të parë të klasifikonte këto probleme, që i përkisnin domosdoshmërisht sferës së fizikës, për të gjetur përgjigjet e tyre përmes eksperimentimit fizik, ai u persekutua. Kthimi nga vendimi që u mor atëherë kundër tij po bëhet tani pas 350 vjetësh.

Më 9 maj 1983, në një ceremoni të posaçme në Vatikan, Shenjtëria e tij Papa Xhon Paul II në praninë e 33 nobelistëve dhe 300 shkencëtarëve të tjerë, deklaroi:

“Përvoja e Kishës, gjatë dhe pas çështjes së Galileos, e ka përcjellë te një qëndrim më të pjekur. ... Kisha nga ana e saj mëson vetë nga përvoja e shqyrtimi dhe ajo tashmë dallon më mirë kuptimin që i duhet dhënë lirisë shkencore ... një ndër cilësitë më të shquara të njeriut. Është kërkim përmes të cilit njeriu e arrin të vërtetën. ... prandaj Kisha është e bindur që nuk mund të ketë



Ibn-al-Haitham (965-1039)

asnjë mospajtim midis shkencës dhe besimit... (megjithatë) përmes një studimi modest dhe ngulmues (Kisha) ka mësuar të ndajë vetitë themelore të besimit nga sistemi shkencor i një periudhe të dhënë, veçanërisht kur duket se studimi i Biblës, i ndikuar nga kultura, detyrimisht lidhet me kozmogoni.

KUFIJTË E SHKENCËS

Në fjalët e tij, nëse Papa nënvizoi pjekurinë që Kisha kishte arritur në marrëdhënie me shkencën; ai gjithashtu duhet të kishte theksuar të kundërtën – pranimin e kufizimeve të disiplinave të tyre nga shkencëtarët që nga koha e Galileos – identifikimin e faktit se janë akoma shumë çështje që qëndrojnë përtej territorit të shkencës së sotme, madje edhe asaj të së ardhshmes. Edhe pse ne mund të hamendësojmë për disa probleme, por kurrsesi nuk mund të vërtetojmë spekulimet tona në mënyrë empirike. Ama ➔

është boshti empirik që qëndron në thelb të shkencës moderne. Ne jemi më modest se sa do të kishte qenë Ibne Rushdi (Averroesi). Ibne Rushdi ishte fizikan me njohuri të jashtëzakonshme, me kontribute të mëdha në studimin e ethes dhe të retinës. Ky është një ndër deklaramet e tij për përjetësinë shkencore. Megjithatë, në një disiplinë tjetër si ajo e kozmologjisë, ai pranoi spekulime e Aristotelit, pa i njohur se ato ishin vetëm spekulimet që mund të dilnin të gabuara në eksperimentimet e së ardhmes. Shkencëtari i sotëm di më mirë se kur e ku ai bën spekulime, ai nuk hedh deklarata për mbylljen e çdo lloj mendimi rreth tyre. Madje edhe për fakte tashmë të pranuar gjerësisht, ne bindemi që mund të zbulohen fakte të reja, të cilat pa i shtrembëruar zbulimet e mëparshme, mund të na shpien drejt përgjithësimi; pra duke sjellë ndryshime të mëdha në konceptet e botëkuptimit tonë.

Në fushën e fizikës, kjo ndodhi në krye të këtij shekulli me zbulimin e teorisë së relativitetit dhe kuantëve. Kjo mund të ndodhë sërish, sepse nëse po kufizohen rastet e koncepteve të reja, botëkuptimi ynë i deritanishëm po bëhet gjithnjë më i pranueshëm dhe më gjithpërfshirës.

Mua më është thënë të shtjelloj këtë pikë:

Unë kam përmendur për kthesën rrënjësore në konceptet e fizikanëve në lidhje me relativitetin e kohës. Na duket e pabesueshme se gjatësia e kohës së intervalit varet nga

shpejtësia, pra sa më shpejtë do të lëvizim, aq më gjatë do t'i dukemi në të jetuarit atij që nuk lëviz me ne. Kjo nuk është pjellë e fantazisë sonë. Ejani në laboratorit e grimcës elementare të CERN-it në Gjenevë, ku prodhohen grimca jetëshkurtëra siç është *mouni*, ose në laborator këtu në Orsaj dhe shënoni kohën intervale që kalohet derisa muaonët e shpejtësive të ndryshme prishen në elektron e neutron. Muonët me shpejtësi më të lartë pushojnë më vonë se sa ata që kanë shpejtësi të ngadaltë, pikërisht në përputhje me ligjin sasior (kuantitativ) të relativitetit, parashtruar për herë të parë nga Ajnshtajni në 1905. Fizikës iu desh shumë kohë për të vërtetuar apo kuptuar Ajnshtajnin. Fatmirësisht, me sa duket, filozofët akoma s'kanë kuptuar Ajnshtajnin. Me sa di unë, nuk ekziston asnjë sistem filozofik, që ngrihet mbi idenë e hapësirës dhe të kohës.

E dyta dhe mundësisht kthesa vendimtare në mendim erdhi në 1926 me parmin e Paqartësisë të Heisenbergut. Ky parim i përket ekzistencës së kufizimit konceptual në njohjen tonë. Ky konfirmon p.sh. se asnjë matje fizike nuk mund të tregojë se në këtë tryezë qëndron një elektron dhe që ai është në gjendje të palëvizshme. Mund të bëhen disa prova për të treguar se saktësisht ku ndodhet elektroni; por këto eksperimente do të asgjësojnë mundësinë e gjetjes së njëhershme të pyetjes se a elektroni është në lëvizje dhe nëse po, atëherë në çfarë shpejtësie? Njohja jonë ka një kufizim të qenësishëm

që me sa duket është i dekretuar. Unë rrëqethem nga tmerrri duke përfytyruar se çfarë do t'i ndodhte Heisenbergut, nëse ai do të ishte lindur në mesjetë – kur betejat teologjike mund ta kishin ndërkryer atë se vallë a mos ekziston kufizimi i ngjashëm për dijen që zotëron Zoti. Pra siç ndodhu, u plasën betejat, por në fushën e fizikës së shek. XX. Opinioni revolucionar i Heisenbergut, i përkrahur nga të gjitha prova të njohura, asnjëherë nuk është pranohet nga shumica e fizikanëve. Fizikani më i shquar i të gjitha kohërave, Ajnshtajni harxhoi një pjesë të bukur nga jeta e tij, duke kërkuar mangësitë në argumentet e Heisenburgut. Ai nuk arriti të mohonte provat eksperimentale, por shpresoi se prova të tilla mbase mund të shpjegoheshin brenda një sistemi tjetër teorik. Pavarësisht nga përpjekjet e përsëritura të Ajnshtajnit, një sistem i tillë akoma nuk është gjetur. Edhe pse vështirë

të shfaqet, por kush nga ne mund të shpallë se ai nuk do të gjendet kurrë.

A shkenca moderne i bie ndesh pasqyrimet metafizik? Le të shqyrtojmë disa shembuj rreth këtij konteksti nga mendimi modern shkencor:

Shembulli im i parë i takon doktrinës metafizike të krijimit nga asgjëja. Sot ne besojmë në kozmologji.

(Endnotes)

- a A.J. Arberry, *Revelation and Reason in Islam*, George Allen and Unwin, Londër, 1957, f. 19
- b Briffault, *Making of Humanity*, f. 190-202, i cituar nga Muhammad Iqbal, *The Reconstruction of Religious Thought in Islam* i ribotuar nga M. Ashraf, Lahore, 1971, f. 129-130
- c Ibn Khaldun, *The Muqqamidah* i përkthyer nga f. Rosenthal, Routledge dhe Kegan Paul, Londër 1958, ribotuar në *The Muslim World on the Eve of Europe's Expansion* redaktuar nga J. Saunders, f. 131-134 botuar nga Prentice Hall, Englewood Clif N. J. 1966

Përkthyes: Çapajev Zera, Shahid Ahmad Butt

A është e lejuar muzika në ISLAM?

Hazret Mirza Tahir Ahmed,
Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar

Po paraqesim një pjesë me pyetje-përgjigje të një mbledhjeje me Hazret Mirza Tahir Ahmed r.a., Kalifit të Katërt të Mesihut të Premtuar.

Pyetësi: “Dikush që njoh ka një ves të keq për të dëgjuar muzikë. Pyetja ime është :

Cila është pikëpamja juaj për muzikën në Islam”?

Hazret Mirza Tahir Ahmed^{r.a.} :

Varet nga shkalla e zakonit dhe natyra e muzikës. Muzika në vet-vete nuk mund të gjykohet si tërësisht e keqe. Parimi islam është se nëse dëmi i diçkaje është më shumë se 50%, atëherë ajo duhet refuzuar, dhe nëse dëmi i saj është më pak se 50%, atëherë mund t'i marrim të mirat e saj, ndërsa të

këqijat mund t'i refuzojmë. Kurse muzika bie në “zonën neutrale”, ajo as nuk është e ndaluar tërësisht, as nuk është e lejuar pa asnjë kusht.

Ne e dimë që në kohën e Hazret Profetit Muhamed s.a.v.s. kur ai hyri në Medinë, gratë e Medinës, duke e mirëpritur atë, këndonin

këngë mirëseardhjeje, gjithashtu ato u binin daulleve që quhen Def. Pra, ajo ishte një lloj muzike që përdornin arabët. Asnjë nuk mund të thotë që ajo nuk ishte muzikë. Megjithatë, nuk ishte praktika e të Dërguarit s.a.v.s. që të lejonte shokët të jepeshin pas muzikës e t'i dorëzoheshin asaj, e as nuk ishte zakoni i tyre. Përkundrazi ata shijonin recitimet e Kuranit, ose duke dëgjuar poezitë e mira e kuptimplota të poetëve të mëdhenj. Por shija e tyre u zhvillua gradualisht dhe së fundmi ata u zhvendosen nga poezia te Kurani.

Pra, duhet kohë dhe durimi për të përmirësuar cilësinë e shijes suaj, dhe pa bërë këtë gjë, do të ishte mizore të detyroni dikë që të braktisë disa gjëra menjëherë. Në këto gjëra është çështje shijesh. Ne disa gjëra të tjera çështja e ndalimit është e prerë dhe ju nuk mund ta ndryshoni atë. Për shembull, ju nuk mund të thoni se dua të përmirësoj shijen time për ujin prandaj nuk e lë verën menjëherë. Kjo nuk është e lejuar, sepse vera është e ndaluar, dhe ajo që është e ndaluar është e ndaluar. Ndërsa muzika nuk bie në këtë kategori.

Për këtë ju mund të zgjidhni një rrugë të zgjuar drejt një rregullsie


graduale për të hequr dorë nga ai zakoni. Për sa i përket muzikës pop, nuk e di se si njerëzit e tolerojnë atë. Është plotësisht e pakuptimtë. Kur njerëzit dëgjojnë atë lloj muzike, ata dalin në një farë çmendurie dhe një dëshire të flaktë të cilën ata s'mund ta shuajnë. Shija që lë pas kjo e ashtuquajtur muzikë moderne është shumë e pahijshme dhe e keqe kurse shoqëria në ndikimin e saj po bëhet më e shëmtuar dhe më e pakujdesshme, duke e lejuar veten për të prishur vlerat tradicionale. Ndaj, një muzikë e tillë padyshim është e keqe dhe konsiderohet si gjynah.

Ju nuk mund të trajtoni të gjitha llojet e muzikës njësoj. Prandaj them, se duhet të jeni të mençur në përzgjedhjen e shijes suaj. Një dëgjim rastësor i muzikës nuk mund të konsiderohet si diçka që ju çon në xhehenem, sigurisht që jo. Megjithatë, nëse nga një dëgjues i rastit i muzikës, ju

largoheni nga gjërat që kanë vlerë më të madhe, pra nga përkujtimi Allahut të Madhërishëm dhe nga namazet, aq shumë sa ajo ju është bërë synimi i shpirtit tuaj dhe si diçka e pazëvendësueshme, atëherë sigurisht jeni humbës.

Shqipëroi: Markelian Shparthi

Varet nga shkalla e zakonisht dhe natyra e muzikës. Muzika në vetvete nuk mund të gjykohe si tërësisht e keqe. Parimi islam është se nëse dëmi i diçkaje është më shumë se 50%, atëherë ajo duhet refuzuar, dhe nëse dëmi i saj është më pak se 50%, atëherë mund t'i marrim të mirat e saj, ndërsa të këqijat mund t'i refuzojmë. Kurse muzika bie në "zonën neutrale", ajo as nuk është e ndaluar tërësisht, as nuk është e lejuar pa asnjë kusht.



HIXHABI

“Gjatë viteve të fundit, *hixhabi* apo *shamia* Gështë kthyer në një çështje në Evropë. Veçanërisht në Francë, është bërë mjaft zhurmë, dhe tashmë ata po mendojnë seriozisht për të nxjerrë legjislacionin, i cili do të ndalojë pjesërisht *hixhabin*. Duke ndjekur gjurmët e Francës, politikanët në vende të tjera evropiane, për interesa të tyre politike, bëjnë deklarata duke mbështetur ndalimin e *hixhabit*, dhe kështu kjo çështje është kthyer në një mjet për të lënduar ndjenjat e myslimanëve.

**Hazret Mirza Masroor Ahmad,
Kalif i Pestë i Mesihut të Premtuar**

Sa herë që kam menduar për Skëtë çështje, unë nuk arrita të kuptoja se çfarë problemi qëndron te *hixhab* që qeveritë e konsiderojnë një kërcënim. A mos vallë veshja e palltos dhe mbulimi i kokës dhe mjekrës me një copë pëlhurë janë krime aq të rënda që u dashka një parlament i tërë të mblidhet dhe të miratojë një legjislacion të tillë kundër tyre? Nëse është e ndaluar për një femër që të mbulojë kokën e saj me një copë rrobe, atëherë pse u lejohet burrave veshja e kapelave dhe beretave mbi kokat e tyre? Kjo do të thotë se një ndalim mund të sugjerohet edhe kundër këtyre kapelave.

Kohët e fundit kam parë një karikaturë në një gazetë ku tregohet një grua me shami duke qëndruar pranë një djali të ri me beretë. Djali i thoshte gruas “jo *burka*” ndërsa gruaja i thoshte djalit “jo beretë”.

Pra, këto çështje janë kthyer në sarkazma dhe ironi; mirëpo njerëzve mendjekthjellët që mbajnë frerët e zbatimit dhe legjislacionit, nuk u duhet të ndërhyjnë në këto çështje. A duhet miratuar legjislacioni kundër grave të krishtera apo çifute që i përmbahen veshjes fetare? Nëse vendoset ndalimi ndaj myslimanëve, atëherë edhe vendet myslimane si kundërpërgjigje mund të vënë kufizimet ndaj veshjeve perëndimore. Kjo çështje ka mundësi të shndërrohet në një top dëbore që

mund të prishë paqen botërore.

Megjithatë, nëse shamia fsheh identitetin e një personi dhe është e domosdoshme që ajo të hiqet për ta identifikuar atë, atëherë qeveritë apo autoritetet kanë të drejtë të bëjnë kështu. Por çfarë parodie, që femrës t'i mohohet e drejta e udhëtimit vetëm sepse ajo mban shami, ose dikujt t'i mohohet e drejta e mjekimit në spital dhe të lihet në mëshirë të fatit sepse ajo ishte e mbuluar. Atëherë, fjala bie, një vajzë gjeniale që renditet në krye të klasës së saj, e cila nuk është thjeshtë një myslimane por një pasuri për shtetin ku jeton, është besnike ndaj shtetit të saj në çdo mënyrë të mundshme aq shumë sa kjo dashuri ndaj atdheut i është ngurtësuar përbrenda dhe ajo mund të sakrifikojë të gjitha aftësitë dhe zotësitë e saj për zhvillimin e atij shteti – nëse kësaj vajze i hiqet e drejta për të vazhduar shkollën vetëm sepse ajo zgjodhi të mbante shami, jo nga imponimi por nga dëshira e saj vullnetare; a nuk është kjo njësoj me mohimin e të drejtave të saj si qytetare? A nuk shërben ky legjislacion që ia mohon të drejtën e arsimit, si një metodë për të humbur talentin kombëtar?


Ky legjislacion akoma nuk është miratuar në Gjermani, por për shkak të rregullave vendosura nga

administratat e disa shkollave, një vajze myslimane ahmadiane, të cilën e njoh personalisht dhe është ndër nxënësit më të zgjuara, i mohohet e drejta e arsimit. Janë akoma mjaft raste të tilla.

Ky talent kombëtar apo e ardhmja e vendit nuk lejohet të realizohet, vetëm sepse një vajzë myslimane dëshiron t'i shërbejë atdheut dhe njëkohësisht do që të praktikojë fenë e saj me vullnetin dhe dëshirën e saj. Një vajze i mohohet e drejta e saj e arsimit vetëm sepse ajo mban një copë pëlhure mbi kokën e saj.

Nëse ky është krim atëherë gjatë dimrit të gjitha grave evropiane, u duhej hequr e drejta për të vënë shall mbi kokat e tyre. Sigurisht, është e nevojshme të vendoset se a përdormi i kësaj pëlhure një metrosht është vërtetë një krim i tillë që t'i mohohen dikujt të drejtat e saj elementare.

A është ky përkufizim i qeverive moderne demokratike që pretendojnë se mbrojnë të drejtat e popullit të tyre? A është kjo metodë për të afruar popuj të ndryshëm? A është kjo rrugë për të ushqyer dashuri nëpër njerëz? Sigurisht, çdo person me mendje të shëndoshë do ta kundërshtojë këtë sepse këto gjëra vetëm do të ngrenë më shumë murin e urrejtjes dhe do të shkatërrojnë paqen globale.”





AUROLA
BOREALE
(dritat veriore)
dhe
përmendja e saj
në KURAN

NUMRI IV

Kurani i madhërishëm është shpallja hyjnore që ia heq perden sekreteve dhe dukurive të fshehura dhe na orienton drejt kërkimit dhe studimit të universit për të gjetur gjurmët e Krijuesit. Ai mban shumë paralajmërime dhe profeci që tashmë janë fakte të njohura shkencore. Përveç astronomisë, fizikës, gjeografisë, gjeologjisë, oqeanologjisë, biologjisë, botanikës dhe shumë shkencave të tjera, Kurani zbulon fakte të reja dhe dukuri të fshehta edhe në fusha të tjera, që vërtetojnë në radhë të parë natyrën e tij hyjnore dhe përforcojnë pohimin e tij e të qenit fjala e Zotit të Gjithëdijshëm.

Kurani jo vetëm që nxit lexuesit për të studiuar dhe shqyrtuar krijimin e gjithësisë por i vlerëson duke thënë:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të tokës.” [Ale-Imran 3:191-2]

Sipas Kuranit, qëllimi i këtij hulumtimi duhet të jetë gjetja e argumenteve për faktin se gjithë ky është krijuar nga Zoti i Plotfuqishëm, në krijimin e të Cilit nuk gjendet asnjë mangësi, siç thotë Allahu në një vend tjetër:

“Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.” [Al-Mulk 67:45]

Siç Allahu ka krijuar thesaret fizike për të plotësuar nevojat e njeriut ashtu edhe botëkuptimet e Kuranit janë të pashtershme dhe me shtresëzime të tilla, që shfaqen në çdo kohë, çdo shekull me një trajtë tjetër, për të frymëzuar besimtarin me fuqinë e besimit hyjnor. Rreth kësaj Kurani thotë:


“Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; dhe Ne nuk zbresim diçka prej tij, por vetëm me masë të caktuar.” [Al-Hixhrr 15:22]

Kështu që në Kuran gjenden shumë ajete që mbajnë temat e krijimit të universit aq bukur sa që nuk mund të hasim në asnjë libër tjetër. Një nga këto ajete është përmendur në suren “Al-Hadid” ku Allahu diskuton një temë që njeriu gjatë shekujve e ka kuptuar vetëm në aspektin shpirtëror. Ai s’kishte mundësi të zbulonte fakte të fshehura shkencore në të.

“Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni.” [Al-Hadid 57:5]

Le të hulumtojmë se a qëndron pohimi i Kuranit që është libër hyjnor dhe udhërrëfyes për të gjithë njerëzimin duke e peshuar sipas kriterit të shkencës.

Tani përshtkrimin që bën Kurani i përngjan më së miri dukurisë së Aurorës boreale ose ndryshe agimit polar të veriut apo të jugut. Aurorat janë dritat natyrore që shfaqen në qiell, dhe zakonisht vëzhgohen gjatë natës dhe shoqërohet nga një tingull i lehtë ose kërcëllitje. Këto drita shfaqen sidomos në zonat polare sepse këtu periudha e errësirës është më e gjatë si dhe gjenden fusha magnetike. ➔



Kurora e diellit që u duk gjatë eklipsit të vitit 1999

Meqenëse këto drita duken vetëm në qiellin e hemisferës veriore prandaj quhen ndryshe agimi verior apo Aurora boreale. Këtu fjala *Aurorë* vjen nga hyjnesha romake e agimit, ndërsa *Boreas* është fjalë greke për erën veriore. Këto shfaqen më së shpeshti nga shtatori deri në tetor dhe nga marsi deri në prill.

Benxhamin Franklini ishte i pari që tërhoqi vëmendjen ndaj këtij “misteri të agimit verior”. Ai i teorizoi këto drita të lëvizshme si koncentrimi i ngarkesave elektrike në vende polare që rriten dhe shtohen nga bora e lagështi të tjera.^a

MEKANIZMI I AURORËS

Dielli është ylli qendror në sistemin diellor ku bën pjesë edhe planeti ynë. Dielli përbëhet nga plazma e nxehtë që ndërthuret me fushat magnetike. Ai është 109 herë më i madh se toka jonë ndërsa masa e tij është 2×10^{30} kilogram, pra 330,000 herë më shumë se toka. Përafërsisht $\frac{3}{4}$ e masës së diellit përbëhet nga hidrogjeni ndërsa pjesa tjetër kryesisht nga heliumi. Temperatura e diellit në sipërfaqe mund të jetë 5505°C ndërsa në bërthamë kjo mund të arrijë deri në $15,000,000^\circ\text{C}$.

Atmosfera e diellit tonë përbëhet nga grimca të ngarkuara të protonit dhe elektronit. Kjo kurorë duket më së miri kur dielli eklipsohet plotësisht nga hëna. Çdo orë dielli lëshon afërsisht 7 miliard tonë grimca të tilla në hapësirë. Rryma e këtyre grimcave të ngarkuara quhet erë diellore. Erërat diellore shkaktojnë fenomene të ndryshme, p.sh. stuhi gjeomagnetike, që mund të shkatërrojë sistemin elektrik në botë, aurora (dritat veriore dhe jugore) etj.

Aurora (*aurorae*) është shfaqja e natyrshme e dritës në qiellin arktik dhe antarktik, që shkaktohet nga përplasja e grimcave të atomit, të ngarkuara me energji lartë në atmosferë (*Termosferë*). Fenomeni i aurorës është një bashkëveprim midis fushës magnetike të tokës dhe erës diellore. Aurorat shkaktohen nga përplasja e grimcave të ngarkuara (në përgjithësi elektrone por dhe protone) që qëndrojnë në magnetosferën e tokës me atomet dhe molekulat që qëndrojnë në atmosferën e sipërme të tokës (në lartësi rreth 80 km lart (50 milje)). Elektronet dhe protonet që qëndrojnë në magnetosferën e tokës

kanë burim Diellin që dalin në formën e një ere diellore. Shpejtësia e kësaj ere diellore ndryshon nga 300 deri në 1000 km/sek, duke bartur një fushë magnetike diellore. Sa më e madhe të jetë era diellore, aq më e fuqishme është shfaqja e aurorës. Kur këto elektrone dhe protone të ngarkuara arrijnë në afërsinë e tokës bashkë me erën diellore dhe fusha e mbyllur magnetike e erës diellore orientohet në mënyrë të përshtatshme (kryesisht drejt jugut), atëherë ajo takohet me fushën magnetike të tokës dhe kështu grimcat diellore hyjnë në magnetosferë dhe mbliidhen në *magnetotail*. Lidhje të tilla magnetike shpejtojnë më tej lëvizjen e grimcave diellore drejt tokës.

Përplasja elektrike në atmosferë ngjall kërcime dhe lëvizje të shpeshta tek elektronet (një dukuri ku energjia kinetike e elektronit shndërrohet në dritën e dukshme); dhe molekulat në atmosferën e sipërme. Kjo energji e ngacmimit mund të humbet nga emetimet e dritës dhe përplasjet. Shumica e aurorave kanë emetime të gjelbra dhe të kuqe që shkaktohen nga atomet e oksigjenit. Gazra të ndryshme, që bashkëveprojnë me atmosferën e sipërme, prodhojnë ngjyra të ndryshme në varësi të përbërësve të oksigjenit dhe nitrogenit. Edhe Niveli i gjallërisë të erës diellore mund të ndikojë ngjyrën dhe intensitetin e aurorave. Për sa i përket formës së aurorave, ato shfaqen si flakërime të shpërndara ose si mjegull apo perde që shtrihen nga lindja deri në perëndim. Ato evoluohen dhe ndryshohen vazhdimisht. Çdo perde përbëhet nga rrezet paralele, ku secila rreshtohet sipas drejtimit

të lokalizuar të vijave të fushës magnetike, gjë që siguron se format e aurorave drejtohen nga fusha magnetike e tokës. Forma e aurorës ndryshon. Vija të shndritshme drite ngrihen deri në 100 km nga toka dhe shtrihen mbi fushën magnetike. Harqet që mund të krijojnë një aurorë arrijnë një gjerësi minimale prej 100 metrash që ndryshojnë vazhdimisht. Pas mesnate aurora krijon disa njolla, të cilat ndriçojnë me një pulsim çdo 10 sekonda.


ERËRAT DIELLORE DHE MAGNETOSFERA

Toka vazhdimisht përplasat nga era diellore që përbëhet nga rryma e plazmës së nxehtë (të gazit me elektronet dhe jonet pozitive). Këto elektrone dhe jone pozitive emitohen nga dielli në çdo drejtim si pasojë e nxehtësisë deri në miliona gradë në kurorën e diellit. Era diellore arrin tokën zakonisht me një shpejtësi prej 400km/sek.

Magnetosfera e tokës është hapësirë që përbëhet nga zona magnetike e saj. Kjo krijon një pengesë për erën diellore, duke e detyruar të devijohet rreth sipërfaqes së tokës prej një distance rreth 70,000 km nga toka.

ZBULIMET E PARA TË KËSAJ DUKURIE

Ndonëse eksploruesi dhe gjeologu i Greqisë së lashtë Pytheas-i ishte i pari që përmendi aurorën, ishin Hiorter-i dhe Celsius-i që në 1741 shpjeguan praninë e kontrollit magnetik, thënë ndryshe që luhatje të mëdha magnetike ndodhin gjithmonë kur aurora vëzhgohej nga sipër. Kjo bëri që të mendohej (më vonë) se shumë rryma të mëdha magnetike ishin lidhur ➔



Credit : Magnetosphere: NASA, the Sun: ESA/NASA SOHO

me dukurinë e aurorës. Fizikani norvegjez Kristian Birkelandi (1908)^b nxori përfundimin se këto rryma rridhnin në drejtim lindje-perëndim pranë harkut të aurorës.

Më 26 shkurt 2008, studimet e THEMIS-it përcaktuan, për herë të parë, ngjarjen shkrehëse që shkaktonte nisjen e nën-stuhisë magnetosferike.^c

Ishte Elias Loomis-i (1860) dhe më pas Hermanz Fritz-i (1881)^d që me më shumë detaje përcaktuan se aurorat shfaqen vetëm në zonat e përcaktuara, një rajon në formën e unazës me rradisun (rreze) afërsisht 2500 km gjerë rreth polit magnetik të tokës.

ORIGJINA E KËSAJ DUKURIE

Tani le të kthehemi përsëri te Kurani për të gjetur përmendjen e kësaj dukurie të rrallë para katërbëdhjetë shekujsh. Nëse del që Kurani e paralajmëron atë, atëherë duhet t'i bindemi faktit se kjo nuk është fjala e Muhamedit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) që vetë

nuk dinte as të lexonte e as të shkruante, por është fjala e Zotit të tij, të Gjithëdijshmit dhe të Plotfuqishmit.

Janë dy parime të përgjithshme në dukurinë e aurorës:

1. Zbritja e grimcave të ngarkuara zakonisht, jonet pozitive nga dielli në formën e erës diellore mbi atmosferën e sipërme të tokës.
2. Prania e atomeve dhe molekuleve në atmosferën e sipërme të tokës (afërsisht në lartësi prej 80 km) që dalin pikërisht nga fusha magnetike të tokës, pra nga magnetosfera.

Tani le të lexojmë fjalët e Kuranit:

“Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij.”

A ka ndonjë mënyrë tjetër për të përshkruar gjithë fenomenin e aurorës më bukur se kjo. Sigurisht që jo. Kjo vërteton se fjala e Zotit, Kurani Famëllartë dhe veprimi i Zotit, shkenca, nuk kanë asnjë konflikt



Kamping nën dritat veriore në Kanada

me njëri-tjetrin, përkundrazi ata janë në përputhje të plotë.

Si përfundim dua të citoj ato fjalë që Dr. Maurice Bucaille përmendi duke përfunduar librin e tij të famshëm “Bibla, Kurani dhe Shkenca: Shkrime të shenjta, studiuar në dritën e dijes moderne”. Ai shkruan:

“In view of the state of knowledge in Muhammad’s day, it is inconceivable that many of the statements in the Qura’n which are connected with science could have been the work of a man. It is, moreover, perfectly legitimate, not only to regard the Qura’n as the expression of a Revelation, but also to award it a very special place on account of the guarantee of authenticity it provides and the presence in it of scientific statements which, when studied today, appear as challenge to human explanation.”

“Duke marrë para sysh nivelin e diturisë në kohën e Muhammedit, është e pabesueshme se shumë nga temat që lidhen me shkencën në Kuran, nuk mund të jenë nga dora e njeriut. Por, është plotësisht e

arsyeshme që Kurani, jo vetëm që të konsiderohet shprehja e shpalljes hyjnore, por t’i caktohet atij një pozitë e veçantë, për arsye se siguron autencitetin e mirëfilltë dhe është i pajisur me temat shkencore që, nëse studiohen sot, e sfidojnë shpjegimin njerëzor.”^e

Shahid Ahmad Butt

Shënime

a) Për përshkrimin e dukurisë së aurorës apo për detajet e saj, jemi bazuar te të dhënat që gjenden në faqen e *Wikipedia-s*.

“Aurora (astronomy).” *Wikipedia, The Free Encyclopedia*. 4 Sep 2009, 08:52 UTC. 4 Sep 2009 <[http://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Aurora_\(astronomy\)&oldid=311802793](http://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Aurora_(astronomy)&oldid=311802793)>.

<http://www.loc.gov/exhibits/treasures/franklin-scientist.html>

b) Birkeland, Kristian (1908). “The Norwegian Aurora Polaris Expedition 1902-3.”

http://www.nasa.gov/mission_pages/themis/auroras/themis_power.html

d) Fritz, Hermann (1881). “Das Polarlicht.”

e) Dr. Maurice Bucaille, *The Bible, The Qur’an and Science, The Holy Scriptures Examined in the light of Modern Knowledge*, Tahrike-Tarsile-Qura’n Inc., New York 11373, 2003, ISBN 1-879402-98-X, f. 269

Kujtim



MUSA RRUSTEMI (1968 - 2010)
President i Xhematit Mysliman Ahmadia të Kosovës

Çdo ditë jeta lind e shfaqet në forma të ndryshme në këtë tokë dhe po aq herë ajo largohet në mënyrë të pavënëre. Vetëm një numër i vogël njerëzish mund ta kapërcejnë përditshmërinë e tyre dhe të lëshojnë gjurmë të thella mbi mendjen, kujtesën dhe zemrat e brezave. Këto figura të jashtëzakonshme ngjallin epokat historike në jetën e një populli.

Ashtu siç Allahu i kishte dhuruar të Dërguarit të Tij Muhammedit ^{sav} ndjekës të devotshëm dhe besnik, Ai gjithashtu i dha shërbëtorit të tij shpirtëror, Mesihut të Premtuar ^{alejhiselam} ndjekës të tillë që manifestuan nivele të reja të besimit, devotshmërisë dhe sakrificës ashtu siç paraardhësit e tyre, *es'habët* i kishin dëshmuar para botës. Duke rrjedhur nga etnitete dhe rajone të ndryshme, këta bijtë dhe bijat e Xhematit Mysliman Ahmedia po ndriçojnë shtëpitë, fshatrat, qytetet dhe vendet e tyre përmes asaj dritës shpirtërore që u është dhuruar nga Zoti i Plotfuqishëm.

Pa dyshim, ndër këta shpirtra të bekuar, ishte edhe vëllai ynë i ndjerë Musa Rustemi, ish-presidenti i Xhematit Mysliman Ahmedia të Kosovës, i cili u nda nga jeta më 5 gusht 2010 në një ngjarje tragjike. *Inna lillahi ue inna ilejhi rra'xhi'un.* (Sigurisht, ne jemi të Zotit dhe tek Ai do të kthehemi). Natyrisht, vdekja e tij u ka shkaktuar një tronditje të rëndë jo vetëm familjes dhe të afërmve të tij, por gjithë xhematit Mysliman Ahmedia dhe në veçanti atij që e kishte njohur më parë. Ai ishte një besimtar i patundur me

vepra e sjellje të shkëlqyera dhe shembullore. Ishte një shërbëtor besnik i sistemit të Kalifatit. Ai ishte mik dhe dashamirës i çdokujt, me një vendosmëri të palëkundshme por njëkohësisht mjaft i përlulur. Fytyra e tij gjithmonë shkëlqejte me një buzëqeshje ndërsa në sfond i rrihte mendimet e thella. Për çdo nevojë ai gjithmonë gjendej i pranishëm. Vërtet, ai ishte një shok i shkëlqyer dhe një vëlla shumë i dashur.

Musa Rustemi lindi më 8 qershor 1968 në fshatin Kokaj, afër qytetit Gjilan, rreth 70 kilometra larg nga kryeqyteti Prishtina në juglindje të Kosovës. Ai i përkiste një familje të madhe, ku përveç tij ishin 4 djem dhe 4 vajza. Ai ishte më i vogël ndër vëllezërit e tij. Kontaktet e para të familjes së tij, me xhematin u vendosën në vitet 70, kur një nga kushërinjtë e tij, që punonte si emigrant në Zvicër, filloi të vizitonte xhaminë “Mahmud” në qytetin Zyrih bashkë me shokët e tij. Kjo xhami ishte ndërtuar nga Xhemati Mysliman Ahmedia. Më pas në vitet 1981-82, një ish-misionar i xhematit me emrin Mushtak Baxhva që kishte shërbyer në Zvicër, vizitoi qytetin e Gjilanit. Por ngjarja më e rëndësishme ngjau në pranverën e vitit 1985 kur një Ahmedian danez z. Hansenit vizitoi familjen e tij në fshatin Kokaj. Atë vit edhe vëllai i tij i madh dr. Isa Rustemi dhe kushëriri i tij z. Fejzullahu do të udhëtonin për Anglinë për të marrë pjesë në Xhelsa Salanën (tubimin vjetor) e atij viti. Ata qëndruan





Gjatë Haxhit 2010, në Mekë

atje për pak ditë edhe pas xhelsës si mysafirë të Kalifatul Mesih IV^{ra}. Z. Musa Rrustemi, duke kujtuar atë kohë, përmendi në fjalimin e tij të mbajtur në *Xhelsa Salanën* e Kosovës më 29 maj 2010: (citoj)

Përshtypjet që kishte sjellë vëllai im Isa nga Anglia, fotot, përshkrimet, kujtimet, takimi me Huzurin dhe Ahmadianët e tjerë, më lënë mbresa të thella. Përpyekja e tij për të ndryshuar veten gjithashtu më bëri shumë përshtypje. Nga Anglia, ai gjithashtu kishte sjellë një libër që akoma nuk ishte botuar por që ndryshoi jetën time për gjithmonë. Libri ishte “Filozofia e mësimeve të Islamit” i shkruar nga themeluesi i xhematit Mysliman Ahmedia Hazret Mirza Ghulam Ahmad ^{alejhiselam}.

Pas mbarimit të shkollës së mesme dhe shërbimeve ushtarake, ai shkoi në Zvicër kur qëndroi për katër vjet si anëtar i xhematit Mysliman Ahmedia të Zvicrës. Ai thotë:

“Takimi im i parë me ahmadianët ishte i mrekullueshëm. Dhjetë ditët

e para, unë qëndrova në xhaminë e Zyrihut. Ajo kohë është një nga momentet më të paharrueshme të jetës sime.”

Më pas, ai vajti në Holandë ku do të qëndronte për 7 vjet. Atje fitoi dhe shtetësinë holandeze. Gjatë udhës për në Holandë, ai vendosi të dedikonte jetën e tij në shërbim të fesë Islame. Atje për herë të parë u takua me Kalifin e katërtë, të cilit ai ia tregoi qëllimin e tij. Shumë shpejt, Huzuri i tha që të shkonte në Shqipëri, por për shkak të disa arsyeve, kjo nuk u realizua dot. Në vitet në vazhdim ai u angazhua të përgatitej për detyrën e vështirë që kishte zgjedhur. Në atë kohë MTA-ja sapo kishte nisur transmetimin e saj. Çdo ditë Musa sahibi do të priste me padurim emisionet e Kalifit të katërtë, sidomos emisionin me arabfolësit “*Lika ma’al arab*”. Këto emisione ushtruan ndikim të madh në jetën e tij.

Ishte pranvera e vitit 2000, kur z. Abdullah Wagishouser, Amir i Xhematit Mysliman Ahmedia të

Gjermanisë ndodhej në Holandë për një vizitë zyrtare bashkë me një delegacion. Musa sahibi rrëfen:

“... ai më kërkoi që ta ndihmoja për të gjetur dikë që ishte i gatshëm për të shkuar në Kosovë për themelimin e xhematit atje. Unë i thashë që nuk njoh askënd që mund ta bënte këtë, por nëse pëlqehet, unë jam i gatshëm që të kthehem në Kosovë. Pa zgjatur shumë, Amir sahibi mori miratimin nga Huzuri dhe unë menjëherë u nisa nga Holanda për në Kosovë.”

Pikërisht para dhjetë vjetësh, ishte fundi i majit 2000 kur z. Musa Rustemi dhe z. Fehim Difentaler, një ahmadian dhe miku i tij i ngushtë nga Holanda nisën udhëtimin e tyre me një furgon duke shkelur Italinë, Greqinë, Maqedoninë dhe kështu mbërritën në Kosovë.

Me vete kishin marrë gjërat më thelbësore për të nisur një mision,

siç ishin libra, saç satelitor, televizor, incizues video, kompjuter, printer dhe një biçikletë etj. Shoku i tij nuk qëndroi më shumë se një javë dhe u kthye në Holandë ndërsa Musa sahibi filloi punë në shtëpinë e vëllait të tij në Gjilan, ku motra e tij banonte përkohësisht bashkë me familjen e saj. Nuk kaloi shumë që ajo pranoi xhematin. Në Gjilan, Musa sahibi qëndroi rreth një muaj. Ata filluan të faleshin në xhemat madje edhe xhumaja e parë u krye në atë shtëpi.

Më pas ai u vendos në kryeqytet Prishtinë, ku gjeti një apartament me qera. Shumë shpejt ai u shoqërua nga vëllai i tij, dr. Isa Rustemi, i cili ishte transferuar nga Zvicra në Prishtinë dhe ushtronte profesionin e tij si mjek këtu. Të dy vëllezërit u angazhuan në aktivitetet e xhematit në këtë qendër të re xhematit. ➔ Musa sahibi akoma nuk kishte



Duke u takuar me Hazret Kalifin e Pestë, gjatë Xhelsa Salanës së Gjermanisë, 2009

asnjë automjet dhe për të kryer detyrat e xhematit ai lëvizte me biçikletë.

Nuk kaloi shumë që Musa sahibi u takua me një tjetër ahmedian nga qyteza e Istogut dhe kështu përpjekjet e tyre për ngritjen e një xhemati filluan të fitonin tiparet themelore të të qenit një xhemat dhe ata tashmë filluan të shijonin frymën e një bashkësie të tillë. Po në atë vit Musa sahibi u njoh me z. Xhavejd Ikbal Nasirin gjatë Xhelsa Salanës së Gjermanisë. Ai ishte caktuar si misionar i Kosovës. Ata të dy u kthyen bashkë dhe u angazhuan në veprimtarinë e Xhematit në mënyrë më të organizuar. Pasi që u regjistrua në universitet për të mësuar gjuhën shqipe, Xhaved sahibi filloi të ftonte shokët e tij të shkollës në qendrën e xhematit, të cilët me kalimin e kohës jo vetë që pranuan xhematin por më pas sollën shumë veta nga rrethi i tyre familjar dhe shoqëror në rrethin e Islam-ahmediatit. Në vitet në vijim shumë anëtarë erdhën nga qyteza Istog.

Pas një kohe të shkurtër, apartamenti që shërbente si qendër e xhematit dukej i pamjaftueshëm, dhe Musa sahibit i duhej të kërkonte një tjetër apartament me më shumë hapësirë. Apartamenti u gjet por edhe ai filloi të dukej i ngushtë para nevojave të xhematit dhe ata tashmë u detyruan t'i shtronin xhematit kërkesë për të blerë një truall për ngritjen e shtëpisë së misionit.

Gjetja e një trualli të përshtatshëm në Prishtinë dhe ndërtimi i shtëpisë së misionit janë padyshim ndër arritjet e tij më të mëdha. Punimet

fillestare për ndërtim u kryen përmes vekar-e-emel (aksioneve) ndërsa pjesa dërrmuese e projektit u realizua nga firma të ndryshme ndërtimi. Përkushtimi i plotë dhe angazhimi i gjithanshëm i Musa sahibit ndaj këtij projekti historik janë të dukshme në çdo cep të ndërtesës. Në të vërtetë, ishte vetëm ndihma e vazhdueshme e Zotit që ia mundësoi atij realizimin e kësaj detyre me rëndësi të jashtëzakonshme po aq të vështirë dhe madhështore që ta përfundonte në mënyrë të shkëlqyer dhe të lavdishme.

Pas marrjes së miratimit nga Huzuri, ai mezi priste të fillonte ndërtimin e xhamisë së parë të Xhemtit Mylsiman Ahmadia në Kosovë, gjë që nuk e lejoi jeta e tij e shkurtër.

Në 2009, gjatë Xhelsa Salanës së Gjermanisë, Hazret Kalifatul Mesih V^{atba} i dha porosi për të kryer haxhin nga ana e tij. Padyshim, ky ishte një bekim dhe nderim i veçantë për atë. Ai kreu haxhin sipas porosisë së Huzurit. Pavarësisht se kishte fituar nder të veçantë duke kryer haxhin në përfaqësim të Kalifit të Mesihut të Premtuar ^{alejhiselam}, ai gjithnjë mbeti i përlulur dhe modest dhe gjithmonë i shmangej kësaj çështjeje.

Ai i përkushtoi çdo moment nga jeta e tij përhapjes së mesazhit të Islam-Ahmediatit. Në fillim të vitit 2002, pavarësisht nga mungesa e kushteve apo mbështetjes, ai nisi një revistë shqipe me titullin “*Al-Islam*”. Më pas përgatiti një doracak rreth Namazit dhe përktheu fjalime të panumërta të Hazret Kalifatul Masih. Gjatë kohës së tij si president, xhemati

i Kosovës nisi uebfaqen e parë të Xhematit në gjuhën shqipe www.islam-ahmedia.org Xhemati i Kosovës gjithashtu botoi një libër me hadithe të zgjedhura të Profetit të Shenjtë savs dhe një fletëpalosje informuese rreth xhematit. Madje, ai kishte nisur përkthimet e shumë librave dhe temave në gjuhën shqipe por nuk arriti t'i mbaronte ato. Nën udhëheqjen e tij të denjë Xhemati Mysliman Ahmedia i Kosovës zhvilloi tri tubime të suksesshme.

Allahu ^{s.v.t.} i kishte dhënë një zemër të dhembshur. Ai gjithnjë angazhohej në shërbimet humanitare. Pranverën e fundit ai drejtoi disa anëtarë që të riparoheshin çatinë e një komshiu të varfër. Gjatë festave të bajramit ai organizonte projekte të veçanta për t'u dhënë ndihmë dhe ushqim njerëzve në nevojë.

Ai gjithmonë besonte në përpjekjet e përbashkëta dhe do të angazhonte anëtarët e xhematit në aktivitete të ndryshme. Ai ishte mjaft i gjindshëm dhe i gatshëm për çdo lloje ndihme edhe për xhematin fqinj të Shqipërisë. Ai shpesh udhëtonte drejt Shqipërisë ose dërgonte anëtarët e xhematit të Kosovës atje për *uekfe ardi* (udhëtim apo qëndrim në ndonjë vend që bëhet për përhapjen e Islamit apo për të dhënë edukimin fetar).

Trashëgimia më e madhe që ai lë, është pa dyshim xhemati fisnik, i devotshëm dhe i sinqertë i Kosovës. Ai e mbajti me dashurinë e Allahut, besimin në lutje, nënshtrimin ndaj Kalifatit dhe shumë cilësi të tjera larta përmes sjelljes së tij personale. Ai dëgjonte problemet dhe

shqetësimet e tyre dhe gjithmonë gjendej i pranishëm në nevojat e tyre. Ai gjithnjë orvatej t'i shmangej botës materiale e dëshirave të saj dhe gjithmonë si një rob i vërtetë i Zotit angazhohej në përgatitjen e jetës së paskësajme. Të rrallë janë këta njerëz që ushtrojnë një ndikim aq të madh mbi jetën e të tjerëve.

Jeta e tij, misioni i tij, arritjet e tij dhe trashëgimia e tij, pra çdo gjë dëshmon për vërtetësinë e asaj profecie madhështore të Mesihut të Premtuar ^{alejhisselam} përmes së cilës Allahu i premtoi se “Unë do të çoj mesazhin tënd deri në skajet e botës.”

Hazret Kalifatul Masih V ^{Allahu e ndihmoftë fuqimisht} e kujtoi Musa sahibin me këto fjalë gjatë fjalimit të së xhumasë mbajtur më 20 gusht 2010:

“Do të doja të përmend një tjetër mik të sinqertë që është Musa Rrustemi sahib, xhenazja e ti cilit u fal para disa ditësh bashkë me Musa Thabit sahibin. Meqenëse ai ishte një mik shumë i sinqertë, prandaj do të ndaj këtu disa fjalë rreth tij. Ai ndërroi jetë më 5 gusht të vitit 2010. In-na lillahi ua in-na ilaihi raxhiun (ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi). Sivjet në fjalimin e tij të xhelsës së Kosovës, ai kishte rrëfyer se si vëllai i tij kishte vizituar Anglinë në 1985 dhe u takua dhe u impresionua thellë nga Hazret Kalifi IV Allahu e mëshiroftë. Kur vëllai u kthye dhe ia rrëfeu kujtimet e tij dhe takimin me Kalifin, kjo i la përshtypje të thella Musa sahibit. Ai gjithashtu u impresionua duke parë ndryshimet në vëllanë e tij. Pasi që kreu shkollën e mesme ➤

dhe shërbimet ushtarake, ai shkoi në Zvicër, ku qëndroi për katër vjet. Ai vetë tregoi se u kënaq së tepërmi kur u takua me Ahmedianët andej. Pastaj për pak kohë kishte qëndruar edhe në Holandë. Gjatë rrugës së tij për në Holandë, ai vendosi të dedikonte jetën e tij për hir të Xhematit. Kishte kohë që kishte bërë bejtin (anëtarësim në xhemat) pasi që kishte parë ndryshimet në vëllanë e tij. Në Holandë ai u takua për herë të parë me Kalifin IV dhe gjatë këtij takimi, ai shprehu edhe dëshirën e tij për të dedikuar jetën. Atëherë Huzuri i tha që të shërbente në Shqipëri por për shkak të disa arsyeve, ai nuk mundi ta realizonte këtë. Në vitin 2000, kur Amir sahibi i Gjermanisë ishte në Holandë për një vizitë, ai i tha Musa sahibit që të gjente dikë

që mund t'i shërbente xhematit në Kosovë. Ai u përgjigj se nuk besonte se dikush mund të dëshirojë të shkojë atje, megjithatë ai është i gatshëm për këtë mision. Pas miratimit nga Hazret Kalifi IV Allahu e mëshiroftë në maj 2000 ai u nis për në Kosovë. Fillimisht ai qëndroi në Gjilan në shtëpinë e vëllait të tij, ku banonte dhe motra e tij familjarisht. Pas pak motra e tij pranoi xhematin dhe e xhumaja e parë u fal në shtëpinë e tyre. Pastaj ai u vendos në Prishtinë dhe shërbeu për dhjetë vjet si President i Xhematit të Kosovës. Ai gjithnjë përpiquej për të mirën dhe përparimin e Xhematit. Kishte shumë dëshirë për të bërë tablig dhe gjithmonë orvatej për përhapjen e mesazhit në një formë apo në një tjetër. Punët e Xhematit i bënte me përkushtim të madh dhe



paratë e Xhematit i shpenzonte me shumë kujdes. Një pjesë të madhe të ndërtimeve të shtëpisë së misionit, e bëri me vekare-amal (punë vullnetare). Një herë, kur mori vesh se rroga e tij ishte më e lartë sesa rroga e një misionari, pa pyetur dikë, vetë e uli rrogën e tij duke thënë se si mund të jetë ajo më e lartë sesa rroga e një misionari. Musa Rrustemi sahib gjithmonë shqetësohej për ta ngritur Xhematin në baza të forta dhe për t'u dhënë anëtarëve të rinj zhvillimin e duhur. Ai i trajtonte edhe anëtarët e rinj sikur të ishin të afërmit e tij dhe me mëshirën e Zotit dhe falë përpjekjeve të Musa sahibit, një pjesë e madhe e anëtarëve të Xhematit të Kosovës është bërë musi dhe është me arsim e morale të larta. Ai kishte një natyrë shumë të gëzuar. Ishte shumë i sinqertë dhe shumë i përpiktë në namazet e tij. Kur falte namazet, i falte me shumë devotshmëri. Kishte një dashuri të zjarrtë ndaj Kalifatit, të cilën mund ta dalloje edhe në sytë e tij. Çdo vit, ai më takonte gjatë Xhelsa Salanës së Gjermanisë. Vitin e kaluar, më tha se hoxhallarët kanë përhapur tek myslimanët e thjeshtë se ahmedianët nuk bëjnë Haxh, por shkojnë në Xhelsën e tyre dhe për këtë arsye disa njerëz nuk na dëgjojnë. Unë i thashë atij të bënte Haxh. Me bekimin e Zotit, vitin e kaluar, ai bëri edhe Haxh. Ai ishte akoma i ri... Allahu i Madhërishëm e faltë, e mëshiroftë dhe i lartësoftë pozitën në Xhenet. Allahu i dhëntë durim familjes së tij dhe e bëftë atë të qëndrueshëm në Ahmediat. Lutemi që Zoti të na dhurojë shumë njerëz si Musa Rrustemi sahib, jo vetëm në Kosovë, por në çdo vend të botës,

të cilët të jenë shumë të sinqertë, besnikë dhe në mënyrë vetëmohuese të shërbejnë për Xhematin.” Amin

Sigurisht, vdekja e tij është një humbje e madhe veçanërisht për familjen dhe të afërmit e tij, miqtë, kolegët dhe për anëtarët e xhematit të Kosovës dhe për Xhematin Mysliman Ahmedia në përgjithësi. Edhe pse dhimbja e mallëngjimi i largimit të vëllait tonë është i papërballueshëm dhe i ka goditur fort zemrat tona, por ne dimë që duhet ta përballojmë atë me durim dhe lutje, siç ka thënë i Dërguari i Allahut ^{savs} sytë po derdhin lot dhe zemra po ngashërehet, por ne kurrsesi nuk do të nxjerrim asnjë fjalë kundër dëshirës së Zotit tonë. Jeta dhe vdekja janë në dorën e Zotit tonë të Plotfuqishëm dhe Atij do t'i kthehemi. Megjithatë në thellësinë e shpresës dhe ndjenjave tona qëndron modeli i shkëlqyer i vëllait tonë. Ai që u largua, ka përmbushur të gjitha detyrat e tij, prandaj kujtimet e tij na përballojnë.

Allahu i Madhërishëm e faltë, e mëshiroftë dhe i lartësoftë pozitën në Xhenet.

Allahu e faltë, e mëshiroftë dhe i lartësoftë pozitën e tij në xhenet. Amin

Para disa muajsh, në Youtube, është hedhur një video, në të cilën z. Ahmed Kalaja, Imami i xhamisë së Dine Hoxhës të Rrugës së Kavajës, Tiranë, flet për Xhematin Mysliman Ahmedia dhe si shumica e kundërshtarëve të këtij xhemati hyjnor, ngren akuza të padrejta e të pabaza kundër themeluesit të tij të nderuar. Redaksia e Vërtetësisë merr përsipër përgjigjen e të gjitha atyre akuzave dhe sjell dëshmi të qarta, që lexuesi mund të gjykojë vetë se në fakt, ato provojnë vërtetësinë e Hazret Mirza Ghulam Ahmedin, themeluesin e Xhematit Mysliman Ahmedia.

Në videon e tij, z. Ahmed Kalaja thotë se Hazret Mirza Ghulam Ahmedi a.s. vdiq nga kolera duke u bërë shenjë e pranimit të lutjes së dijetarit Thenaullah Amritsari. Në numrin e ardhshëm, inshallah do të tregojmë me argumente të qarta sesi vetë dijetari Thenaullah pësoi humbjen dhe jo ashtu siç thotë z. Ahmed Kalaja. Në këtë numër të Vërtetësisë, do të shpalosim vetë ngjarjen e vdekjes së tij si dhe shpalljet rreth saj, të cilat Hazret Mesihu i Premtuar a.s. i kishte marrë prej Zotit, shumica prej të cilave u botuan gjatë jetës së tij. (Redaksia)

**Vdekja
e Hazret Mirza Ghulam
Ahmedit,
Mesihut të Premtuar ^{a.s.}
dhe
shpalljet rreth saj**

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin e Shenjtë:

Çdo gjë që ekziston në tokë do të zhduket dhe do të mbetet përgjithmonë vetëm Zoti yt që është shumë i Madhëruar dhe shumë i Nderuar.”
(Sure El-Rehman, 27-28)

Para katërbëdhjetë shekujsh Zoti i Madhërishëm, duke i dhënë vdekjen edhe Hazret Muhamedit ^{s.a.v.s.} na ka treguar që çdo njeri, sado që të jetë i dashur dhe i afër ndaj Zotit, duhet të braktisë këtë botë. Por i bekuar është ai që largohet nga kjo botë e përkohshme në gjendje të tillë që vetë Zoti i thotë:

“Kthehu te Zoti yt, ti je i kënaqur me Atë dhe Ai është i kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Sure El-Fexhr, 29-31)

Kundërshtarët e Mesihut të Premtuar, themeluesit të Xhematit Musliman Ahmadia, pa asnjë dëshmi, kanë përhapur mjaft gënjeshtër rreth vdekjes së tij. Ai nuk ka ndërruar jetë nga kolera, por shqetësimin e dehidratimit ai ka pasur shpesh gjatë jetës së tij, që ishte për shkak të stërlodhjes mendore që bënte ai për fenë Islame. Ata që vazhdimisht rrijnë të angazhuar me punë mendore, shkrimin e librave ose punë të tjera shkencore, shpesh hasin këtë problem shëndetësor. Edhe vdekja e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. ka qenë pikërisht për këtë shkak. Për këtë, do të tregojmë fakte historike në numrin e ardhshëm, inshallah. Në vijim, do të lexoni ngjarjet që ndodhën

në kohën e vdekjes së tij, ngjarje këto, vetë janë një shenjë madhore e vërtetësisë së tij. Veç kësaj, do të paraqesim edhe shpalljet që Zoti i kishte dhënë rreth kësaj ngjarjeje, prej të cilave, shumica u botuan dhe u përhapen gjatë jetës së tij.

Së pari do t'i shpalosim ngjarjet e fundit të jetës së Mesihut të Premtuar a.s. sipas biografisë së tij “*Hajat-e-Tejeba*” (“Jeta e Pastër”).

“Udhëtimi për në Lahor dhe përsëritjet e shpalljeve rreth vdekjes

27 prill 1908

Në ato ditë Hazret Amma Khan (gruaja e Mesihut të Premtuar a.s.) kishte qenë e sëmurë. Ndaj, ajo donte të shkonte një herë në Lahor që të kurohej prej ndonjë mjekjeje të shquar. Hazret Mesihu i Premtuar, ndoshta për shkak të ndikimit të fshehtë të shëndetit të tij, ngurronte të nisej për udhëtim. Por, u bë gati pasi e shoqja ngulmonte. Më 26 prill, të vitit 1908, në kohën e agimit atij iu shpall “*Mabash eimen az bazie rozgar*”¹ (d.m.th. “Mos u trego i pavëmendshëm nga ➔ dredhia e kohës!”)

Për këtë arsye, atë ditë ai nuk udhëtoi, por, më 27 prill 1908 u nis për në Lahor. Kur arriti në

1. Gazeta “*Bedr*” vëllimi 7, nr. 17 data 30 prill 1908, f. 7. Dhe gazeta “*El-Hekem*” vëllimi 12, nr. 29, data 22 prill 1908, f. 1.

Betala (një qytet i vogël rreth 16 km larg nga Kadiani) u njoftua që, për atë ditë nuk kishte vende të rezervuara në tren. Atëherë ai donte të kthehej në Kadian, por pastaj si u mendua, qëndroi po në Betala duke pritur një tren të rezervuar. U nis me tren më datën 29 prill 1908 dhe në Lahor qëndroi në shtëpinë e Khvaxha Kemaludin Sahibit, të cilën me ardhjen e tij e shndërroi si një qendër të madhe vizitorësh. Edhe ahmadianët dhe joahmadianët filluan të vinin dhe të takoheshin me të. Një joahmadian i nderuar, një princ nga Kabuli, i quajtur Princi Muhammed Ibrahim Khan, e kishte ftuar Hazurin për të ngrënë në shtëpinë e tij. Por Hazuri, për një arsye, mendoi që të mos shkonte në shtëpinë e tij. Atëherë Princi i shtroi kërkesën që Hazuri ushqimet, t'i hante në shtëpinë ku banonte por ato t'i paguante ai, ndaj i dërgoi pesëdhjetë rupi. Meqë në Lahor u vendos për një qëndrim të gjatë, atëherë Hazret Maulana Nuruddin Sahibi, Hazret Maulana Mohammad Ahsan Sahib Amrohi dhe njerëz të tjerë arritën atje. Madje edhe gazeta “*Badr*” u transferua përkohësisht në Lahor sa për t'i njoftuar njerëzit me lajme të reja.

Në Lahorë ishin shumë kundërshtarë që u acaruan keq pas ardhjes së Hazurit. Çdo ditë para shtëpisë së tij, sherrxhinj dhe njerëz të ligj grumbulloheshin dhe bërtisnin me fjalë provokuese dhe me sharje banale. Disa ahmadianë po zemëroheshin aq shumë saqë Hazuri i thirri të gjithë dhe i këshilloi që t'i

duronin këto sharje dhe të tregohen të përmbajtur. Ai u tha: I inatosuri nuk është trim, por i tillë është ai që e gëlltit inatin dhe përmbahet. Shërbyesit i zbatuan udhëzimet e Hazurit dhe treguan mjaft durim. Njerëzit e ligj ishin të zënë me këto veprime, kurse vizitorë të nderuar i vinin Hazurit vazhdimisht dhe përfitonin. Ndërkaq më 9 maj 1908 atij përsëri iu shpall “*Arrahil thummar rahil. Inna Allaha jehmilu kulla hamlin*”² d.m.th. “Është koha e nisjes, po është koha e nisjes. Allahu do të mbartë çdo barrë.”

Ky ishte një paralajmërim që atij iu afrua koha e vdekjes, por Hazuri, me shumë durim dhe këmbëngulje, vazhdonte punën e tij pa shfaqur asnjë shenjë shqetësimi prej tij. Megjithatë, sipas praktikës së profetëve, duke iu bindur kuptimit konkret të shpalljes, ai e ndërroi vendbanimin e tij dhe tha që edhe kjo është një lloj nisjeje. Por Zoti kishte një mendim tjetër. Hazuri ndërroi shtëpinë dhe shkoi në banesën e Sejed Mohammad Husain Shah Sahibit. Pas disa ditësh erdhi lajmi i vdekjes së një ahmadiani të sinqertë, shef stacioni, Babu Shahdin Sahibit. Atëherë njerëzit u bindën që kuptimi i asaj shpalljeje ishte në të vërtetë vdekja e Babu Sahibit. Por sipas të dhënave Hazuri e dinte shumë mirë që ajo shpallje nuk ishte për dikë tjetër.³

2. Gazeta “*Bedr*”, vëll. 7, nr. 21, data 26 maj, 1908, f. 7. Dhe gazeta “*El-Hekem*”, vëll. 12, nr. 35, data 30 maj, 1908, f. 1
3. Biografi i Mesihut të Premtuar ^{a.s.} “*Hajat-e-Tejeba*” f. 346, 347

“Më 16 maj 1908, natën, ai mori një shpallje ku i thuhej: “*Mëkën takija bër umr na pajdar*”⁴ që do të thotë “Mos u mbështet mbi moshën e përkohshme.”

Sëmundja e vdekjes

Ndërsa Hazuri ishte i zënë në përgatitjen e fjalimit të tij “Mesazhi i Paqes” më 20 maj, të vitit 1908 atij iu shpall “*Arrahil thummar rahil vël mautu kërib*”⁶ d.m.th. “U afrua koha e nisjes, po u afrua koha e nisjes dhe vdekja është afër.” Kjo shpallje qartazi tregonte që bëhej fjalë për vdekjen e Hazurit. Prandaj ai nuk bëri ndonjë shpjegim. Hazrat Amma xhan (gruaja e Hazurit) e mërzitur nga këto shpallje që i vinin njëra pas tjetrës i tha: “*Tani të kthehemi në Kadijan*” Ai iu përgjigj: “*Tashmë ne do të nisemi vetëm atëherë kur Zoti do të na nisë.*”⁷ Siç u theksua në ato ditë Hazuri ishte i zënë me përgatitjen e fjalimit të tij “Mesazhi i Paqes” por mbas kësaj shpalljeje ai filloi të përpiquej shumë, filloi të shpejtonte në punën e tij. Më në fund, në pasditen e 25 majit, pothuajse e përfundoi atë dhe ia dorëzoi shkruarit. Të dhënat na tregojnë që Hazuri, duke menduar

se nuk do ta gjente më kohën për ta përfunduar, atë e dorëzoi atë sa kishte shkruar. Mbas faljes së Iqindisë, Hazuri, mbajti një fjalim të shkurtër rreth vdekjes së Hazret Isait a.s. dhe ky ishte fjalimi i fundit i tij. Pastaj, si zakonisht, doli jashtë për shëtitjen. Një karrocë me qira ishte gati për të. Hazuri kërkoi prej Hazret Sheik Abdul Rahman Sahibit, i cili ishte një shërbyes i sinqertë i tij, që t’i thoshte të zotit të karrocës: “*Ne duam të shëtisim vetëm një orë për të marrë ajër të pastër. Ai na duhet të na çojë deri atje nga ku mund të kthehemi në shtëpi brenda kohës.*” Ai bëri sipas urdhrit dhe Hazuri mbas shëtitjes u kthye në shtëpi. Në atë kohë ai nuk kishte ndonjë sëmundje dalluese. Nga puna e vazhdueshme për fjalimin, ndiente pak lodhje dhe ndoshta për shkak të ndikimit të ngjarjes që do t’i vinte më pas, ndihej pak i vetmuar. Ai si i fali namazet e akshamit dhe të jacisë hëngri shumë pak ushqim dhe u shtri.

Vdekja, më 26 maj, 1908

Tani do të trajtojmë ngjarjen e vdekjes së Mesihut të Premtuar a.s. Meqenëse kjo është ngjarja e fundit në jetën e Hazurit, është më mirë të përmenden fjalët e të birit të Hazurit, Mirza Bashir Ahmad Sahib, i cili jo vetëm që ishte një historian i mirëfilltë, por edhe një dëshmitar i kësaj ngjarjeje. Ai thotë:

4. Gazeta “*Bedr*”, vëll. 7, nr. 22, data 2 qershor, 1908, f. 3

5. Në këtë shpallje është përmendur edhe viti i vdekjes. Sipas numërimit të *Abxhedit* shifrat e kësaj fjalie bëhen 1326. Pikërisht ky ishte viti i kalendarit Islamik kur Hazuri ndërroi jetën. Lavdi e Zotit!

6. Gazeta “*Bedr*” vëll. 7, nr. 22, data 2 qershor, 1908, f. 3

7 Hazret Mirza Bashir Ahmad, “*Silsila Ahmedia*”, f. 182

“Ora ishte rreth njëmbëdhjetë e natës kur Hazuri ndjeu nevojë që të shkonte në banjë dhe u çua për të shkuar atje. Atë shpesh e zinte barku. Kur shkoi në banjë veten e ndjeu të lodhur. Duke u kthyer e zgjoi nënën (d.m.th. gruan e tij) dhe i tha: *“Më zuri barku dhe ndihem shumë i lodhur.”* Ajo u ngrit menjëherë dhe u ul pranë tij. Dhe meqenëse ai ndihej mirë zakonisht kur dikush ia shtypte këmbët edhe ajo filloi t’ia shtypte. Ndërkohë ai e ndjeu se po e zinte barku prapë, ndaj shkoi për nevojë. Kësaj radhe kur u kthye ishte aq i lodhur saqë, duke u shtrirë mbi krevat nuk arriti të mbahej dhe gati u rrëzua në të. Hazret Amma xhan (gruaja e tij) tha shumë e mërztur: *“Allah! Çfarë po ndodh!”* ai i tha: *“Kjo është ajo që ju thosha unë.”* D.m.th. tani i kishte ardhur momenti i fundit. Më pas, ai i tha: *“Thirre Maulvi Sahibin* (d.m.th. Hazret Maulana Nurudin Sahibin që ishte një nga më të afërmit e tij dhe njëkohësisht ishte një mjek i shkëlqyer.) dhe vijoi: *“zgjoje Mahmudin* (d.m.th. vëllanë tim të madh Hazret Mirza Mahmud Ahmad Sahibin) *dhe Mir Sahibin”* (d.m.th. gjyshin tim ose vjehrrin e Hazret Mesihut të Premtuar.) U mblodhën të gjithë dhe më pas e thirrën edhe doktor Sejed Husen Shah Sahibin dhe doktor Mirza Jakub Beg Sahibin. Në mjekimet ata u përpoqën me të gjitha aftësitë e tyre, por kush mund ta largonte fatin e caktuar prej Zoti. Lodhja po i shtoej nga çasti në çast dhe pastaj nevoja i erdhi edhe një herë dhe lodhja iu shtua aq shumë sa pulsi mezi i ndihej. Për shkak të zënies së

barkut, gryka dhe goja filluan t’i thaheshin dhe ai ndiente shumë vështirësi për të folur. Por fjalët që dëgjoheshin nga goja e tij ishin këto të tria: *“Allah! I Dashuri im, Allah.”* Përveç këtyre fjalëve ai nuk tha asgjë tjetër.

Kur vajti koha e faljes së mëngjesit dhe ndërkohë, kur edhe unë gjendesha pranë tij, ai me një zë shumë të dobët pyeti: *“A vajti ora për faljen?”* Njëri nga pasuesit e tij i tha: *“Po Hazur,erdhi ora.”* Me të thënë këtë, ai për ta bërë tejamumin, preku krevatin me të dyja duart, dhe duke u shtrirë nisi faljen. Por ndërkohë i ra të fikët. Kur e mori vetën prapë, pyeti: *“A vajti ora për faljen?”* dhe ndërkohë iu përgjigjën *“Po Hazur, vajti ora.”* Ai prapë duke u shtrirë nisi faljen. Pas kësaj mbeti pothuajse i pa vetëdijshëm, por sa herë që e merrte veten dëgjoheshin po këto fjalë: *“Allah! I Dashuri im, Allah”* dhe lodhja i shtoej vazhdimisht. Më në fund në orën dhjetë (të mëngjesit) ra në gjendje agonie dhe ne besuam që nuk kishte më shpresë. Deri atëherë nëna e nderuar po i lutej Zotit me shumë durim dhe nuk thoshte veçse: *“O Zot! Jeta e tij kaloi në shërbimin e Islamit, Ti atij jepi edhe jetën time.”* Por kur ai ra në gjendje agonie, me hidhërim të thellë dhe duke qarë ajo tha: *“O Zot! Ky po na braktis tashmë, por Ti mos na braktis të lutem!”* Në fund, afërsisht në orën dhjetë e gjysmë, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. mori nja dy herë frymë thellë dhe pastaj i doli shpirti duke shkuar drejtë Padronit dhe të Dashurit të tij. *Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi.* (Kurani i Shenjtë, Sure Al-Bekare, vargu 157) *Çdo*

gjë që ekziston në tokë do të zhduket dhe do të mbetet përgjithmonë vetëm Zoti yt që është shumë i Madhëruar dhe shumë i Nderuar.” (Kurani i Shenjtë, Er-Rehman 27,28) ⁸

Mosha e Hazurit:

Në kohën e vdekjes, pikërisht sipas shpalljes prej Zotit, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. ka qenë në moshën 74 vjeç në bazë të kalendarit diellor dhe 76 vjeç sipas kalendarit hënor.⁹

Paralajmërimet rreth moshës dhe vdekjes së Hazret Mesihut të Premtuar a.s.

- ❖ Një nga shpalljet e para të Mesihut të Premtuar a.s. ishte shpallja rreth moshës së tij të cilën ai e kishte përmendur në shumë libra që u botuan kur ai ishte gjallë. Kështu për shembull në faqen 443 të librit të tij “*Izala-e Auham*” (“Heqja e Dyshimeve”) që u botua për herë të parë u botua në vitin 1891 nga shtëpia botuese *Rijad-e-Hind, Amritsër*, ky fakt përmendet. Por ne do ta citojmë atë shpallje nga libri i tij “*Tohfa Golërvia*” që u botua në shtator 1902. Ai, duke dhënë një provë shumë të fortë mbi vërtetësinë e tij, thotë:

“Në këtë periudhë njëzetënjë vjeçare, duke u nisur nga libri “*Berahirin-e-Ahmadija*” (libri i parë

8 Hazret Mirza Bashir Ahmad “*Silsila Ahmedia*”, f. 82-84

9 Biografia e Mesihut të Premtuar a.s., “*Hajat-e-Tejeba*”, (“Jeta e pastër”) f. 350-356

i tij, pjesa e parë e të cilit u botua për herë të parë në vitin 1880) deri më sot, unë i shkrova dyzet libra dhe afërsisht gjashtëdhjetëmijë broshura (bëhet fjalë për tirazhin), që u botuan me dëshminë dhe vërtetësinë e deklaratave të mia. Dhe ato të gjitha janë broshura të shkurtra prej meje. Në to zakonisht, unë botoja shpalljet e mia të reja. Në këtë situatë çdo i mençur mund të mendojë se si po kalon kjo kohë kaq e gjatë, duke punuar, ditë e natë me përkushtim që nga deklarata ime profetike deri më sot. Dhe Zoti, jo vetëm që më dha jetën deri tani, por më dha edhe shëndet për këto vepra dhe më dhuroi para e kohë. Në ato shpallje, praktika e Allahut të Lartësuar s’ishte që të bisedonte me mua rrallë herë, por shumica prej atyre shpalljeve janë plotë paralajmërimë dhe nxjerrin në pah edhe qëllimet e këqija të armiqve. Për shembull, Zoti i Lartësuar e dinte që armiqtë do të dëshironin vdekjen time, edhe donin të nxirrnin përfundimin që ky ishte gënjeshtar, prandaj edhe vdiq shpejtë. Për këtë, Ai më përpara m’u drejtua dhe më tha: “*Themanin Haulan au keribam min dhalik au tazida alaihi sinina vë tëra nëslën bëida*” D.m.th. ‘Mosha jote do të jetë tetëdhjetë vjeç ose dy a katër vjet më pak ose më shumë. Dhe ti do të kesh një jetë të tillë që do të shikosh një brez të largët.’ Dhe afërsisht tridhjetepesë vjet kaluan pas kësaj shpalljeje që u botua dhe u shpërnda në mijëra njerëz.” (*Ruhani Khazain* vl. 17, *Zamima Tohfa Golërvia* f. 66)



- ❖ Në shtator të vitit 1905, ai pa një ëndërr në të cilën është përmendur qartazi viti i vdekjes së tij. Për këtë ai thotë:

“Para disa ditësh e pashë në ëndërr Maulvi Abdul Kerim Sahibin, ndjesë pastë, (i cili ishte një pasues shumë i sinqertë i Hazurit që kishte ndërruar jetë) Në fillim biseduam pak, pastaj mendova se ngaqë ky është i vdekur, t’i kërkoja të lutej për mua. Atëherë unë i thashë: lutuni për mua që mosha ime të jetë aq sa të kem kohë të mjaftueshme për të kryer misionin tim. Me të thënë këtë, ai u përgjigj: “*Tehsildar.*” Unë i thashë: ju po më thoni atë që s’ka lidhje me të. Ju lutuni për çështjen të cilën jua kërkoja. Atëherë ai pasi i ngriti duart e tij deri te kraharori dhe jo më lart, dhe tha: “**Njëzetinjë.**” Unë i thash: Më sqaroni. Por ai nuk më sqaroi dhe shumë herë po këtë më thoshte “Njëzetinjë, njëzetinjë.” Dhe pastaj iku.”¹⁰

Këtu numërori ‘njëzetinjë’ tregon moshën e misionit të Mesihut të Premtuar a.s. Sepse ai pyeti Maulvi Abdul Kerim Sahibin që të gjente kohën e mjaftueshme për të kryer misionin e tij. Dhe për këtë ai iu përgjigj “**Njëzetinjë**” dhe vazhdoi t’i thoshte po atë numëror. Ngjarjet që pasuan pastaj, qartazi na tregojnë vërtetësinë e kësaj ëndrre. Hazuri botoi broshurën e parë për *Beatin* (Betimin për t’u anëtarësuar në Bashkësinë e tij) në vitin 1888 dhe pikërisht mbas njëzetinjë vjetëve, 10. Gazeta “*Bedr*”, vëll. 1, nr. 37, data 24 nëntor, 1905, f. 2; Gazeta “*El-Hekem*” vëll. 9, nr. 41, data 24 nëntor 1905, f. 1

më 26 maj në vitin 1908 ka ndërruar jetë.

Vdekja e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. nuk u paralajmërua vetëm nëpërmjet shpalljeve të lartpërmendura. Ndonëse ato të gjitha u botuan në jetën e tij dhe janë shumë të qarta dhe një i mençur që frikësohet nga Zoti nuk mund t’i shmangë, ndërsa një kundërshtar vetëm për ta kundërshtuar, mund të thoshte se ato nuk ia mbushin mendjen. Por Hazret Mesihu i Premtuar a.s. ka botuar një libër “*Al-Vesijat*” (“Testamenti”) më 24 dhjetor 1905, pra dy vjet e gjysmë para vdekjes së tij, duke i shpallur në të ngjarjet rreth vdekjes së tij. Ai e fillon atë libër si vijon:

“Për shkak se Zoti i Madhërishëm më ka njoftuar përmes shpalljeve të përsëritura, se koha e vdekjes sime është afër, dhe se shpallja rreth kësaj çështjeje nga Ai u përsërit aq shumë, saqë më ka dridhur tërë qenien time, duke ma bërë zemrën të ftohtë ndaj kësaj bote, e konsiderova të përshtatshme që të shkruaj disa këshilla për miqtë e mi dhe për gjithë ata që duan të përfitojnë nga fjalët e mia. Në fillim, do t’ju njoftoj për atë shpallje hyjnore, e cila më paralajmëroi për vdekjen time dhe më nxiti për këtë detyrë. Së pari do ta shënoj atë që është në gjuhën arabe, pastaj do ta shkruaj edhe atë që është në gjuhën urdu.

“Largimi yt nga kjo botë është afruar dhe Ne nuk do të lëmë asnjë gjë që mund të shkaktojë turp dhe nderim për ty. Afatit tënd të caktuar nga Zoti, shumë

pak kohë i ka mbetur. Ne do t'i hedhim poshtë të gjitha akuzat dhe nuk do të lëmë asnjë shkak që mund të përdoret për të përbuzur ty. Ne kemi fuqi të tregojmë ty diçka nga paralajmërimet tona rreth kundërshtarëve ose të ta marrim shpirtin. Ti do të vdesësh në atë gjendje, që Unë do të jem i kënaqur me ty. Dhe Ne për vërtetësinë tënde do të lëmë shenja të qarta përgjithmonë. Premtimi që ishte bërë është afër. Tregojnë njerëzve bekimet që Allahu t'i dha ty. Ai që përvetëson takuanë dhe duron, Allahu nuk do t'ua humbë shpërblimin njerëzve të tillë të devotshëm”.

... Pastaj, Allahu i Lartësuar mu drejtua në gjuhën urdu dhe më dha lajmin e vdekjes sime me këto fjalë:

“Shumë pak ditë kanë mbetur. Atë ditë të gjithë do të pikëllohen. Kjo do të ndodhë. Kjo do të ndodhë. Kjo do të ndodhë. Pas kësaj do të vijë edhe ngjarja jote. Pasi të jenë shfaqur të gjitha fatkeqësitë dhe të gjitha mrekullitë e natyrës do të ndodhë ngjarja jote.”

Njohuria që më është dhënë rreth kësaj, është ajo që vdekja do ta mbërthejë tokën nga të gjitha anët. Gjithkund, do të bien tërmete që do të jenë shkatërrimtare, sikur të jetë vetë kiameti. Toka do të tundet aq shumë saqë jeta do të vështirësohet për shumë njerëz. Atëherë, atyre që do të pendohen dhe iu shmangen mëkateve, Allahu do t'u tregojë mëshirë. Pra, është e sigurt që do të ndodhin të gjitha këto gjëra, mu ashtu siç kishin paralajmëruar të gjithë profetët për këtë kohë. Por, ata që pastrojnë zemrat e tyre dhe i ndjekin rrugët që i pëlqen

Allahu, nuk do të kenë as frikë e as hidhërim. Zoti, duke mu drejtuar mua, tha:

“Ti je alarmues prej meje. Unë të kam dërguar, që mëkatarët të ndahen nga ata që veprojnë mirë.” Dhe më tha: ***“Një alarmues erdhi në këtë botë, por bota nuk e pranoi atë. Por Allahu do ta pranojë dhe do të shfaqë vërtetësinë e tij me sulme shumë të ashpra. Unë do të të bekoj ty, aq shumë saqë edhe mbretërit do të kërkojnë bekime nga rrobat e tua.”***

... Zoti më thotë se shumë fatkeqësi do të ndodhin dhe shumë gjëra do të zbresin në tokë, disa do të ndodhin para vdekjes sime dhe disa më pas. Ndërkohë, Ai do ta bëjë këtë Xhemat të përparojë me gjithë fuqi, pak me dorën time dhe pak pas meje”.¹¹

11. Rruhani Khazain, vëll. 20, *El-Vesijat* f. 3-6



Dr. Abdul Salami, duke marrë çmimin Nobel

Dr. ABDUL SALAMI

i pari shkencëtar mysliman që mori çmimin Nobel

(Dr. Abdul Salami ka qenë anëtar i nderuar
i Xhematit Mysliman Ahmadia)

Fjalimi i Dr. Abdul Salamit gjatë marrjes së çmimit Nobel

Shkëlqesia juaj, të nderuar zonja dhe zotërinj Si përfaqësues i kolegëve të mi, Prof. Glashow dhe Weinberg, falënderoj Fondacionin Nobel dhe Akademinë Mbretërore të Shkencës për këtë nder të madh dhe mirësitë që më dhanë e më lejuan që t'ju drejtohem në gjuhën time amëtare urdu.



Pikërisht ky është besimi i të gjithë fizikanëve. Sa më shumë të thellohemi, aq më shumë mahnitemi dhe befasohe mi.

E them këtë, jo vetëm për t'ju kujtuar juve që jeni të pranishëm këtu sonte, por edhe atyre që i përkasin Botës së Tretë, të cilët, për shkak të mungesës së mundësive dhe mjeteve, ndihen të privuar nga kërkimi i dijesh shkencore.

پاکستان اس کے آہے ماہیت سکور ہے۔
Pakistani juve ju është shumë mirënjohës.

Nisja e fizikës është një trashëgimi e përbashkët e tërë njerëzimit. Lindja dhe Perëndimi, Veriu dhe Jugu kanë qenë pjesëmarrës të barabartë në këtë fushë. Në Librin e Shenjtë të fesë Islame, Allahu thotë:

مَا تَرَى فِي
خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِنْ تَفْوُتٍ فَارْجِعِ الْبَصَرَ كَلَّا
تَرَى مِنْ فُطُورٍ ﴿١٠٠﴾
ثُمَّ ارْجِعِ الْبَصَرَ كَرَّتَيْنِ يَنْقَلِبْ إِلَيْكَ الْبَصَرُ
فَارِثًا ذَهَابًا ﴿١٠١﴾

“Ti s’mund të shohësh asnjë të metë në krijimin e të Gjithëmëshirshmit, andaj, vështroje mirë e mirë! A sheh ndonjë të metë? Vështro edhe një herë! Shikimi yt do të kthehet te ti, i hutuar dhe i lodhur”.

(El-Mulk 67:4-5)

Alfred Nobeli theksoi se asnjë dallim race apo ngjyre nuk do të bëhet për ta arritur këtë fisnikëri. Në këtë rast, më lejoni t’u them atyre, të cilëve Zoti ua dhuroi bujarinë e Tij: le të përpiqemi për t’iu afruar të gjithëve, mundësitë e barabarta, në mënyrë që edhe ata të bëjnë përpjekje në krijimin e fizikës dhe shkencës për dobinë e të gjithë njerëzimit. Kjo pikërisht duhet të ketë qenë në shpirtin dhe idealet e Alfred Nobelit që ndërtuan jetën e tij. Zoti ju bekoftë!

(Marrë nga: Les Prix Nobel. The Nobel Prizes 1979, Editor Wilhelm Odelberg, [Nobel Foundation], Stockholm, 1980)

Shqipëroi: Ilirian Ibrahim



Xhelsa Salana e 44-të të Xhematit Mysliman Ahmadia të Anglisë

Xhemati Mysliman Ahmadia i Anglisë zhvilloi Xhelsa Salanën (tubimin vjetor) e 44-të më 30, 31 korrik e 1 gusht 2010 në *Hedikatul Mehdi* në qarkun Hampshire. Në vitin 1891 kur Hazret Mesihu i Premtuar ^{alejhiselam} kishte themeluar *Xhelsa Salanën* në Kadian, Indi, ai gjithashtu kishte njoftuar se Zoti e ka treguar se njerëzit nga kombe të ndryshme të botës


do të bashkohen për të marrë pjesë në këtë tubim. Numri i pjesëmarrësve në *xhelsa Salanën* e parë ishte vetëm 75 veta, por tubimi pati rritje të vazhdueshme dhe në vitin 1983 arriti kulmin kur në *xhelsa Salanën* e fundit të Xhematit të Pakistanit, 250 mijë veta morën pjesë (që atëherë qeveria Pakistaneze nuk e lejon zhvillimin e *xhelsa Salanës* atje).

Sivjet, numri i pjesëmarrësve në *Xhelsën* e Anglisë ishte më shumë se 28 mijë që kishin ardhur nga 97 vende të ndryshme. Përmes kanalit satelitor të xhematit MTA gjithë programi i *xhelsës* u transmetua drejtpërdrejtë në gjithë globin dhe kështu Ahmadianët në mbarë botën përfituan nga kjo gosti shpirtërore. Çdo Xhelsa ka veçorinë e vet dhe xhelsa e kësaj radhe ishte për të kuvenduar kujtimet besimshtytëse të dëshmorëve të Lahorit.

Përpos fjalimit të së xhumasë, Hazret Kalifatul Masih V (Allahu e ndihmoftë fuqimisht mbajti katër fjalime të rëndësishme që përktheheshin drejtpërdrejtë në 12 gjuhë të botës. Ditën e fundit më 1 gusht u organizua ceremonia e bejtit (besëlidhjes) ndërkombëtar. Sivjet 458.760 persona u anëtarësuan në xhemat, pra 42 mijë veta më shumë se vitin e kaluar. Të pranishmit lexonin fjalët e *bejtit* në gjuhë të tyre ndërsa përmes MTA-së Ahmadianët nga 198 vende të botës, ripërsërisnin besëlidhjen e tyre.

Sipas raportit që jepet gjatë ditës së dytë të Xhelse Salanës:

Xhami të reja: sivjet Xhemati Mysliman Ahmadia ka gjetur 294 xhami në të gjithë botën, ndër të cilat 115 i ka ndërtuar vetë, ndërsa 179 të tjera, Zoti i



Madhërishëm ia dha të gatshme.

Shtëpi të misionit: përveç xhamive, Xhemati ka ndërtuar 87 shtëpi të misionit gjatë këtij viti.

Përkthime e Kuranit

Famëlartë: Sivjet, me bekimin e Zotit, Xhemati ka përkthyer Kuranin Famëlartë në një tjetër gjuhë, e cila është *portugalishtja kriole*, që flitet në Gini Bisau (Guinea-Bissau) të Afrikës. Kështu, deri tani Xhemati Mysliman Ahmadia ka përkthyer Kuranin Famëlartë në 70 gjuhë të ndryshme të botës, *Elhamdulillah*.

Veprimtaria e IAAAE-së: Vullnetarët e Organizatës Ndërkombëtare të Arkitektëve e të Inxhinierëve Ahmadian gjithashtu janë përfshirë në zbatimin e projekteve të ndryshme për furnizimin e ujit dhe energjisë me panele diellore në 160 vendet e Afrikës. Në këto vende janë vendosur 485 pompa. Organizata ka filluar punë edhe për ndërtimin e fshatrave modele që do të furnizohen me energji dhe uji i pijshëm 24 orë.





Humanity First (organizatë humanitare) po ushtron veprimtarinë e saj në 35 vende. Në Afrikë organizata ka mundësuar ujën e pijshëm për 1,67 milion persona. Kanë përfituar 51140 persona nga shërbimet shëndetësore ndërsa 21497 studentët kanë fituar bursat për shkollim. Pas tërmeteve në Haiti organizata u ofroi ndihmë mjekësore 23400 personave nga ekipet e kualifikuara doktorësh përbërë nga 159 mjekë vullnetarë. Po ashtu projekte të ndryshe humanitare u kryen në Indi dhe Angli.

Mexhli Nusrat-e-Xhehan: Përmes kësaj shoqate 39 spitale dhe qendrat shëndetësore ushtrojnë veprimtarinë e tyre ku

shërbejnë 41 mjekë ndërsa në 12 vende të Afrikës numri i shkollave të mesme, 9 vjeçare e ato fillore ndërtuar nga xhemati ka arritur numrin 656.

Uakfi Nau: Numri i fëmijëve të cilët prindërit i kanë dedikuar në rrugë të Zotit vetëm gjatë këtij viti është 2139 ndërsa numri total i këtyre fëmijëve ka arritur shifrën 41220 nga 87 vende të botës.

El-Vesijjet: anëtarët e këtij sistemi premtojnë për të kontribuar 1/10 nga të ardhurat e tyre për hir të Zotit. Që nga 2005 kur Huzuri ^{atba} u kishte bërë thirrje Ahmadianëve për t'u bashkuar në këtë sistem, numri i anëtarëve të tij ka arritur

109 mijë që tregon nivelin e sakrificës dhe përkushtimit në këtë xhemat.

Nëkëtëxhelsë, 7 dijetarët mbajtën fjalimet ndërsa personalitete të shquara nga politika apo jeta shoqërore vlerësuan përpjekjet e xhematit në mbarën botën për të përhapur mësimet e paqes dhe harmonisë dhe projektet humanitare. Sulmet terroriste ndaj dy xhamive të xhematit në Lahor më 28 maj, ku 86 Ahmadianët u martirizuan, gjithashtu u diskutua disa herë. Të gjithë të ftuarit anglezë apo

të huaj, me një zë shprehën ngushëllimet e keqardhjet për këto sulme.

Anëtarët e xhematit nga e gjithë bota përfituan nga fjalët besimshytëse dhe këshillat e çmueshme të Huzurit. Xhelsa përfundoi me lutje të heshtur që mbushi gjithë ambientin me mallëngjime dhe ngashërime.

Kështu kjo xhelsa mbaroi me suksese të mëdha. Allahu i mundësoftë të gjithë Ahmadianët që të përfitojnë nga bekimet e saj. *Amin*

Xhelsa Salana e 35-të të Xhematit Mysliman Ahmadia të Gjermanisë

Xhemati Mysliman Ahmadia i Gjermanisë zhvilloi Xhelsa Salanën e 35-të më 25,26 dhe 27 qershor 2010 në Mannhiem. Kryetari i Xhematit Mysliman Ahmadia Hazret Mirza Masroor Ahmad Kalifatul Masih V ^{atba} nderoi këtë tubim me praninë e tij. Për të marrë pjesë në këtë tubim kishin ardhur më shumë se 25 mijë veta nga 50 vende të botës. Të gjitha seancat e *xhelsës* u transmetuan drejtpërdrejtë në MTA dhe kështu miliona Ahmadianët që jetojnë kudo në botë, u bashkuan për ta ndjekur këtë takim shpirtëror. Xhelsa filloi me fjalimin e së xhumasë,

ku Huzuri vazhdoi diskutimin e historive të Ahmadianëve që u martirizuan në sulmet terroriste ndaj dy xhamive të xhematit në Lahor në Pakistan më 28 maj 2010.

Më 26 qershor Huzuri mbajti një fjalim të veçantë duke u drejtuar grave Ahmadiane. Huzuri recitoi ajetin 72 të suresë et-Teubes: *“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo*





është fitorja madhështore.” Huzuri tha se pëlqimi dhe kënaqësia e Zotit janë me të vërtetë xheneti i Zotit apo fitorja madhështore. Ai gjithashtu i këshilloi që të kujdesen për të drejtat e njëra-tjetrës dhe duke harruar keqkuptimet e dhembjet, të angazhohen në përforsimin e marrëdhënieve miqësore me të tjerat.

Më 27 qershor Huzuri mbajti fjalimin përmbyllës ku kujtoi sakrificat e 86 ahmadianëve të pafajshëm që ranë dëshmorë në sulmet barbare ndaj dy xhamive të xhematit. Huzuri tha se ai me fjalët e Kuranit *“Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes*

vetëm Allahut”, Atij që dëgjon lutjen e çdo të mjerit, Cili është mbështetja e shpresa të të shtypurve dhe të nënshtruarve. Huzuri tha se jemi të bindur që këto janë sprova prej Zotit ato gjithmonë në bëjnë më të fortë në bindjen e besimin tonë. Këto sprova do të na shtynë për më shumë lutje dhe Zoti si gjithmonë duke u përgjigjur lutjeve tona, do të na bekojë me suksese dhe fitore të mëdha.

Huzuri tha se të gjitha arritjet shpirtërore varen vetëm nga nënshtrimi ndaj të Dërguarit të Allahut ^{savs} dhe Ahmadianët e dinë mirë këtë prandaj ata kurrsesi nuk do të zbrapsen

nga kjo dashuri për shkak të kërcënimeve, atentateve, bombave apo granatave. Ai tha se çdo njeri që kundërshton të dërguarin e Zotit, ai në fakt dëshiron të përballojë Zotin. Prandaj o Ahmadianët, mos u pikëlloni. Detyra jonë është që të përulemi para Zotit dhe t'i përgjero kemi për mëshirën e Tij. O Zot! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim. Ne kështu besuam. O Ti që i përgjigjesh lutjes, O Mëkatfalës dhe Mëshirëbërës! Na mundëso që t'i përmbahemi betimit tonë. O Zot! Falna gabimet tona, na i shlyej gynahet tona, dhe bëna që të vdesim me të mirët. Huzuri tha se sigurisht secili prej dëshmorëve kishte përmbushur premtimin e tij dhe tani ndriçon si yll që orienton drejt gjetjes së pëlqimit të Zotit.

Ai tha se asnjë mizori e padrejtësi nuk mund t'i bëjë asnjë dëm Xhematit. Nëse do të përforcojmë lidhjen tonë me Zotin atëherë asnjë fuqi nuk mund të pengojë përparimin e Xhematit. Para se të mbyllte fjalimin e tij, Huzuri bëri një lutje. Ai tha "O Zot! Plotëso premtimin Tënd që ke bërë me robërit e Tu. Na fal gabimet tona dhe mbështillna në mëshirën Tënde. Asnjë sprovë e asnjë vështirësi të mos dobësojë besimin tonë. Mbrona nga çdo lloj keqe. Bekona me fitore dhe suksese." Pastaj Huzuri udhëhoqi lutje të heshtur gjatë së cilës dëgjohehin vetëm të qarët dhe gulçimat. Gjithë ambienti ishte mbushur me mallëngjim e ngashërim sikurse engjëjt bënë hije mbi të pranishmit.

هَذَا مِنْ فَضْلِ

INDEX IN ENGLISH

The Prophet Who Has Foretold The Unseen to The Utmost

Editorial

3

Verses From The Holy Quran - a presentation

5

Signs of The Advent of The Imam Mahdi and Promised Messiah – according to the hadiths

8

**About the Prophecies of the Holy Quran
Writings of the Promised Messiah a.s.**

25

Unveiling of the Unseen by the Quran

Hadrat Mirza Tahir Ahmad, Khalifatul Masih IV

30

“Love For All, Hatred For None”, a News with no comments

45

Perfection of the name of Allah

46

Islam and Science – Concordance or Conflict?

50

Permissibility of Music in Islam

Q/A - Hadrat Mirza Tahir Ahmad r.a., Khalifatul Masih IV

62

Hijab

Hadrat Mirza Masroor Ahmad a.t.b.a., Khalifatul Masih V

64

Northern Lights and the Holy Quran

66

In Memory of Late Mr. Musa Rrustemi, former President of Jamaat Ahmadiyya Kosovo

72

The Death of the Promised Messiah a.s. and Revelations about it

80

Dr. Abdul Salam’s Banquet speech

88

The 44th Jalsa Salana of Jamaat Ahmadiyya UK

90

The 35th Jalsa Salana of Jamaat Ahmadiyya Germany

93

Frekuencat në satelit

Sateliti	Pozicioni	Frekuencat
Hotbird 7A	13' Lindje	10722 MHz
Diametri min. i antenës	Polarizmi	Symbol Rate
1 metër	Horizontal	29900 Mbps
FEC	Video PID	Arabisht
3/4	1004	1604
Anglisht	Frëngjisht	Urdu
1304	1404	1204
	Gjermanisht	
	1504	

*“Unë do të çoj
mesazhin tënd
deri në
skajet e botës”*

*(Shpallja Hyjnore
për Mesihun e Premtuar a.s.)*

mta

REACHING THE CORNERS OF THE EARTH
Duke arritur skajet e botës



mta

MUSLIM TV AHMADIYYA

*Duke transmetuar
mesazhin e paqes,
harmonisë dhe dashurisë
në të gjitha anët e botës*



Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit www.mta.tv



Përpjekje të Xhematit Mysliman
Ahmedia për të përhapur paqe
Qindra autobusë në Nju Jork e në
Londër mbartin moton e Xhematit
Mysliman Ahmedia



DASHURI
për të gjithë
URREJTJE
për askënd



www.loveforallhatedfornone.org

“Vërtetësia” (The Truthfulness) is a periodical Albanian magazine published by Ahmadiyya Muslim Jama’at of Albania.
For Index in English, see page 96